



**Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administratës publike –
Diplomaci**

TEZË MAGJISTRATURE

**“Konfliktet ndërkombëtare” – studim rasti: Aspekti
krahases ndërmjet konfliktit në Irlandën e Veriut
dhe Republikës së Maqedonisë**

Mentori:
Prof. dr. Jonuz Abdullai

Kandidat:
Naim Etemi

Shkup, 2017

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
1. KONFLIKTET SHOQERORE.....	7
1.1. Konfliktet si fenomene shoqërore.....	9
1.2. Llojet e konflikteve – Ndarja e konflikteve sipas shkaqeve.....	14
1.3. Mënyra e zgjidhjes së konflikteve.....	20
1.4. Roli i faktorit ndërkombëtarë gjatë procesit të negocimit.....	26
2. KONFLIKTI NË IRLANDËN E VERIUT.....	37
2.1. Irlanda e Veriut si pjesë përbërëse e Mbretërisë së Bashkuar.....	37
2.2. Fillesat e konfliktit në Irlandën e Veriut.....	40
2.3. Trazirat (The Troubles).....	44
2.4. Irlanda e Veriut gjatë vitit 2001	46
2.5. Procesi paqësor në Irlandën e Veriut.....	50
3. KONFLIKTI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	53
3.1. Ndarja dhe pavarësia e Maqedonisë nga ish – Jugosllavia.....	53
3.2. Konflikti maqedono – shqiptarë.....	59
3.3. Konflikti i armatosur gjatë vitit 2001.....	62

3.4.	Raportet ndërmjet maqedonasve dhe shqiptareve pas vitit 2001 e kendej.....	65
4.	DALLIMET NË MES KONFLIKTIT NË IRLANDEN E VERIUT DHE KONFLIKTIT NË MAQEDONI.....	68
4.1.	Elementet e përbashkëta të konflikteve.....	70
4.2.	Shkaqet e konflikteve.....	71
4.3.	Ndikimi i faktorit ndërkombetarë në zgjedhjen e konflikteve.....	73
4.4.	Marrëveshjet e arritura dhe zbatimi i tyre.....	76
	Përfundimi.....	78
	Konkluzione dhe rekomandime.....	79 – 80
	Literatura e shfrytëzuar.....	81 - 86

Faleminderime

Realizimi i këtij punimi shkencor i dedikohet të gjithë “bashkudhëtarëve”, të cilët më kanë mbështetur në këtë rrugëtim të gjatë.

Së pari, ky punim nuk mund të zhvillohej i plotë pa mbështetjen, drejtimin dhe njohuritë e thelluara të udhëheqësit tim shkencor, Prof. Dr. Jonuz Abdullai. E falënderoj për zemërsisht për kohën, durimin, këshillat dhe kontributin e madh në përfundimin e këtij punimi. Ndihma e tij ka qenë e padiskutueshme në çdo moment, duke filluar që nga përcaktimi i fushës së studimit, e më gjerë, në gjetjen e shtigjeve më me interes për t’u shqyrtuar në këtë punim.

Së dyti, mirënjohje nga zemra për familjen time, për gjithë durimin, mbështetjen dhe sakrificën.

Ju Faleminderit!

Hyrje

Gjithmonë njerëzimi është ballafaquar me situata të ndryshme, fenomene të përgjithshme që kanë sjell deri te konflikte që njëherë ka qenë rrezik për paqen dhe stabilitetin botëror. Në jetën e përditshme, konfliktet shpesh herë janë barazuar me kundërshtime të palëve të përfshira në të, me pushtetin ose përdorimin e dhunës. Konfliktet ndërkombëtare zakonisht fillojnë kur dalin në pah ndryshimet dhe diferencat e interesave, kur ulet besimi dhe rritet mosbesimi, ku komunikimi nuk është aspak i hapur dhe i sqartë. Problemi i vërtetë qëndron në rrezikun e vazhdueshëm të përshkallëzimit të tyre duke kaluar pragun e dhunës dhe duke u bërë shkak i shkatërrimit të jetëve njerëzore i cili nuk mund të justifikohet në asnjë rrethanë. Nëse e konkretizojmë këtë qasje shpjeguese në realitetin irlandez-verior, në aspektin sociologjik nuk ka ndonjë rëndësi substanciale (luftë apo konflikt), sikurse rasti i shqiptarëve të Republikës së Maqedonisë. Duhet theksuar se shumica e konflikteve etnike nuk fillojnë për shkak të sovranitetit territorial apo pavarësisë. Konfliktet pothuajse gjithmonë përfshijnë “minoritetet substanciale” që janë shumicë në një pjesë të territorit apo shtetit ku jetojnë, që në përgjithësi është territor tradicional dhe historik i tyre. Të dyja shtetet kanë qenë të përfshira nga konflikte me pasoja që më së shumti i kanë vuajtur popullata civile.

Qëllimet kryesore të këtij hulumtimi do të fillojnë që nga konfliktet ndërkombëtare me theks të veçantë në rastin e Irlandës së Veriut dhe Republikës së Maqedonisë.

Rasti i Irlandës së Veriut që është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, ku përjashtimi i gjërë i pakicës katolike nga kategoritë shtetërore dhe private të punësimit, rregulla diskriminuese të vendosjes dhe votimit, ndarja e madhe pothuajse në çdo sferë të jetës në mes protestantëve dhe katolikëve.

Rasti i shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, ku haset përjashtimi i gjuhës shqipe nga përdorimi në shumicën e institucioneve shtetërore (diskriminim), përfaqësim tejet i ulët nga kategoritë e ndryshme të punësimit në institucionet shtetërore, zakonisht e lidhur me politikën gjuhësore që në formë jo të drejtë i dëmton apo i përjashton.

Në fillim të temës do e nis me nocionin dhe paraqitjen e konflikteve, duke sqaruar qartë arsyet dhe aspektet e ndryshme rreth këtij termi. Pastaj do të mundohem të sqaroj historikun, zhvillimet dhe rastet kryesore se çfarë kanë të përbashkët dhe në çka dallohen rastet e Irlandës së Veriut dhe të Republikës së Maqedonisë, shkaqet e konflikteve, ndikimi i faktorit ndërkombëtarë në zgjidhjen e konflikteve si dhe marrëveshjet e arritura dhe zbatimi i tyre. Në fund do t'i paraqesë përfundimet dhe rekomandimet e studimit.

1. KONFLIKTET SHOQËRORE

Çdo ditë në vende të ndryshme të botës kemi dhunë kolektive, që merrë një nivel të lartë të vëmendjes publike. Konfliktet e dhunshme në shoqëri apo në ambiente ku nuk ka qetësi menatale janë me numër të madh.

Kur kemi mospërputhje të mendimeve, mosdëgjim aktiv, padrejtësi në rrethin shoqëror padyshim se do të vij deri tek konflikti. Si pasojë e kësaj fillon të formohen disa grupe (ato të shtetit dhe terorizmit grupor), përdhunimeve si armë luftarake, zhvendosja e një numri të madhë të njerëzve nga shtëpit e tyre si dhe ballafaqimet me bandë të armatosur ose bandë diversantësh (hajdutësh, kriminelësh, tradhtarësh). E gjithë kjo ndodh si pasojë e kësaj që u cek në këtë pjesë.

Konflikti është një fenomen, ekuivalenca latine e të cilit “conflictus” thënë përgjithësisht, tregon kundërshtim.¹

Në politikë termi „konflikt“ i referohet dy grupeve apo më shumë grupeve të individëve me pozicione dhe synime të papajtueshme e shoqëruar me përdorimin e metodave të dhunës. Me objekt të një konflikti do të kuptojmë arsye apo shkaqet për të cilat palët hyjnë në konflikt. Objekti i konfliktit mund të jetë një send ose e mirë materiale p.sh. në një mënyrë të caktuar kur një pasuri pretendohet nga dy ose më shumë palë ose mund të jetë një veprim a mosveprim i një pale, i cili shkel interesat e palës tjetër. Si objekt i një konflikti mund të shërbejë edhe një konflikt tjetër, i cili nuk është zgjidhur, por, përkundrazi, ka sjellë një vazhdimësi konfliktesh.

Konfliktet ndodhin në nivele të ndryshme të shoqërisë, si në shkolla ndërmjet studentëve, në familje, në tregti në mes aksionarëve dhe kompanive zbatuese etj. „Konflikti“ si term na shkakton shumicës nga ne një nivel të lartë të shqetësimit, zemërimit, rrënimit, dhembjes dhe vuajtjes.

Konfliktet shoqërore mund të definojnë si: shfrytëzimi i konfliktit si vegël nga njerëz të cilët veten e identifikojnë si pjesëtar të grupeve, pa marrë parasysh nëse grupi identitet i është i

¹ Stojanoski, Nelko; Gjurovska, Mileva; Matevski, Zoran, *SOCIOLOGJIA* për vitin e III të gjimnazit të reformuar, Prosvetno Dello, Shkup, 2004, f.124.

përhershëm apo tranzitor, kundrejt një grupi tjetër ose shumicë individësh, për arritjen e qëllimeve qoftë ekonomike, qoftë politike apo qoftë dhe sociale.

Për konfliktet shoqërore do të shkruaj edhe Fehmi Agani tek „Toleranca dhe konfliktet shoqërore“ ku thotë: „Konfliktet shoqërore janë forma të ndërveprimit të palëve shoqërore të konfrontuara, institucioneve, grupeve, individëve, shteteve, subjekteve me pozicione dhe interesa të ndryshme, me pikëpamje dhe synime të kundërta.“²

Palët në një konflikt janë individët, grupet e individëve, shtetet, interesat e të cilave janë përplasur. Nga tre elementet përbërëse të konfliktit, elementi palë është më i rëndësishmi për të përcaktuar si përmbajtjen e konfliktit, ashtu edhe vetë ecurinë apo fatin e tij. Ky element është shumë më kompleks se elementet e tjera.

Kur në një konflikt të caktuar, ndërhyjnë një palë mund të thuhet se nuk është asgjë tjetër, veçse një qëndrim i saj ndaj realitetit. Zgjidhja e konflikteve si një aftësi e punës së shkallëshkallëshme dhe profesionale zakonisht përcaktohet në rastet kur dy apo më shumë palë, të cilat mbështesin qëllime të kundërta, mundohen që të marrin qëllimet e të tjerëve dhe ti përshtatin me të tyre. Sido qoftë konflikti, mundet gjithashtu të ndodhë në situata të bashkëpunimit në të cilat dy ose më shumë palë kanë qëllime stabile, sepse mënyra se si njëra palë dëshiron të arrijë qëllimet e veta mund të destabilizojë palën tjetër.

Mes të tjerash lidhur për konfliktet shoqërore që ka shkruar është edhe Anthony Oberschall, i cili në librin e tij të titulluar „Theories of social conflict“, do të shprehë: „Konfliktet „shoqërore“ i referohen konfliktit në të cilin palët janë një grumbull i individëve, grupimeve, organizatave, komuniteteve, më tepër se individë, si në rolin e konfliktit. Kjo ndodh kur dy ose më shumë njerëz kundërshtojnë njëri-tjetrin në ndërveprime sociale. Konflikti shoqëror është luftë mbi vlerat apo pretendimet për statusin dhe burimet e pakta, në të cilën qëllimet e grupit në konflikt nuk janë vetëm për të fituar vlerat e dëshiruara, por edhe të neutralizojnë, dëmtojnë, apo të eliminojnë rivalët. Konfliktet shoqërore përfshijnë një gamë të gjerë të fenomeneve sociale siç janë: ato klasore, racore, fetare dhe konflikte komunale; trazirat,

² Fehmi Agani, *Toleranca dhe konfliktet shoqërore*, Prishtinë, 1997, f.27.

kryengritjet, revolucionet; greva dhe çrregullime civile; marshime, demonstrata, tubime protestuese, dhe te ngjashme.”³

Ndërsa sipas filozofit gjerman Karl Marksit, konfliktet shoqërore interpretohen si luftë klasash, e cila sipas tij paraqet forcën motorike të zhvillimit të formacioneve ekonomike e shoqërore gjatë historisë njerëzore, histori e cila rezulton me krijimin e formacioneve ekonomiko shoqërore më të avancuara se ato paraprake. Edhe pse teoria marksiste në planin praktik ka pësuar fiasko, Karl Marksi vazhdon edhe më tej të mbetet një ndër teoricientët më interesant të mendimit sociale në botën perendimore.

1.1. Konfliktet si fenomene shoqërore

Konflikti është pjesë e jetës, ekzistenca e tij është po aq e lashtë sa edhe ekzistenca e njeriut. Prej kur ekziston shoqëria është e pamundur të mos kemi konflikt në jetën shoqërore.

Janë dhënë definicione të ndryshme për dhe rreth konflikteve ndërnjerëzore. Nga kjo mund të konkludojmë se konfliktet kanë qenë dhe si duket do të jenë bashkëudhëtarë të njerëzimit. “Konfliktet, mosmarrëveshjet kanë qenë bashkëudhëtarët historikë të shoqërisë njerëzore”.⁴

Fjalori i gjuhës së sotme Shqipe konfliktin e definon si: “Mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy njerëzve apo dy palëve, ndeshje e ashpër, acarim i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve që çonë deri në një luftë të armatosur”.⁵ Më pas konflikti sjell dhunë individuale apo të organizuar, ku si pasoj e dhunës palët marrin pozicione diametralisht të kundërta. “Konflikti është një dukuri që shpie në dhunë të organizuar të shkaktuar nga përfshirja e palëve, që kanë pozicione të papërputhshme për çështje të ndryshme...”⁶

Përpara se të trajtojmë konfliktin me gjithë larminë dhe llojshmërinë e pafund të konkretizimit, është e rëndësishme që të përmendim Violeta Petreska Beshka, e cila do të shkruaj

³ Anthony Oberschall, *Theories of social conflict*, Nashville, Tennessee, 1978, f. 291.

⁴ Ismet Elezi, *Ndërmjetësimi për Pajtim në Konfliktet Penale*, Tiranë, 2004, fq. 11.

⁵ *Fjalor i shqipës së sotshme*, ASHSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letrarisë, Tiranë, 2002, f.833-834.

⁶ Lisen Bashkurti, *Krizat ndërkombëtare*, Tiranë, 2008, f. 236.

për nocionin konflikt në librin e saj të titulluar „Konfliktet“; „Me nocionin konflikt nënkuptohet përleshja apo ndeshja midis dy ose më shumë personave apo grupesh që përdorin forcën si mjet për t’u mbrojtur nga dikush...“

„Konfliktet janë dukuri shoqërore në marrëdhëniet ndërnjerëzore, të cilat mund të dalin nga: dallimet në vlerat shpirtërore dhe kulturore, mosmarrëveshjet, perceptimet e ndryshme rreth interesave personale dhe të palës tjetër, paafësia në shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale, kërkesave të papërmbyshura etj. Derisa nuk kuptohet esenca se konflikti është problem i përbashkët dhe që mund të zgjidhet vetëm me përpjekje dhe bashkëpunim reciprok, asnjëra palë në konflikt nuk mund të dalë e fituar.“⁷

Në jetën e përditshme, gati-gati kur themi konflikt ne nënkuptojmë si shkak të mosmarrëveshjes. Fjala „konflikt“ jo domosdoshmërisht do të thotë betejë. Pra, ç’do kund, në ç’do kohë ku njerëzit takohen mund të vjen deri te konflikti.

Konfliktet janë objekt i studimit multidisiplinar nga studiues të ndryshëm, që do të thotë se bëhet fjalë për një dukuri teje të rëndësishme, sepse nuk ekziston veprimtari kolektive dhe shoqërore, në të cilat nuk gërshetohen interes të ndryshme. Kjo dukuri shoqërore përkufizohet ndryshe nga autorë dhe studiues të shkencave humane. Mirëpo, në shkencën politike, konfliktet për herë të parë trajtohen nga A. Tokëvili, K. Marksi, A. Bentli, të cilët konfliktin e shqyrtojnë si një burim të politikës, si një bazë e rëndësishme nga të cilat rrjedhin të gjitha ndryshimet në shoqëri.⁸

Konflikti është një fenomen shoqëror. Konflikti për fat të mirë apo të keq atë e gjejmë pothuajse kudo si dukuri shoqërore. Por mbi të gjitha, nuk mund të thuhet se konflikti është i keq e as i mirë. Pasi që mund të japë rezultate të mira ose mund të japë rezultate negative.

Bejtush Gashi në librin „Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike“, do të shkruaj: „Konfliktet mund të prodhojnë rezultate negative, por edhe pozitive, pavarësisht nga teknikat e komunikimit që përdoren; konfrontimet, të cilat përfshijnë dëgjim aktiv dhe mirësinë e bashkëpunimit, prodhojnë rezultate pozitive dhe lejojnë që dallimet të negocohen. Në literaturën profesionale termi konflikt përkufizohet si një betejë qëndrore, mohim i forcave të kundërta ose


⁷ Violeta Petreska Beshka, *Konfliktet*, Shkup, 1995, f.2-5.

⁸ Jonuz Abdullahi, *Politika dhe politikat politike*, Arbëria Desing, Tetovë. 2016, f. 127

fuqive, si trazira apo beteja; situata ose kushte të kundërshtimeve, antagonizëm, mosmarrëveshje; një tension i dhembshëm, i ngritur nga përplasje në mes të rrjedhave të kundërshtive të kundërta.“⁹

Mendoj se konfliktet asnjëherë nuk duhet „mbuluar me pëlhurë“, por duhet „zbuluar“ dhe trajtuar seriozisht, sepse një sqarim sa më i hershëm i mosmarrëveshjes mund të jetë një punë e suksesshme. Dhe për të menjanuar konfliktet duhet ndëgjim aktiv, të mos iu ikim mosmarrëveshjeve dhe problemeve, por tu qasemi haptazi. Gjithashtu sipas meje mund të them se konflikte shkaktohen, sepse: janë cenuar të drejtat, interesat si dhe janë cenuar pushtetet.

Sa për ilustrim, ja si do të dukej edhe grafikisht.



Mosmarrëveshjet në përmasat e tyre mund të çojnë në tronditje të karakterit tërësor, në diskriminime etnike, racore, gjinore, në mungesë tolerance që kjo rrugë të shpie deri tek luftërat e ndryshme.

Varësishtë nga zgjatja e konfliktit luftarak ka edhe rezultate të pasigurt . Gjatë periudhës luftarake është fakt që në aty nuk ka fitimtar, por vetëm humbës. Humbës janë të gjithë ata që janë përfaqësuesit kryesorë të një organizate apo të një grupi me veprimet e tyre shkatruese, të

⁹ Bejtush Gashi, *Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike*, Prishtinë, 2008, f. 13.

cilët përveç dëmtimëve materiale ato shkaktojnë edheçrregullime postraumatike, që me vite riprodukohen në kornizën e dhënë shoqërore. Për këtë shkak është mirë të kultivohet toleranca me gjithë lloj-llojshmërinë e saj me qëllim që pengohet dhuna dhe konflikti.

Në këtë kontekst për dhunën dhe mungesën e tolerancës e shoh të arsyeshme që ta citojë, Vaclav Havelin, kryetar i Çekisë, citat që gjendet edhe tek libri „Toleranca politike në funksion të paqës“ i Nazmi Maliqit, i cili është shprehur në këtë mënyrë: „ ... Dhuna është padrejtësi për qenjen njerëzore. Intelektualët kanë të drejtë të mendojnë për të ardhmen, ta paramendojnë atë se si duhet të jetë. Por, detyra e tyre, përparësia e tyre kryesore, sipas meje është të kuptojnë të tashmen, t’i kuptojnë krizat e saj dhe t’i emërojnë me emrin e vërtetë. Pikërisht kështu lind ndërgjegjia e vërtetë për perspektivat...“¹⁰

Gjithashtu rreth konfliktit do të shkruaj edhe studiuesi amerikan K.J.Holsti sipas të cilit:

„Konflikti është një dukuri që qon në dhunë të organizuar e shkaktuar nga përfshirja e palëve, që kanë pozicione të pabarabarta për çështje të ndryshme, kanë qëndrim armiqësor dhe forma të caktuara veprimi ushtarak e diplomatik.“¹¹

E shoh të arsyeshme që të përmendi edhe F. Tashevskia Remenska, e cila rreth paraqitjes së konfliktit do të shprehet: „Konflikti paraqet formën e bashkëveprimit ndërmjet individëve ose grupeve të ndryshme, në të cilën ka për qëllim që të zhduket, të vendoset ose të ndërmerret kontroll ndaj individëve ose ndaj grupeve shoqërore. Në konflikt secila nga palët është e vetëdijshme për ndryshimet e grupit tjetër. Konflikti paraqitet në kushte kur disa personave ose grupeve u kufizohet resurse të caktuara, të drejta, përfitime etj. Konfliktet ndërmjet grupeve në masë më të madhe e rrisin kohezionin në suazat e grupit, si dhe i rrisin ndjenjat joshqërore (paragjykimet) ndaj grupit me të cilin ndodhet në konflikt. Vëzhgimi i konflikteve si fenomen shoqëror mund të kryhet nga aspekte të ndryshme siç janë: ai social, psikologjik, filozofik, juridik, politik i dhe ai i sigurisë. Konflikti për se (për secilin) paraqet shprehje natyrore të dallimeve shoqërore dhe luftës së përhershme të njerëzimit për drejtësi dhe vetëvendosje. Konflikti për nga natyra nuk është destruktiv dhe paraqet dukuri normale në secilën bashkësi

¹⁰ Nazmi Maliqi, *Toleranca politike në funksion të paqës*, Fondacioni Friedrich Ebert, Shkup, 2001.

¹¹ Lisen Bashkurti, *Krizat ndërkombëtare*, Tiranë, 2008, f. 236.

dinamike. Nëse me konfliktin udhëhiqet në mënyrë paqësore dhe të hapur, ai mund të jetë pozitiv, konstruktiv dhe progersiv.“¹²

Konstatimi se konflikti është rregullator dhe qëllimi i jetës sociale duket shume absurd dhe aspak i argumentueshëm. Por, nese deshirojmë të jemi objektiv dhe kritikë, kjo domethënë të shohim të vërtetën në mënyrë racionale. Duke shikuar nga qasja e të kuptuarit dinamik, shoqëria është sistem i cili vazhdimisht pëson ndryshime të cilat vijnë si rezultat i antagonizmave në nivele të ndryshme të sferës sociale, apo grupeve shoqërore dhe si rezultat të kësaj kemi shpërthimin. Si i tillë konflikti pasqyron gjendjen kur shkalla e komunikimit në mes grupeve antagoniste nënkupton shkallën më të lartë të aplikimit të dhunës. Jo përherë konfliktet qojnë në rregullime pozitive shoqërore ose në ndërtimin e gjendjes paraprake e cila rezulton me ardhjen në pah të aspekteve rregullative pozitive. Sa më të mëdha të jenë dallimet midis palëve konfrontuese në aspektin e diferencës së potencialit të dhunshëm ndryshimet pozitive në mënyrë proporicionale janë më të vogla.

Interesim lidhur me konfliktet si fenomene sociale e shprehu edhe Maks Weberi, i cili kishte mësuar gjuhën ruse në mënyrë që të kishte mundësi ta përcillte revolucionin rus. Interesin e tij në lidhje me konfliktet shoqërore ai e ka orientuar në mjetet metodologjike të realizimit të pushtetit. Edhe pse ishte një përfaqësues tipik i mendimit liberal demokratik, ai ishte i preokupuar për aspektet territoriale, gjë që edhe sot e kësaj dite nuk ka humbur nga aktualiteti si burim i konflikteve moderne.

Ka të drejtë Lewis A. Coser kur pohon se „Konflikti padyshim është i keq dhe sjellë viktima, ku humbja e jetëve të njerëzve nuk mund të arsyetohet me asnjë rrethanë. Le të paramendojmë se si do të ishte dukur bota pa revolucionin borxhez francez, pa kryengritjen e Spartakut, pa rezistencën ndaj fashizmit, pa rezistimin ndaj racizmit e kolonializimit.“¹³

Përkufizimi që do t'i pëmbledhte të gjitha aspektet themelore të konfliktit duhet të përqëndrohet në tre përbërësit themelor të tij:

- Palën në konflikt,

¹² F. Tashevska Remenska, *Mekanizma për zgjidhjen e konflikteve etnike*, Shkup, 2009, fq. 230.

¹³ Lewis A. Coser, *Social Conflict and the Theory of Social Change*, The British Journal of Sociology, 1957, f.197-207

- Sjellja konfliktuoze dhe
- Interesat konfliktuoz.

Domethënë, konflikti është rezultat i ekzistimit në të njëjtën kohë të interesave konfliktuoze dhe i sjelljes konfliktuoze ndërmjet palëve në konflikt. Me rëndësi jashtëzakonisht të madhe është shmangia nga konfliktet, që me përgjegjësi politike të gjendet forca që do të japin koncept real politik për respektimin e institucioneve demokratike të sistemit, për tolerancë ndërkombëtare, tolerancën fetare etj. Stabilitetin, sigurinë dhe paqen në shumë raste, individët, grupe të caktuara, nuk e kuptuan si konstantë të mbështetur në parimet e barazisë qytetare, mirëkuptimit ndëretnik dhe tolerancën politike, si mundësi reale për të shkuar në një të ardhme me prespektivë, me aspirata demokratike e mbështetur në paqen.¹⁴

Mund të themi se ka mjaft mendime lidhur për këtë fenomen të quajtur konflikt, ku përfshihen në aspektin negativ dhe gjithashtu në atë pozitiv. Por, njerëzit në përgjithësi prihen që ta shikojnë konfliktin si një dukuri negative. Pasi ky term shpesh na pasqyron dhunë, luftë, urrejtje apo thënë më shkurt krijon emocione të forta dhe situata të pakëndshme. Megjithatë, konflikti është e pamundur të mos prezent qoftë edhe si element i bashkëveprimit shoqëror. Por, gjithashtu konflikti mund të jetë burim i frymëzimit, mësimi, marrdhënieve më të mira, ndryshimeve konstruktive. Pra, deri sa të ekzistojë njerëzimi në rruzullin toksor do të kemi edhe konflikte, të cilat burimin e kanë pikërisht nga mospajtimet në mes njerëzve.

1.1. Llojet e konflikteve – Ndarja e konflikteve sipas shkaqeve

Duke e ditur se konfliktet pengojnë zhvillimin e njerëzimit, dëshirën e tij për një të ardhme të ndritshme. Shumë persona me mijëra vjet janë përpjekur dhe kanë punuar në përmirësimin e tyre, për shkak të dhimbjes humbjet dhe të reduktuar të ardhme që premtan ardhmëri më të mirë të njerëzimit në tërësi.

¹⁴ Nazmi Maliqi, *Toleranca politike në funksion të paqes*, Shkup, 2003, fq. 143.

Varësisht nga situatë kemi disa lloje të konflikteve, të cilat do të mundohemi t'i cekim më poshtë në këtë punim.

Barton vendos lidhjen në mes frustracioneve dhe nevojave themelore për identitet, si dhe për siguri dhe qëllime të tjera (p.sh., njohja, autonomia, dinjiteti). Sipas tij teoria e nevojave njerëzore konsideron se ka disa nevoja të caktuara gjenetike dhe antologjike ndaj të cilat synon dhe se procesi i socializimit, nëse nuk është kompatibil me këto nevoja njerëzore, shkakton shqetësim dhe sjellje antisociale individuale dhe grupore. Individët nuk mund të socializohen me sjelljet që e shkatërron identitetin e tyre dhe nevojat tjera, prandaj duhet të reagojnë kundër rrethimit që e bënë ajo. Sjellja, që është jashtë frustracioneve të këtyre bazave dhe nevojave shpesh do të duket agresive dhe kontraproduktive.¹⁵

Koncepti i një konflikti mund të kalojë në një shkëmbim verbal dhe të rezultojë në përleshje. Konflikti mund të ekzistojë në nivelet e ndryshme të analizës. Si kritere me vlerë për klasifikimin e konflikteve mund të merren:

- Një territor i caktuar.
- Një periudhë e caktuar.
- Objekti i konfliktit.
- Palët që hyjnë në konflikt.

Mbështetur në këto kritere, dallojmë këto lloje të konflikteve:

- Konflikti në vetvete (nëpërmes këtij konflikti zakonisht bëhet presion psikologjik)
- Konflikt ndërpersonal
- Konflikt grupor
- Konflikt organizacional
- Konflikt komunitetesh
- Konflikt brendashtetëror (p.sh., luftërat civile, fushatat elektorale)
- Konfliktet ndërkombëtare (konflikti në këtë nivel mund të shfaqet si konflikt më i gjërë). Është konceptuar si dhunë e organizuar në shkallë të gjërë midis forcave të armatosura të shteteve përkatëse.¹⁶

Sipas një klasifikimi tjetër, konfliktet ndahen në:

¹⁵ Nazmi Maliqi, *Toleranca politike në funksion të pages*, Shkup, 2003, fq. 144.

¹⁶ Bejtush Gashi, *Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike*, Prishtinë, 2008, fq. 15.

- konflikte fetare,
- konflikte nacionale,
- konflikte ideologjike,
- konflikte ekonomike, dhe
- konflikte ndëretnike.

Konfliktet fetare janë të ngjashme me konfliktet ndëretnike dhe gjithashtu mund të ndihmojnë për zhvillimin e konflikteve ndëretnike në të cilat entuziazmi i besimit zakonisht është përdorur të ndezë konfliktin dhe të frymëzojë dhe nxitë palët që luftojnë. Në fe nuk ka asgjë thelbësore, e cila të krijojë domosdoshmërisht konflikte; në shumë vende pjesëtarët e grupeve të ndryshme fetare bashkëjetojnë në mënyrë paqësore. Megjithatë, ndryshimet fetare përmbajnë mundësinë për lindjen e konfliktit, si dhe për thellimin e pamundësisë për trajtimin e konflikteve ekzistuese, sepse fetë në vetvete përmbajnë vlera themelore, duke përcaktuar ç'është e mirë dhe ç'është e keqe, të cilat vështrohen si vlera të përjetshme.¹⁷ Kjo bëhet gjithnjë dhe më e vërtet, ndërkohë që lëvizjet fundamentaliste janë forcuar në dhjetëvjeçarët e fundit. Pjesëtarët e këtyre lëvizjeve i organizojnë jetët e bashkësive të tyre përreth besimeve të tyre fetare dhe shume prej tyre janë të gatshëm të japin edhe jetën për këto besime. Këto lëvizje janë fuqizuar shumë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit dhe sfidojnë vlerat e praktikat e organizatave politike jofetare ose të atyre që janë krijuar jashtë institucioneve fetare.

Si një sistem besimi ndërkombëtar, fetë shpesh merren si një e drejtë më e lartë sesa e drejta shtetërore dhe traktatet ndërkombëtare. Historia është e mbushur me ndeshje midis grupeve që aderojnë në forma të ndryshme të të njëjtit besim. Në këto konflikte sfida qëndron në realizimin e përshtatjes së njerëzve me shumëllojshmërinë e besimeve dhe praninë e besimeve fetare të të gjitha grupeve për të bashkë ekzistuar. Konfliktet ndëretnike janë rrënjësuar thellë në formimin e kulturës dhe prandaj janë më të vështira për tu zgjidhur.

Konfliktet nacionale mund të jenë sfidat e ardhshme më të mëdha për tu zgjidhur pas atyre ndëretnike dhe fetare. Shumë njerëz e vështrojnë nacionalizmin për kushtimin ndaj

¹⁷ Greg Cashman, *What causes war – an introduction to theories of international conflicts*, Maryland, 2013, fq. 1.

interesave të një kombi, si forcën më të rëndësishme në politikën botërore gjatë dy shekujve të fundit. Nacionalizmi i shfrytëzon energjitë e popullsisë të mëdha duke u mbështetur në ndjenjat e tyre patriotike ndaj kombit. Nacionalizmi ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm për përforcimin e dallueshmërisë kombëtare si një ndjenjë përparësore e njerëzve në një pjesë të madhe të vendeve të botës.¹⁸

Konfliktet ideologjike. Ajo më shumë i shton e qëndron si simbol i konflikteve ndërmjet grupeve dhe shteteve, sesa i shkakton ato. Ideologjitë janë të lidhura në mënyrë më të dobët me vlerat thelbësore e me të vërtetën e përgjithshme, sesa është e lidhur me to feja, kështu që ato krijojnë probleme më të pakta për sistemin ndërkombëtar. Për realistët, ndryshimet ideologjike ndërmjet shteteve nuk kanë shumë rëndësi, sepse të gjithë pjesëtarët e një sistemi ndërkombëtar ndjekin interesat e tyre kombëtare në rrethanat e aleancave të paqëndrueshme. Për shembull, gjatë Luftës së Ftohtë ekzistonte një luftë ideologjike botërore ndërmjet demokracive kapitaliste dhe komunizmit. Megjithatë, aleancat e konkurencat ushtarake të kësaj lufte ishin shumë të shkëputura prej faktorit ideologjik. Ideologjitë mund të ndihmojnë për të mobilizuar popullsitë kombëtare që të mbështesin një shtet në veprimet e tij ndërkombëtare, si p.sh. fashizmi (ideologjia naziste) që frymëzoi nacionalizmin gjerman të periudhës para Luftës së Dytë Botërore, duke përligjur agresionin gjerman. Ideologjia mund të nxisë dhe të dendësojë konfliktin midis dy konkurruesve, siç ndodhi me superfuqitë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.¹⁹

Konfliktet ekonomike. Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të luftërave civile. Ato aq shumë u shpeshtuan sa që u bënë si luftëra ndërkombëtare, duke prekur një të katërtën e të gjitha vendeve të botës nga mesi i viteve 90. Gjatë kësaj periudhe këto luftëra jo vetëm që u bënë më të shpeshta por edhe zgjaten më gjatë. Ato shënuan një ndryshim në karakterin e luftës në përgjithshmi. Viktimat e luftës tani më shumë se në të kaluarën, janë prodhuesit ekonomik në vend se të caqeve ushtarake. Grupet luftuese gjithashtu veprojnë si agjentë ekonomik në zonat në të cilat ata luftojnë për të mbijetuar. Në disa zona ata drejojnë industrinë, rregullojnë prodhimin dhe ofrojnë shërbime. Në vende të tjera aktiviteti i tyre është grabitja. Këto ndryshime kanë ndodhur gjatë një

¹⁸ Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë, 2003, fq. 46.

¹⁹ Bejtush Gashi, *Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike*, Prishtinë, 2008, f. 17.

periudhe të shpejtë të rritjes së prosperitetit global, rritjes së globalizimit dhe rritjes së pabarazisë globale.²⁰

Konfliktet ndëretnike. Mungesa e konflikteve mes përkatësive etnike është e rrallë. Historia jep pakshembuj të jetesës të shoqërive ose shteteve pranë njeri-tjetrit pa manifestuar herët a vonë mosmarrëveshje apo ndeshje ndërmjet synimeve të kundërta të etnive. Për shkak të mosmarrëveshjeve të thelluara, të cilat rrezikojnë kriza që të çojnë deri në luftë.

Konfliktet ndëretnike janë ndoshta burimi më i rëndësishëm i konflikteve në shumë luftëra që ndodhin në të gjithë botën. Këto konflikte janë rrënjësuar thellë në formimin e kulturës dhe prandaj janë më të vështira për tu zgjidhur. Lufta e Ftohtë, me sistemin e saj të ngurtë të aleancave dhe qeveritë komuniste autoritative në Evropën Lindore, ndihmuan për të mbajtur nën kontroll këto konflikte, të cilat pas përfundimit të saj, shpërthyen fuqishëm.²¹

Shumica e konflikteve etnike nuk fillojnë për shkak të suverinitetit territorial apo pavarësisë. Argumenti që konfliktet brenda shtetërore gjithmonë përfshijnë kërcënim separatist për bashkësinë e shtetit është një përbindësh. Duket se shumica dërmuese e konflikteve të lartëpërmendura nuk kanë të lindura antagonizma apo mosnjohje të shtetit, por kërkesa nga grupe për përmirësime në strukturat dhe institucionet e shtetit. Kjo më tutje është e konfirmuar në studimet empirike të konflikteve që përfshijnë pakicat, siç është fjala për pakicat në Risk Project, që thekson se numri i konflikteve në botë është në rritje që nga viti 1960, edhe pse intensiteti i tyre në kuptimin e përgjithshëm është zvogëluar në kohën e fundit, veçanërisht aty ku të drejtat e pakicave respektohen dhe aty ku një lloj renditje autonome është negociuar. Nuk është prezenca e pakicave etnike, gjuhësore apo fetare në një shtet ajo që vetvetiu është burim natyror i konfliktit. Ajo çka është më e veçantë kur njëri konsideron dallimet njerëzore nga aspekti gjuhësor, fetar dhe kulturor është ajo se përkundër ndoshta qindra mijëra pakica të ndryshme apo kombinime grupore në botë, në fakt ka vetëm disa konflikte brendashtetërore me dhunë.²²

Konflikt ndërkombëtar çdo herë ka pasur, ka edhe në kohën e sotme dhe do të ekzistojë gjithnjë.

²⁰ Macartan Humphreys, *Economics and Violent Conflict*, Harvard University, 2003, f. 1.

²¹ Louis Kriesberg, *Constructive conflicts – from escalation to resolution*, UK, 2012, f. 5.

²² Fernand de Varennes, *Theory of Ethnic Conflicts and Sociology*, Australia, 2004, f. 7/8.

„Në konfliktin ndërkombëtar, palët në konflikt janë shtetet ose organizatat ndërkombëtare, derisa konfliktet e brendshme të armatosura udhëhiqen midis grupeve antagoniste në hapësirën e një shteti. Konfliktet e brendshme mund të paraqiten si grusht shteti, rebelimet e armatosura ose kryengritjet të cilat eskalojnë në konflikte të armatosura me përmasa më të gjëra që zakonisht quhet luftë qytetare, si konflikte me dhunë shumë intensive ushtarake dhe me mobilizim shumë të vëllimshëm të njerëzve në shtet. Si kriteret për atë se rebelimet a janë përshkallëzuar në luftë qytetare merren: intensiteti i dhunës, kohëzgjatja e operacioneve ushtarake, vëllimi i forcave të përdorura dhe shtrirja e hapësirës ku zhvillohen operacionet ushtarake. Konflikti i brendshëm mund të ketë për qëllim luftën për pushtet të grupeve të caktuara, ndryshimin e sistemit ekzistues politik, shkëputjen e një territori për bashkimin e tij ndaj një shteti tjetër ose për krijimin e shtetit të ri të pavarur. Konflikti i brendshëm udhëhiqet midis forcave të rregullta të armatosura të shtetit dhe grupeve të armatosura nga shteti i njëjtë me emra të ndryshëm: rebelues, kryengritës, terroristë, disidentë, forca antiqeveritare, komplotistë, forca të rezistencës, armata çlirimtare, guerilë, grupe të armatosura etj. Për konfliktin e brendshëm bëhet fjalë edhe kur qeveria legjitime e shtetit nuk e ka kontrollin e tërësishëm dhe nuk e ka pushtetin ndaj gjithë popullatës dhe ndaj gjithë territorit ose kur në shpërbërjen e pushtetit ndeshen midis vete grupe të caktuara rivale politike ose etnike.“²³

„Nëse shteti i huaj e ndihmon pushtetin legjitim kundër të cilit janë ngritur kryengritësit, konflikti e mban karakterin e brendshëm, kurse nëse shteti i huaj lufton në anën e kryengritësve, konflikti transformohet në konflikt ndërkombëtar. Pas pyetjes se në cilin nivel përkrahja e huaj ndaj kryengritësve shëndërrohet në intervenim ushtarak, konsiderohet se furnizimi më i vogël i kryengritësve me armë nuk trajtohet si përdorim i forcës së armatosur. Por, kur furnizimi i armës shoqërohet edhe me instruktorë ushtarak për stërvitje të kryengritësve, konsiderohet se shteti i huaj ka filluar me luftë.“²⁴

„Edhe pse të gjitha rregullat nuk zbatohen në konfliktin e brendshëm të armatosur, shteti në territorin e të cilit ndodhet konflikti, mund të shpall qëllimin e vet për për zbatimin e parimeve themelore të kësaj të drejte ndaj forcave konfrontuese. Kjo normalisht ndodh kur konflikti e arrin shkallën e armiqësive të ashpërsuara ushtarake si kryengritje më masive ose revolucion. Pastaj,

²³ Voislav Vasileski, *E drejta ndërkombëtare në konfliktet e armatosura*, Shkup, 2003, f. 321.

²⁴ Yoram Dinstein, *War, aggression and self-defense*, Cambridge, 1995, f. 6.

rregullisht edhe pala kundërshtare shpall qëllim të ngjashëm. Këto deklarata kanë veprim juridik vetëm ndërmjet palëve involvuese në konflikt, derisa shtetet, të cilat nuk përzihen në konflikt kanë të drejtë të mos ua njohin palëve të drejtat që janë paraparë në konfliktin ndërkombëtar.“²⁵

Konflikti etnik është burimi kryesor dhe primar për dhunë dhe pasiguri në botë. Ndërmjet viteve 1900 dhe 1987, gjithsej 170 milion njerëz kanë qenë të vrarë nga autoritetet e tyre në gjithë botën. Këto shifra nga larg i tejkalojnë numrat nga viktimat e konflikteve ndërshtetërore. Sipas të dhënave të Ernest Reger, deri në vitin 1993 pothuajse dy e treta e konflikteve politike në botë kanë qenë konflikte etnike.²⁶

Shkaqet kryesore për paraqitjen e konflikteve mund të kategorizohen në tri nivele:

1. Konflikte për shkak të resurseve të kufizuara, (dy individ ose dy grupe që dëshirojnë diçka të njëjtë, por është e dukshme se ajo nuk është e mjaftueshme për dy palët)
2. Konflikte për shkak të nevojave të pakënaqura themelore (mund të jenë të natyrës së ndryshme psikologjike dhe biologjike, p.sh., nevoja për sigurim, nevoja për përkatësi, nevoja për ujë, ushqim, strehim) dhe
3. Konflikte për shkak të vlerave të ndryshme (cilat punë dhe ide janë të drejta, të dobishme dhe të rëndësishme, dhe cilat nuk janë).²⁷

1.3. Mënyra paqësore e zgjidhjes së konflikteve

Çdo konflikt-mosmarrëveshje mund të ketë zgjidhje, mjafton të kërkohej. Njëra ndër metodat apo rrugët që kanë funksionuar për gjatë historisë, edhe pse në mënyra të ndryshme ka qenë dhe akoma vazhdonë të jetë „ndërmjetësimi“. „Çka është e re, është se ndërmjetësimi është rizbuluar si një zëvendësim për shumë nga metodat aktuale të adresimit të konfliktit të pavolitshëm.“²⁸ Kjo nënkupton, ndërmjetësimi nga një palë e tretë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes-konfliktit në mes palëve të përfshira në konflikt. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e

²⁵ L.C. Green, *The contemporary law of armed conflict*, Manchester, 1996, f.47.

²⁶ John Paul Lederach, *Building peace: sustainable reconciliation in divided societies*, Washington, 1997, f. 7.

²⁷ Agnesh Heler, *Vlerat dhe kërkesat*, Beograd, 1981.

²⁸ Stephen K. Erickson & Marilyn S. McKnight, *The Practitioner's Guide to Mediation: a klient-centered approach*, (Canada, 2001), fq. 3.

një mosmarrëveshje-konflikti ndërnjerëzor përveq anes profesionale dhe përfitimeve materiale, më shumë duhet kuptuar si një akt human dhe njerëzor, kur kihet parasysh se nëpërmjet punës dhe angazhimit si “ndërmjetës” në zgjidhjen e një mosmarrëveshje-konflikti, arrin të pajtos njerëz dhe përmes saj arrin ti shuash armiqësit të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë fatale për vetë njerëzimin.

Ndërmjetësimi për pajtim ka rëndësi të madhe morale, politike-kulturore, politikoshoqërore e së fundi, juridike e praktike. Konflikti është fakti, ajo që ndodh dhe që nuk perceptohet njësoj nga të dyja palët. Është e kuptueshme që perceptimi varet nga shumë faktor. Të tillë janë makro dhe mikro mjedisi në të cilin ai person është rritur, edukuar, stereotipe dhe paragjykime të caktuara, të formuara nga ajo përvojë vetjake, ose e jetës së të tjerëve, të tillë si prindërit, motrat, vëllezërit, të afermit, madje ndonjëherë edhe nga ata që duken pa ndikim në një moment të caktuar, por mund të kenë dhënë ndikimin e tyre në një deformim të caktuar²⁹

Ndërmjetësimi sipas Fjalorit të gjuhës Shqipe nënkupton, “Ndërmjetësim për pajtim. Ndërmjetësim për pushimin e zjarrit. Ndërhyej pranë dikujt për të arritur një marrëveshje, për një punë a për të zgjidhur diçka në dobi të një tjetri. Ndërmjetësuan për paqe (për marrëveshje). Ndërmjetësoj për ti pajtuar”³⁰

Kemi lloj-llojë mënyra për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve pozitivisht, para se të përdoren proceset formale apo ndërhyrja e palës së tretë. Mosmarrëveshjet apo pakënaqësitë duhet çdoherë të zgjidhen, me mirëbesim nga vetë redaktori ose redaktorët e shqetësuar duke shpjeguar atë që konsiderohet apo mendohet si jo e drejtë.

Për zgjidhjen e konfliktit gjithmonë jemi përpara dy rrugëve. Të zgjidhjes së konfliktit në mënyrë paqësore ose në kundërshtim me të parën është rruga e dytë, lufta. Praktika ka treguar se zgjidhja e konflikteve me mënyrën e parë, pra zgjidhjen paqësore të tyre, është kurdoherë rruga më e thjeshtë më ekonomike dhe si rrjedhojë më e drejtë. Ndërsa „zgjidhja“ me luftë për shumë

²⁹ Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale: Manual për Gjyqtar dhe Prokuror: Botim nga UNICEF, Komisioni Europian dhe Sida. Tiranë 2007, f. 44.

³⁰ Fjalor i shqipës së sotshme, ASHSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letrësisë, Tiranë, 2002, f.833-834.

autorë nuk është një zgjidhje, por thjesht një arsye për të nisur një konflikt. Për disa të tjerë një përfundim i keq.³¹

Konflikti në vetvete që nga momenti i lindjes dhe deri në mometin e shuarjes apo të transformimit në një konflikt tjetër kalon nëpër disa faza, të cilat janë:

- * **Faza e lindjes së konfliktit**
- * **Faza e zhvillimit të tij**
- * **Faza e rritjes apo e acarimit të konfliktit**
- * **Faza e zgjidhjes apo faza e transformimit të tij në një konflikt tjetër.**

Nuk mund të themi se të gjitha konfliktet në mënyrë të domosdoshme i kalojnë të gjitha këto faza gjatë zhvillimit të tyre. Shumë prej tyre paraqesin një pamje diqka më të ndryshme ngase thamë më lartë.

Faza e lindjes së konfliktit - i përgjigjet konfliktit kur interesat e palëve pjesmarrëse me konflikt ndeshen në mes tyre dhe kjo përplasje bëhet e dukshme për palët. Mardhëniet në mes tyre pësojnë ndryshime të dukshme, duke filluar nga shkalla më e lehtë në formën e mardhënieve të ftohta deri në mardhënie të tendosura. Që në këtë fazë mund të parashikohet rrjedhja e zhvillimit të konfliktit.

Faza e zhvillimit të konfliktit: - paraqet një pamje të ndryshme në varësi të llojit të konfliktit. Në këtë fazë bëhet publike ekzistenca e konfliktit dhe merret informacion mbi veprimet e palëve, me synim realizimin e interesave të tyre. Këto veprime shprehin qëndrimin e palëve ndaj konfliktit dhe, në një farë mënyre, në këto qëndrime pasqyrohen motivet dhe qëllimet e palëve në këtë konflikt.

Faza e acarimit apo kulmit të konfliktit; - është faza më e lartë e zhvillimit të konfliktit. Në këtë fazë përplasje e interesave dhe qëndrimeve është në shkallën më të lartë dhe shpeshherë është parrugdalje. Kjo fazë sjellë, në më të shumtën e rasteve, lindjen e një konflikti të ri të një natyre shumë më të ashpër me pasoja të rënda për palët.

³¹ Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë, 2003.

Faza e zgjidhjes apo e shuarjes së konfliktit; - nënkupton epilogun e konfliktit dhe ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve në mes palëve. Kjo fazë kushtëzohet nga ndikimi faktorëve frenues ose stimulues në konflikt.³²

Rreth fazës e zgjidhjes së konfliktit Bejtush Gashi thotë: „Faza e zgjidhjes nënkupton epilogun e konfliktit dhe ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve në mes palëve. Kjo fazë kushtëzohet nga ndikimi i faktorëve frenues ose stimulues në konflikt. Ndikimi i faktorëve frenues në konflikt bën të mundur që konflikti të mos shkojë drejt fazës kulmore të acarimit, por të zgjidhet që në fazat fillestare të lindjes apo zhvillimit të tij. Në të kundërtën, prania e faktorëve stimulues të konfliktit sjell acarimin e tij dhe në të shumtën e rasteve pamundësinë e zgjidhjes së tij. Mundësitë e zgjidhjes së konfliktit rriten vetëm duke hequr dorë nga mbivlerësimi i tyre duke synuar në: përpjekjet e përbashkëta për zgjidhje, moskëmbëngulja në pika standarde fikse (të qenit tolerant), gjetja e mundësive të zgjidhjes nëpërmjet realizimit të ideve e mendimeve të hedhura.“³³

Zgjidhja e konflikteve është koncept i cili mbështet aksione të shumta strategjike e politike, të cilat përpiqen ta parandalojnë shpërthimin, përshkallëzimin ose kthimin e konfliktit të dhunshëm. Diplomacia parandaluese mund të cakton dërgimin e diplomatëve të nivelit të lartë të një organizate rajonale ose ndërkombëtare, ose të një shteti të zonës në konflikt që tu ndihmojnë palëve në konflikt për t'i ndryshuar perceptimet dhe për të ndërmarr masa kundër përshkallëzimit të konfliktit në të cilin janë të përfshirë.³⁴

Sipas natyrës së konfliktit, nuk ka konflikte të mira dhe të këqija, destruktive ose konstruktive, por kjo do të varret nga forma e qasjes që do ta zgjedhin pjesëmarrësit për të zgjedhur mosmarrëveshjet dhe vet konfliktin. Në zgjidhjen e konflikteve mund të ketë disa qasje të rëndësishme:

1. Qasje destruktive: ndodhin kur mendojnë informacione, paraqitet mosbesim, dhunë, luftë etj.
2. Qasje konstruktive: shkëmbimi i informatave, njoftimeve, qëndrimi miqësor, krijimi i mirëbesimit

³²Gashi, Bejtush. Hidri, Pjetër, *Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike*, Prishtinë, 2008, fq. 15, 16, 20, 21.

³³ Bejtush Gashi, *Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike*, Prishtinë, 2008, fq. 21.

³⁴ Anthony Wanis St. John, *Nga menaxhimi me kriza deri në parandalimin e konflikteve*, Shkup, 2009, fq. 56.

3. Zgjidhja e konflikteve me anë të bisedimeve: si elemente në strukturën e bisedimeve mund të merren: vlerat, pozicionet, interesat, kërkesat dhe arritja e marrëveshjes.
4. Zgjidhja e konflikteve me ndërmjetësimin e palës së tretë. Ky proces zhvillohet në disa faza: përgatitja për fillimin e ndërmjetësimit, përcaktimi i çështjeve kontestuese, identifikimi i qartë i grupeve në konflikt, gjetja e zgjidhjes, propozimi i zgjidhjes, arritja e pajtueshmërisë, vëzhgimi i implementimit të marrëveshjes të arritur.³⁵

Me zgjidhje të vërtetë të konfliktit nënkuptojmë zgjidhjen e konfliktit me mënjanimin e plotë të shkaqeve të lindjes së konfliktit ndërmjet palëve. Kjo arrihet me bashkëpunim, që do të thotë se në vend të qasjes ndërmjet supozimeve se do të duhet të heqim dorë nga diçka, palët në konflikt do të bashkëpunojnë duke u përpjekur bashkërisht të zbulojnë se në çfarë mënyre mund të zgjidhet problemi, ndërsa asnjëra palë mos të jetë humbëse, por të dyjat të fitojnë. Gjatë një sjellje të tillë të palëve, konflikti nuk konsiderohet si problem i njërës palë, por ai shifet si problem i përbashkët i të dyja palëve.³⁶

Sipas sociologjisë bashkëkohore qytetare kemi disa mënyra për zgjidhjen e konflikteve. Mënyra e parë është arritja e marrëveshjes dhe pajtueshmërisë ndërmjet palëve të kundërshtuara. Secila nga ato, i respekton kërkesat dhe qëndrimet e kundërshtarit deri në maksimum. Kështu zgjidhja bëhet me respektimin e plotë të oponentëve.

Mënyra e dytë për zgjidhjen e konfliktit ka të bëjë me kompromisin. Në të tilla raste njëra nga palët në mënyrë vullnetare heq dorë nga një pjesë e kërkesave të veta, pasi që ndjenë dobësi dhe pamundësi të njëjtat t'i realizojë plotësisht. Atëherë pjesërisht tërhiqet, për t'i mos i humbur të gjitha.

Mënyra e tretë është ngushtë e lidhur me forcën e më të fortit. Ai me ndihmën e detyrimit, e sjellë anën më të dobët në situatë, që plotësisht t'i pranojë kushtet e tij. Shembull tipik janë konfliktet ekonomike në ndërrmarjet. Në kësi lloj rastesh shpeshherë punëdhënësit nëpërmjet llojeve të ndryshme të detyrimeve ju imponojnë kërkesat e tyre punëtorëve. Një situatë e ngjashme mund të paraqitet edhe në konfliktet politike. Pushteti aktual politik në një shtet, duke e përdorur pozitën e dominimit, opozitës mund t'i imponojë qëndrimet e veta. Mirëpo,

³⁵ Shih: Violeta Petroska Beshka, *Konfliktet*, Shkup, 1995, fq. 2-5.

³⁶ Nazmi Maliqi, *Toleranca politike në funksion të paqes*, Shkup, 2003, fq. 153-154.

mund të ndodh edhe rast i kundërt kur opozita në mënyrë të njëjtë, madje edhe me metoda më të vrazhda mund të rrënojë qeverinë e një shteti të caktuar.

Mënyra e katërt e zgjidhjes së konfliktit është e ashtuquajtura zgjidhje arbitrare. Kjo paraqitet atëherë kur palët në konflikt do të dakordohen për zgjidhjen e konfliktit, që të përfshihet pala e tretë, të jetë ajo në nivel të individit ose në nivel të komisionit. Megjithatë ana e tretë mund të përfshihet edhe pa pëlqimin e plotë nga dy palët e kundërshtuara. Kjo zakonisht paraqitet në momente kur ekziston rreziku për zgjerimin ekstrem të konfliktit, që mund të sjellë shumë pasoja të padëshiruara. Megjithatë si do që të jetë të dy palët fillojnë t'i njohin gabimet e tyre dhe mundohen të dalin nga situata e tillë e cila bartë karakteristika të paqartësisë dhe paprespektivës.³⁷

Gjatë zgjedhjes së strategjisë për zgjedhjen e ndonjë konflikti etnik, ndikim të caktuar ka pala e tret, ose siç e quajnë disa autorë, „mediatorët“. Në parim, rolin e ndërmjetësuesit mund ta luajë një njeri, ose një grup i përbërë nga disa profesionistë. Gjatë zgjidhjes së konflikteve etnike ndërshtetërore rolin e pales së tretë mund ta marrë një shtet i tretë.

Si duket, roli i pales së tretë në zgjidhjen e një konflikti të caktuar fsheh mjaft mundësi. Përfshirja e qëllimshme e pales së tretë rëndom lidhet me faktin se dy kundërshtarët I janë drejtuar për ndihmën asaj, ose këtë e kanë bërë vetëm njëra pale. Mund të përzihet edhe vetë pala e tretë në konflikt. Këto tri lloje të sjelljes së palvs së tretë shkaktojnë tri pasoja të ndryshme për zgjidhjen e konfliktit.

Më shpesh të dy palët në konflikt i drejtohen palës së tretë në raste kur:

- të gjitha argumentet, forcat dhe mjetet e të dyja palëve, të cilat marrin pjesë në konflikt, janë shterur dhe objekti i konfliktit është bllokuar;
- të dy palët këmbëngulin në pozicionet e tyre që janë me karakter kundërshtues të ndryshëm, të papajtueshëm dhe kanë interesa mjaft kundërshtues;
- normat e para lidhen të lidhura me rregullimin e konfliktit interpretohen në mënyra të ndryshme nga të dyja palët;

³⁷ Zoran Matevski, *Zgjidhja konstruktive e konflikteve*, Shkup, 2003, f. 48-49.

- kur njëres palë i janë shkaktuar dëme serioze ajo kërkon kompensime dhe kërkon sanksione kundër pales tjetër;
- për të dyja palët është me rëndësi t'i ruajnë marrëdhëniet e mira, por nuk kanë mundësi vetë të gjejnë rrugëdalje nga konflikti.³⁸

1.4. Roli i faktorit ndërkombëtarë gjatë procesit të negocimit

Në grupin e mjeteve diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, bëjnë pjesë: bisedimet, negocimi (ndërmjetësimi), shërbimet e mira, komisionet e hetimit dhe komisionet e pajtimit.

Mjet tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në mënyrë paqësore është edhe negocimi (ndërmjetësimi). Njëjtë sikurse „shërbimet e mira“, edhe te negocimi, kemi ndërhyrjen e një pale të tretë, e cila përpiqet që të ofrojë palët që të zgjidhin mosmarrëveshjen midis tyre. Në shikim të parë, negocimi duket i ngjashëm sikurse „shërbimet e mira“, mirëpo realisht ka dallime midis këtyre dy mjeteve, pasi te negocimi, roli i ndërmjetësuesit nuk konsiston vetëm në afrimin e palëve për t'u ulur në tryezën e bisedimeve, por ai me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes merr pjesë gjatë gjithë procesit të bisedimeve, madje duke u ofruar palëve, këshilla, sugjerime dhe propozime.

Në Fjalorin e Drejtësisë të Universitetit të Oksfordit jepet ky përkufizim për negocimin: metodë për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilën një palë e tretë vepron me pëlqimin e shteteve të përçara dhe në mënyrë aktive merr pjesë gjatë procesit të bisedimeve, duke ofruar sugjerime thelbësore në lidhje me kushtet e zgjidhjes dhe në përgjithësi duke u përpjekur për të pajtuar kërkesat e kundërta, gjithmonë duke u munduar që mos ngjallë ndonjë pakënaqësi midis palëve.³⁹

³⁸ Stojanoski, Nelko; Gjurovska, Mileva; Matevski, Zoran, *SOCIOLOGJIA* për vitin e III të gjimnazit të reformuar, Prosvetno Dello, Shkup, 2004, f.126.

³⁹ A Dictionary of Law, University press. Oxford, 2009, f. 348.

Negociatat janë forma të bisedimit, komunikimit dhe dialogut dy ose shumëpalësh për zgjidhjen e problemeve të çfarëdolloji. Negociatat janë të vjetra sa edhe vetë historia e njerëzimit. Negociatat janë në natyrën njerëzore të zgjidhjes së problemeve, janë rruga më e drejtë për kapërcimin e kontradiktave, mospërputhjeve apo divergjencave të ndryshme, janë afrimi drejt zgjidhjeve që ofrojnë palët e ndryshme apo të kundërta drejt një kompromisi që pranohet prej tyre dhe që prodhon marrëveshjen më të qëndrueshme. Negociatat janë rruga më e mirë drejt kompromisit. Ato janë mekanizmi për shmangien e thellimit të problemeve, të kontradiktave apo konflikteve, janë zgjidhja që prodhojnë më së shumti fitues dhe më së paku humbës. Negociatat burojnë nga nevoja për mirëkuptim njerëzor dhe shpjen në zgjidhje mirëkuptimi. Negociatat rrjedhin nga nevoja për paqe dhe prodhojnë paqe. Ato vijnë nga domosdoshmëria për zgjidhje të çfarëdolloj problemi midis palësh, me anë të bisedimeve, këmbimit të ideve, informacioneve, dhënies së propozimeve të nxitjes mbi bazën e tyre të dialogut dypalësh apo shumëpalësh.

Duke buruar nga natyra njerëzore, negociatat janë pjesë e sjelljes dhe e veprimit njerëzor. Gjithë njerëzit negociojnë mes tyre, fillojnë negociatat brenda familjes, shtrihen në mardhënieshoqërore, profesionale, biznesi, politike e mardhëniesh ndërkombëtare. Në kuptimin filozofik por edhe praktik, gjithë njerëzit janë negociator për aq kohë sa përballen me probleme që kërkojnë zgjidhje me të tjerët, me anë të bisedave, këmbimit të mendimeve, dialogut dhe polemikave, në mënyrë sa më mirëkuptuese, paqësore dhe kompromisi. Si një element zgjidhjeje problemesh, me anë të bisedimeve, dialogut debatit që prodhojnë marrëveshjen midis palëve të ndryshme, konkurruese, rivalizuese apo kontradiktore, negociatat reflektojnë në evoluimin e vet shkallën e zhvillimit të njerëzimit, të shoqërisë dhe të institucioneve të krijuara prej saj në nivele kombëtare apo ndërkombëtare.

Sa më i lartë civilizimi njerëzorë dhe institucional aq më shumë rritet prania, përdorimi dhe vlerësimi i negociatave. Negociatat janë kështu, një tregues shumë domethënës i pjekurisë së shoqërisë njerëzore dhe institucioneve të krijuara prej saj. Niveli i ulët i pranisë, përdorimit dhe vlerësimit të negociatave shpreh nivelin e ulët të emancipimit, të civilizimit dhe të institucioneve të një shoqërie të caktuar apo të një sistemi mardhëniesh ndërkombëtare. Njerëzimi ka arritur duke e çmuar përherë e më shumë rëndësinë e negociatave për katër arsye kryesore. Së pari, negociatat prodhojnë zgjidhjen më të mirë, sepse shmangin zgjidhjet konfliktuale; Së dyti janë

zgjidhja më e shpejtë, sepse zgjidhjet e tjera nëpërmjet konflikteve shtyjnë shumë atë ; janë zgjidhja me koston më të lirë e të favorshme sepse zgjidhjet e tjera kanë kosto pakrahasimisht më të lartë dhe më të shtrejtë, duke përfshirë jetët njerëzore, dëmet kolaterale dhe humbjet financiare; Së katërti prodhojnë zgjidhje më të qëndrueshme.

Përse negociatat prodhojnë zgjidhjen më të mirë? Negociatat vijnë mbas lindjes dhe përkeqësimit ose komplikimit të një problemi midis minimalisht dy palëve. Ato janë rezultat i një procesi paraprak komunikimesh, bisedimesh dhe dialogu, e si të tilla përbëjnë shkallën më të lartë të zgjidhjes së problemeve nëpërmjet arsytimit njerëzorë. Në negociata udhëheqë aryja mbi gjithqka. Arma në negociata janë argumentet, faktet, të dhënat, aktet ndërkombëtare. Pra të dhënat, faktet, aktet-ja se cilat janë armët e përdorura në negociata. Nga arsytimi, njerëzimit nuk i ka ardhur kurrë e keqja. Aryetimi prodhon zgjidhje racionale, logjikisht të pranueshme, moralisht të mira dhe juridikisht të drejta. Përse negociatat prodhojnë zgjidhje më të qëndrueshme dhe afatgjata? Negociatat prodhojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata sepse ato janë kompromis midis palëve dhe jo imponim midis tyre. Duke qenë kompromis, në vetvete negociatorët bëjnë konçensione reciproke dhe arrijnë benefite reciproke. Produkti më i mirë i negociatave është ai që quhet në gjuhën negociatore « win/win result », pra rezultat vetëm me fitues.

Zgjidhja me negociata eviton daljen e proceseve jashtë kontrollit dhe përfshijnë në to të turmave apo dukurive të rrugës. Dalja jashtë kontrollit sjell humbje kohe. Ka faturë të lartë shpenzimesh. Gjithashtu hyrja në valle, e rruga me gjithë konçeguencat e saj, shoqërohet gjithnjë me probleme që shkaktojnë dëme të natyrave të ndryshme. Dëmet janë kosto e paparashikueshme dhe që mund të mos sjellë kurrfarë dobie në zgjidhje, veçse e komplikon dhe vonon atë.

Negociatat evitojnë zgjidhjet me anë të sanksioneve ekonomike e penaliteteve të ndryshme. Sanksionet dhe penalitetet e ndryshme janë provuar që kanë kosto shumë të lartë. Madje, çfarë është më paradoksalja, sanksionet i paguajnë gjithnjë më shumë sesa thjeshtë autorët dhe shkaktarët e problemeve apo krizave. Me rastin e divorcit familjar, sanksionet dhe penalitetet i paguajnë jo vetëm prindërit që janë shkaktarët e tijë, por edhe fëmijët që janë viktima të pafajshme. Pra, siç shihet, sanksionet dhe penalitetet e ndryshme jo vetëm që kanë kosto shumë më të lartë se negociatat, por e keqja më e madhe e tyre është se faturën e lartë e

paguajnë edhe faktorët që nuk janë shkaktarë real të problemeve, krizave dhe të injorimit të negociatave për zgjidhjen e tyre.⁴⁰

Tipat dhe llojet e negociatave - Gjatë historisë së tyre negociatat janë zhvilluar pandërprerë. Në kohët tona, ato kanë arritur të konturojnë tipet dhe llojet kryesore të tyre. Tipet dhe llojet e negociatave janë formëzuar në varësi të natyrës së problemeve dhe krizave që negociatat kanë pasur në qendër, në varësi të numrit të palëve pjesëmarrëse në negociata, në varësi të strukturës së negociatave sikundër edhe në varësi të modelit të zgjidhjes që ato kanë prodhuar.

Tipet e negociatave dallohen nga numri i palëve pjesëmarrëse biseduese në to. Deri në kohët tona janë formësuar katër tipe negociatash;

- a) negociatat dypalëshe
- b) negociatat shumëpalëshe
- c) negociatat e përziera
- d) negociatat paralele.

Negociatat dypalëshe kanë të bëjnë me bisedime midis dy subjekteve të cilat kanë probleme ose kriza për të zgjedhur ndërmjet tyre. Si të tilla, negociatat dypalëshe janë më të thjeshta dhe më të menaxhueshme. Këto ndiqen kur palët kanë qartësinë e duhur të problemeve dhe krizave ndërmjet tyre, kanë besueshmërinë e mjaftueshme që i shpie drejt bisedimeve, disponojnë aftësinë e plotë që nëpërmjet dialogut që arrijnë në një zgjidhje të pranueshme për palët dhe kanë, padyshim mbi të gjitha, vullnetin për t'i zgjidhur problemet vetë ndërmjet tyre pa involvuar subjekte të tjera në to.

Negociatat shumëpalëshe kanë lindur më vonë se negociatat dypalëshe. Ato janë produkt i një shkalle më të lartë të zhvillimit njerëzorë, shoqëror e shtetëror dhe të sistemeve më të avansuara të mardhënieve ndërkombëtare. Negociatat shumëpalëshe burojnë nga ekzistenca e problemeve apo krizave, të cilat ose e kanë origjinën në më shumë se dy subjekte, ose pasoja e atyre problemeve apo krizave prek dhe rrezikon më shumë se sa interesat e thjeshtë dy

⁴⁰ Bashkurti, Lisen *Negociatat, Historia, teoria, praktika*, Tetovë, 2010, f. 419-427.

subjekteve problematike. Si të tilla, negociatat shumëpalëshe janë shumë më komplekse, më të vështira dhe më të ndërlikuara për tu menaxhuar dhe arritur në marrëveshje.

Negociatat shumëpalëshe preferohen në disa raste : në rastet kur problemet e shkaktuara nga një palë, dy palë apo më shumë palë implikojnë edhe shumë subjekte të tjera ; kur zgjidhja që synohet me anë të negociatave do të ishte më efektive dhe e garantuar nëse vendoset nga më shumë sesa palët e drejtëpërdrejta të implikuara në problem ose në krizë ; kur efekti i marrëveshjes, në një mënyrë apo tjetër lidhet me interesat e shumë subjekteve të tjera ose kur një objekt problematik dypalësh, për arsye të mungesës së qartësisë së palëve, të skepticizmit midis tyre, të tensionit ekzistues, të paaftësisë negociuese ose edhe të mungesës së vullnetit, lind nevojën e negociatave shumëpalëshe, me qëllim që të përfshihen në zgjidhjen e problemeve ose krizës si dhe në dhënien e garancive për zbatimin e marrëveshjes, më shumë sesa dy aktorë problematike. Negociatat shumëpalëshe e kanë të vështirë arritjen e marrëveshjes, sepse kanë të bëjnë më shumë subjekte, vlera dhe interesa, të cilat në diversitetin e tyre vështirësojnë konsensusin ose marrëveshjen e pranuar përgjithësisht. Por, ashtu sikundër negociatat shumëpalëshe e arrijnë me më vështirësi marrëveshjen. Po ashtu, të vështiruara nga pikëpamja e efektshmërisë dhe e garancive për zbatimin e marrëveshjeve, ato mund të quhen shumë më të efektshme dhe më garantuese.

Negociatat e përziera: Krahas negociatave thjeshtë dypalëshe dhe thjeshtë shumëpalëshe, në historinë e negociatave ka ndodhur në jo pak raste të ndeshim procese negociatash që janë të përziera ose që konvertohen në procese të sipër. Pra, ka mjaft raste kur negociatat nisin si dypalëshe e më tej vijnë shumëpalëshe. Ka raste kur negociatat nisin shumëpalëshe dhe më pas vijnë të reduktohen në dypalëshe. Gjithqka në këtë komplikim të tipit të negociatave e kushtëzon ecuria e procesit negociator, natyra e problemit apo krizës dhe vetë negociatorët.

Në rastin kur negociatat nisin dypalëshe dhe bllokohen për shkak të tensionit, paaftësisë, mungesës së besimit ose të vullnetit për të çuar procesin e bisedimeve përpara nga të dy palët, atëherë lind nevoja e zgjerimit të pjesëmarrësve në proces. Ndërrimi i tipit të negociatave nga dypalëshe në shumëpalëshe i shërben në këtë rast zhbllokimit të procesit negociator dhe mund të konsiderohet i domosdoshëm dhe i dobishëm.

Negociatat paralele : Kemi atëherë kur për të njëjtin problem apo krizë, krahas negociatave dypalëshe zhvillohen edhe negociata paralele rreth të njëjtit problem apo të njëjtës krizë. Kjo do të thotë se për një problem apo krizë të caktuar negociojnë dy palët direkt të involvuara, por krahas tyre dhe në mbështetje të tyre mbi të njëjtin objekt negociatash, themeluara posaçërisht për të përcjellur ecurinë, fazat dhe zgjidhjen e negociatave dypalëshe dhe për të ndikuar në marrjen e vendimit përfundimtar. Në jo pak raste negociatat zhvillohen paralelisht midis dy subjekteve të involvuara në një problem apo krizë të caktuar dhe strukturave ndërkombëtare shumëpalëshe që mbulojnë këtë lloj problematike, në sistemin e organizatave ndërkombetare.⁴¹

Klasifikimi i negociatave

Në librin e tij “Si negociojnë kombet”, Fred Ikle bën klasifikimin e negociatave ndërkombëtare sipas qëllimeve të palëve për arritjen e marrëveshjes. Në mes tyre në vend të parë janë:

- **Marrëveshjet për vazhdimësi:** Qëllimi i tyre është që ta vazhdojnë gjendjen momentale të punëve. Si të tilla marrëveshjet shpesh herë ndodhë të jenë rutinore.
- **Marrëveshjet për normalizim:** Ky lloj është i paraparë për tejkalimin e ndonjë konflikti, p.sh. marrëveshjet për ndërprerjen e zjarrit, marrëveshjet paqësore apo rivendosja e marrëdhënieve diplomatike. Qëllimi i bisedimeve që i paraprijnë është normalizimi që mund të involvon shkallë të lartë të rishpërndarjes.
- **Në negociatat për rishpërndarje:** Kërkohen ndryshime në status quo apo në arazhmane momentale, p.sh. në lidhje me kufijtë territorial, fuqitë e votuesve në ndonjë institucion ndërkombëtar, kontributet e buxhetit dhe për qështje të tjera.
- **Marrëveshje inovative:** Këtu palët tentojnë të japin grupe të ndryshme të obligimeve apo marrëdhënieve për bartjen në shkallë të caktuar të politikës dhe forcës së drejtë të institucioneve joshitetore, planifikimi i institucioneve të reja, apo institucionet për bashkëpunim. Marrëveshja kinezo-britanike e vitit 1984 për ardhmërin e Hon Kongut paraqet shembull interesi për marrëveshjen e normalizimit dhe inovacionit, duke

⁴¹ Po aty, fq. 419,420,421,422,425,426,427.

ekspozuar statusin dhe autorizimin e Honkongut, që me 1997 do të shpallet rajon i posaqëm administrativ i Republikës Popullore të Kinës.

- **Negociatat për efektet anësore:** Në këtë lloj të negociatave një apo më shumë palë mund të kenë qëllime që nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me arritjen e marrëveshjes. Ato mund të përfshijnë deklarata të regjistruara për qëndrim të caktuar, propaganda mbledhje të informacionit për pozitën negociuese, për palët e forta dhe të dobëta në anën tjetër apo për diskreditim të vendimit të kundërshtarit.

Këto kategori sigurojnë klasifikim themelor të negociatave, të cilët mund të përdoren edhe për rishikimin e ndryshimeve të marrëdhënieve mes shteteve, grupeve apo palëve. Kuptohet, kategoritë e mësipërme paraqesin lloje ideale, sepse në praktikë negociatat shpeshherë janë të një karakteri ‘të përzier’ dhe kanë elemente të tregëtis së pastër.⁴²

Fazat \ etapat e procesit të negociatave

Modeli themelor sipas së cilit konceptohen negociatat dypalëshe dhe shumëpalëshe është modeli sipas të cilit negociatat shikohen si progres me çrast palët mirren vesh për rendin e ditës, në pika të shkurtëra i paraqesin dhe i hulumtojnë qëndrimet fillestare dhe kërkojnë kompromis me qëllim që ta zvogëlojnë ndarjen mes qëndrimeve deri sa të vijnë në pikën e konvergjencës, e cila krijon bazën për marrëveshjen e vërtetë.

John E. Barston në librin e tij “Modern Diplomacy” e paraqet këtë model themelor me anë të skemës në vijim duke e ndarë procesin e negocimit në nënte faza:

1. Faza përgaditore:

- i. përgaditja e qëndrimit të etnitetit/grupit;
- ii. marrëveshje për vendin e takimit;
- iii. përmbajtje e shkurtër e rendit të ditës;
- iv. niveli në të cilin bëhen negociatat.

⁴² Latifi, Veton, *Negocimi si teknikë parësore për zgjidhjen e konflikteve, Zhvillimi i Negociatave 2*, Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Mardhënie Ndërkombëtare, 2007, fq. 29,30.

2. Faza hyrëse(procedurale):

- i. vërtetimi i palëve të akredituara;
- ii. përsëri vërtetimi i qëllimit dhe statusi i bisedimeve
- iii. dokumentacioni punues
- iv. procedura e punës:
 - a) ndërprerje(nëse ka);
 - b) gjuha që do të shfrytëzohet;
 - c) të drejtat procedurale;
 - d) dekordim se cili tekst apo projekt;
 - e) a do të ketë procesverbal me pëlqim.

3. Faza hyrëse (esenca):

- i. vërtetimi apo plotësimi i rendit të ditës
- ii. diskutim për qëndrimet fillestare

4. Faza esenciale:

- i. hulumtimet e rajoneve ku ka ndryshime
- ii. formimi i rajoneve për marrëveshje

5. Shtyrja e negociatave për raundin tjetër të negociatave (nëse është e arsyeshme)

6. Arritja e marrëveshjes kornizë

7. Pastrimi i drejtë i tekstit dhe propozim -amandamentet tjera

8. Pranimi apo nënshkruajtja e marrëveshjes finale

9. Deklaratë për punën ose komunike.

Ky model shërben si model bazë për proceset e negociatave të shumë negociimeve dhe proceseve paqësore anekënd botës, sidomos vlenë si një model standard dhe universal për negociata për ndërprerjen e konflikteve.

Etapat e zhvillimit të negociatave

Etapa I –Përgaditore

1. Zgjidhja e qasjes së bisedimeve
2. Analiza e nevojave dhe interesave:
 - në lidhje me objektin
 - në lidhje me mënyrat
 - në lidhje me mardhëniet ndërnjerëzore
3. Sigurimi i informative
4. Formimi i ekipit
5. Precizimi se qka do të bisedohet

Etapa II –Zhvillimi i negociatave

1. Vënia e rregullave të qarta
2. Identifikimi i problemit –paraqitja e interesave, kriterëve, dhe llojet e zgjidhjes

3. Taktikat për negociata

- arritja e përparësisë në llogari të shfrytëzimit të forcës së kundërshtarit nëpërmjet mosvërtetimit të qëndrimit të pritur stereotip
- ballafaqimi me potezat e papastërta të palës tjetër
- ndarja e njerezve nga problemet

Etapa III –Sjellja e vendimeve

1. Formulimi i qartë
2. Precizimi i afateve
3. Njerëzit

Ky model është në një formë më të shkurtër dhe më të thjeshtë në shikim të parë nga modeli i Barstonit. Megjithatë, numri më i vogël i etapave në këtë rast nuk paraqet gjithnjë indikatorë tipik për nivelin e kompleksitetit dhe zbatueshmërisë së një modeli të procesit të negociatave. Pamarrë parasysh se cili model i fazave të procesit të negociatave merret parasyshë mes tyre ka përputhshmëri të theksuara në fazat kryesore. Edhe në të dy modelet e mësipërme faza fillestare apo përgaditore e negociatave mund të merr shumë kohe, p.sh. dilemat për zgjidhjen e palëve që duhen të marrin pjesë në negociata.

Praktika e negocimit dhe proceseve të zgjidhjeve paqësore sygjeron që proceset negociuese shpeshherë të fillojnë me të ashtuquajtura bisedime preliminare. Qëllimi i këtyre bisedimeve është që të vërtetohet apo testohet nëse negociatat që pritet të pasojnë janë potencialisht të dobishme.⁴

Kur flasim për negocimin, si një lloj i veçantë në një proces të bisedimeve me anë të të cilit mundësohet që palët të arrijnë të zgjidhin një mosmarrëveshje, nuk duhet lënë anësh dhe roli që luan apo ka pala e tretë në këtë proces. Në të vërtetë, roli i palës së tretë është tepër i rëndësishëm dhe ajo gjatë gjithë procesit është pjesë aktive dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe e përfshirë në mosmarrëveshjen mes palëve. Negocimi, mund të ofrojë një shtet ose disa shtete. Edhe organizatat ndërkombëtare si OKB, po edhe organizatat regjionale, mund të jenë si ndërmjetësues për zgjidhjen paqësore të një mosmarrëveshje ndërkombëtare.

Ndërmjetësuesi, i cili do të angazhohet në një proces për të ofruar ndihmën e tij, duhet të ketë shumë kujdes në mënyrë që të përmbushë misionin që i është besuar. Në këtë drejtim, ai duhet të jetë i paanshëm në konfliktin midis palëve dhe të mos favorizojë asnjërën palë gjatë përpilimit të agjendës. Misioni i ndërmjetësuesit është që të mundohet, me anë të këshillave, propozimeve, të ofrojë që palët të arrijnë deri te zgjidhja. Në bazë të kësaj që nënvizojmë shihet qartë se ndërmjetësuesi, qëllim kryesor ka arritjen e një marrëveshje midis palëve në konflikt. Pala e tretë, do të konsiderohet se ka qenë e suksesshme, nëse arrin që palët të arrijnë marrëveshje. Kjo mund të arrihet, nëse ndërmjetësuesi, përpiket në bisedime herë me njërën palë dhe herë me palët tjetër, të gjejë atë që konsiderohet e pëlqyeshme për ato. Nga kjo që theksuam, vërejmë se roli i ndërmjetësuesit është një detyrë e vështirë. Në anën tjetër, kjo nuk do të thotë se nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, se ndërmjetësuesi ka qenë i keq ose se ndërmjetësuesi nuk ka qenë shumë aktiv në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje. Praktika e së

drejtës ndërkombëtare njeh raste ku kemi pasur ndërprerje të bisedimeve midis dy shteteve edhe pas përpjekjeve shumë serioze të një shteti ose organizate ndërkombëtare.

Kështu, gjashtë shtete evropiane dhe Papa, kanë provuar të negocojnë midis SHBA-ve dhe Spanjës në vitin 1898, por nuk kanë pasur sukses; Holanda ka refuzuar negocimin e Kinës në konfliktin holandezo-indonezian më 1947; Britania e Madhe ka refuzuar propozimin amerikan për negocim në konfliktin rreth kufijve midis Hondurasit Britanik dhe Guatemalës më 1948; India ka refuzuar ofertën e Australisë për negocim në konfliktin midis Indisë dhe Pakistanit; Siria ka kërkuar nga mbreti saudit Ibn Saudi ta tërheqë ofertën e negocimit përkitazi me mosmarrëveshjen midis Sirisë dhe Turqisë, më 1957.⁴³

Gjatë vitit 2008, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, duke folur për rëndësinë që ka negocimi në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, kërkonte nga Asambleja e Përgjithshme dhe KS sigurimin e mjeteve të duhura, me qëllim që të rritet roli i negocimit nëpërmjet OKB-së. Gjithashtu, ai theksoi se përvoja tregon se përpjekjet efektive nëpërmjet negocimit të koordinuar, kishin rezultuar të suksesshme në ndërtimin e paqes dhe ruajtjen e saj.⁴⁴

⁴³ Zejnulla Gruda, *E drejta nderkombetare publike*, Prishtinë, 2002, f. 418.

⁴⁴ <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=28189&Cr=ki-moon&Cr1>

2. KONFLIKTI NË IRLANDËN E VERIUT

Në zemër të problemeve në Irlandën e Veriut është mosbesimi. Konflikti me shekuj ka gjeneruar urrejtje që e kanë bërë praktikisht të pamundur për të dy komunitetet t'i besojnë njëri tjetrit... Nëse ka ndonjëherë paqe të qëndrueshme dhe pajtim të vërtetë, ajo që është me të vërtetë e nevojshme është çmontimi i mentalitetit në Irlandën e Veriut... besimi duhet të ndërtohet me kalimin e kohës nga veprimet në të gjitha pjesët e shoqërisë. (Senator George Mitchell, 1999)

2.1. Irlanda e Veriut si pjesë përbërëse e Mbretërisë së Bashkuar

Para se të flasim për Irlandën e Veriut si pjesë përbërëse e Mbretërisë së Bashkuar e shoh të udhës të bëj një paraqitje të shkurtër për Mbretërinë e Bashkuar.

Mbretëria e Bashkuar është një ndër shtetet më të zhvilluara të Evropës perëndimore, me sipërfaqe tokësore prej 242,500 km². Pra, Mbretëria e Bashkuar është monarki kushtetuese me sistem parlamentar qeverisës.⁴⁵ Monarku është Mbretëresha Elizabet II, e cila ka mbretëruar që nga 6 shkurti i vitit 1952. Kryeqyteti i Mbretërisë së Bashkuar dhe qyteti më i madh i saj është Londra, një qytet global dhe qendra financiare me një sipërfaqe të popullatës urbane prej 10.3 milion banorë, qyteti i katërt më i madh në Evropë dhe i dyti në Bashkimin Evropian.⁴⁶

Sipas *The national archives, Countries within a country*, e botuar më vitin 2003, do të shkruhej: „Fusha tjera të mëdha urbane në Mbretërinë e Bashkuar përfshijnë rajonet e Birmingamit, Leeds, Glasgow, Liverpulit dhe Mançesterit. Mbretëria e Bashkuar përbëhet nga katër vende (shtete): Anglia, Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut.“⁴⁷

⁴⁵ <https://www.royal.uk/role-monarchy>

⁴⁶ *United Nations, Population Division*, UN, 2014

⁴⁷ *The national archives, Countries within a country*, 2003

Ndërsa, Irlanda e Veriut u bë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1801.⁴⁸ Irlanda Veriore dallon nga pjesët tjera përbërëse të Mbretërisë së Bashkuar pasi që është i vetmi vend në të që ka kufi tokësor me Republikën e Irlandës. Shtrihet në veri lindje të Republikës së Irlandës me sipërfaqe prej 14.139 km².

Për numrin e popullsisë së Irlandës si burim më të saktë do të bazohem tek Agjencioni i statistikave të bëra në vitin 2011, ku thuhet se: „popullsia e Irlandës së Veriut ishte 1.810.863.“⁴⁹

Irlanda e Veriut përbëhet prej gjashtë bashkive nga nëntë komunat e Ulster-it (kryesisht protestante). Si njësi administrative e Britanisë së Madhe, Irlanda e Veriut u përcaktua nga Akti i Qeverisë së Irlandës të vitit 1920, dhe ka pasur formën e vetëqeverisë të ngjashme me Uellsin dhe Skocin.⁵⁰

Belfasti kryeqyteti i Irlandës së Veriut është qytet i ndarë ku edhe dallohet qartë ndarja fizike ndërmjet katolikëve dhe protestantëve.

Siç theksuam edhe më lartë se Mbretëria e bashkuar është Monarki Kushtetuese ku kreu i shtetit është Mbretëresha Elizabeta II; Monarku i Britanisë shërben si kreu i shtetit i pesëmbëdhjetë vendeve të tjera të Komonwealthit, duke e vënë Britaninë e Madhe në një bashkim personal me këto vende. Sidoqoftë, Parlamenti Britanez ka autoritet të nxjerr ligje për këto hapësira të kufizuara, kurse Qeveria Britaneze mban kujdes për politikën e jashtme gjithashtu edhe për mbrojtjen e tyre.

Demografia e Irlandës së Veriut është interesante. Katolikët hyrën në tranzicionin demografik 60 deri 80 vjet pas protestantëve. Mësimet tradicionale katolike mbi kontrollin e lindjes si dhe varfëria rurale dhe nivelet më të ulëta të arsimimit të femrës sollën deri në këtë ndryshim. Megjithatë, edhe pse ata përbënin vetëm 35% të popullsisë së Irlandës së Veriut, katolikët përbën 60% të emigrantëve të tyre.⁵¹

Protestantët vepruan në disa fusha për ta bërë jetën e katolikëve më të vështirë, të cilët inkurajuan emigracionin. Në organizatat bazë, protestantët u përpoqën për të parandaluar që

⁴⁸ <http://www.economist.com/blogs/economist-explains/2013/11/economist-explains-4>

⁴⁹ <https://www.nisra.gov.uk/statistics/population>

⁵⁰ *The Northern Ireland Act*, UK, 1998

⁵¹ *The conflict in Northern Ireland: Demographic and economic considerations*, Sri Lanka, International Centre for Ethnic studies, 1991, f.16-47

tokat dhe shtëpите e tyre tu shiten katolikëve. Ata që e bënë një gjë të tillë u ballafaquan me sanksione nga ana e komunitetit. Aty ku protestantët ishin pakicë nëpër qarqet kufitare hapën një fond për blerjen e tokave për protestantët. Kjo vazhdon edhe sot e kësaj dite. Skema ka filluar në vitin 1938 në Fermanagh, një qark kufitar me përzierje të popullatës katolike dhe protestante – dhe u kopjua shume shpejt nëpër shumë vende të Irlandës së Veriut.⁵²

Saj përket politikës së Irlandës së Veriut ka shruajtur edhe Tom Gallagher në librin e tij me titull „James O’Connell, Contemporary Irish Studies“, ku thotë: *Ndarja kryesore politike e Irlandes së Veriut është ndërmjet Unionistëve, që dëshirojnë ta shohin Irlandën Veriore në vazhdimësi pjesë përbërëse të Mbretërisë së Bashkuar, dhe nacionalistët, që dëshirojnë që Irlandën e Veriut të bashkuar me Republikën e Irlandes, pavarësisht nga Mbretëria e Bashkuar. Këto dy pikëpamje të kundërta janë të lidhura me ndarjet e thella kulturore. Unionistët janë kryesisht Ulster Protestant, pasardhës të kolonëve skocez, anglez, huguenot, si dhe gaels që u konvertuan në një prej besimeve protestante. Nacionalistët janë shumicë dërmuese katolike.*⁵³

Skema kauzale e konfliktit në Irlandën e Veriut (shkak – pasojë)

1. Besnikëri e ndarë

Dallimet në bindjet politike. Shumica e protestantëve e shohin veten dhe shetin e tyre si pjesë përbërëse të Mbretërisë së Bashkuar. Katolikët e shohin veten e tyre si irlandez dhe duan të bashkohen me Republikën e Irlandës. Kjo besnikëri ndaj shteteve të ndryshme i bën protestantët dhe katolikët jotolerantë ndaj njëri tjetrit.

2. Ndarje e pabarabartë e banimit

Ndarja jo e drejtë e banimeve publike nga ana e Këshillit të Qytetit (shumica protestantë). Katolikët konsiderojnë se një gjë e tillë e bërë nga ana e Qeverisë është e padrejtë. Në disa qytete më shumë shtëpi u jepen protestantëve se sa katolikëve.

⁵² Grand Orange Lodge of Ireland (GOLI) report, 1996, f.16.

⁵³ Tom Gallagher, *James O’Connell, Contemporary Irish Studies*, University of Bradford, 1983

3. Mundësi punësimi i pabarabartë

Shumë më e vështirë për katolikët e Irlandës së Veriut të gjejnë punë, veçanërisht në sektorin qeveritar. Katolikët i kanë të gjitha kualifikimet e njëjta me protestantët por mundësi të pabarabarta.

4. Mungesë e të drejtës për votë

Para vitit 1969, e drejta për të votuar ka qenë një çështje në mes protestantëve dhe katolikëve. Në atë kohë, vetëm ata që kanë poseduar shtëpi dhe biznese kanë qenë të lirë të votojnë në nivel lokal. Megjithatë shumë kompani kanë qenë në pronësi të protestantëve të pasur që gjithmonë në zgjedhje kanë dalur fitues.

5. Mungesë e mundësive për ndërveprim social

Sistemi arsimor në Irlandën e Veriut, protestantët dhe katolikët nuk mësojnë sëbashku në shkollat e njëjta. Protestantët mësojnë kryesisht në shkolla publike të financuara nga qeveria përderisa katolikët pjesërisht të financuara nga ana e qeverisë. Që nga shekulli XVII, protestantët dhe katolikët jetojnë në vendbanime të ndara.

2.2 Fillesat e konfliktit në Irlandën e Veriut

Për ta kuptuar zanafillën e konfliktit në Irlandën e Veriut duhet të kthehemi në histori ku gjendet spjegimi për trazirat, një ndër konfliktet më të vështira për tu zgjedhur edhe në kohrat e sotme.

Bazën e historisë së Irlandës Veriore e përbëjnë konfliktet me fqinjin e vet Anglinë, lufta e irlandezëve për pavarësi nga pushteti anglez. Kjo luftë për liri zgjati 750 vjet. Filloi në

shekullin XII me pushtimet e para anglo-normandike dhe zgjatën deri në themelimin e shtetit të lirë irlandez në vitin 1922.⁵⁴

Sipas Jonathan Tonge: „Në Irlandë katolikët janë pjesë dërmuese e popullatës, ndërkaq protestantët janë pakicë. Në Irlandën Veriore protestantët janë shumicë, ndërkaq katolikët pakicë, që janë akoma të lënë pas dore dhe llogariten si shtresë e dytë në vendin e tyre. Dëshira e madhe e katolikëve për tu bashkuar me Republikën e Irlandës që të mos vazhdojnë edhe më tej të janë të dëmtuar si pakicë është e pamundur pasi që shumica protestante e Irlandës së Veriut nuk e dëshiron një gjë të tillë pasi që janë ngushtë të lidhur me Mbretërinë e Bashkuar, Unionin. Për këtë arsye ata edhe quhen unionistë, ndërsa katolikët nacionalistë.“⁵⁵

Një ndër konfliktet më të gjata në Evropë, që ka filluar që nga shekulli XII kur Irlanda humbi pavarësinë e vet. Viti 1171 shënon edhe fillimin e kryengritjeve të pandalura të irlandezëve kundër regjimit britanik. Ekzistonte frika e madhe e britanikëve se ndoshta Irlanda do të shfrytëzohej nga vendet tjera e sidomos nga Franca si portë hyrëse për ta sulmuar Britaninë e Madhe. Në vitin 1916 ka filluar lufta qytetare ndërkaq në vitin 1921 anglezët pëfundimisht e ndajnë Irlandën në dy pjesë: në Republikën e Irlandës si shtet të pavarur me 90% katolik dhe Irlandën e Veriut me shumicë protestante e cila mbetet pjesë e pandashme e Britanisë së Madhe. Por, edhe më tej konflikti i përgjakshëm në Irlandën Veriore vazhdon pasi që pakica katolike diskriminohet në vazhdimësi nga shumica protestante në shumë sfera shoqërore duke filluar nga: arsimi, shëndetësia, punësimi, përbërja e deputetëve në parlament etj. Ky ishte edhe fillimi për irlandezo-veriorët të shprehnin haptazi dëshirën dhe qëllimin e tyre për tu bashkuar me Republikën e Irlandës.

Në konfliktin e zhvilluar ndërmjet dy etnive më të mëdha të Irlandës së Veriut ekzistonin edhe formacionet e tyre paraushtarake: katolikët kishin armatën republikane irlandeze – IRA, ndërkaq protestantët kishin disa prej tyre siç ishin: forcat vullnetare të Ulsterit, shoqatën mbrotjëse, mbrojtja e dorës së kuqe.

Më e dhunshme, më nacionaliste e më fanatike fetare ka qenë, padyshim, sjellja e Irlandës së Veriut dhe irlandezo-veriorëve kundër Anglisë dhe anglezëve. Kjo ka shkaqet e veta

⁵⁴ <http://www.dadalos.org/alb/vorbilder/peacepeople/geschichte.htm#Seitenanfang>

⁵⁵ Jonathan Tonge, *Northern Ireland Conflict and Change*, UK, 1998, fq. 18.

dhe historinë e saj. Në krye të kësaj anglofobie për një periudhë të gjatë trazirash ka qenë IRA, organizatë politike irlandeze shume ksenofobe dhe violente. IRA përdori për një periudhë shumë të gjatë sulmet mbi njerëz, shtëpi e objekte private e publike në Irlandën e Veriut dhe në Angli. IRA merrte edhe publikisht përgjegjësitë për këto akte dhune. Këto sjellje e veprime IRA nuk i ndërmori asnjëherë në Skoci apo në Uells.⁵⁶

Në komunitetin protestant, anglezët janë identifikuar me politikanët Britanikë. Ato gjithashtu, ngandonjëherë ishin të neveritur prej vendasve për shkak të perceptimit ndaj tyre si injorues të komuniteteve luajaliste. Në brendësi të Mbretërisë së Bashkuar, anglofobia në Irlandë shkaktoi turbullira, tensione, kriza, akte dhune e terrorizmi për shumë kohë. Procesi i transferimit gradual të kompetencave nga Londra në Irlandë ka ndikuar jashtëzakonisht shumë për rënien drastike të anglofobisë tek irlandezët. IRA, gjithashtu, i është kthyer gjithnjë e më shumë mjeteve politike e diplomatike për zgjidhjen e problemeve me Londrën.

Karakteristika, shtrirje dhe konsekuenca direkte në marrëdhëniet ndërkombëtare midis Mbretërisë së Bashkuar dhe kombeve të tjerë ka prodhuar anglofobia jashtë, pra tek shtete të tjera. Këtë shqetësim e kanë shfaqur edhe personalitete të mëdha të teorisë politike botërore si: Xhon Stjuart Mill. Në një shkrim të famshëm ese të Xhon Stjuart Millit me titull, „Pak fjalë mbi mos-ndërhyrjen“, ai shkruante se... „Anglia gjen veten e vet, lidhur me politikën e saj të jashtme të turpërohet me tipin e egoizmit e të vetëkënaqësisë; si një komb i cili nuk mendon për tjetër gjë, por vetëm për të vënë në majë të gishtit dhe për të vërtitur rreth tij fqinjët e saj... duke i bërë miqtë e vet kundra... mania e pretendimit për të vepruar me qëllime dobësimi të atyre, prej të cilëve në fakt neve vërtetë jemi nxitur për tu bërë këto që jemi“.⁵⁷

Ky është një konkluzion në kohën kur Anglia ishte në kulmin e sundimit të saj kolonialist botëror. Por, ndërkohë, Xh. S. Mill po elaboronte doktrinën e tij të nacionalizmit liberal ose të nacionalizmit qytetar. Në anglofobitë nga jashtë brenda, për të cilat flet posaçërisht Xhon Stjuart Mill janë marrëdhëniet e Mbretërisë së Bashkuar me Irlandën. Dihet që anglofobia nga jashtë Mbretërisë së Bashkuar ka një traditë shumë të gjatë të lidhur me nacionalizmin irlandez. Shumica e këtij fenomeni e ka tabanin në ndjenjën e armiqësisë së përhapur gjerësisht te katolikët e varfër për popullsinë anglo-irlandeze, e cila është kryesisht anglikane. Në Irlandë,

⁵⁶ 9 BBC News, „The IRA campaigns in England“, 4 March 2001.

⁵⁷ J. S. Mill, *A Few Words on Non-Intervention*, London, 1859.

përpara të njohurës, „Krizë të Madhe“, ndjenjat antiangleze ishin të ngulitura thellë dhe manifestoheshin në rritjen e armiqësisë anti-angleze organizuar nga Irlandezët e Bashkuar.⁵⁸

Draft kronologjia e konflikteve në Irlandën e Veriut nga viti 1968 e deri më 2001

- 1968 – Fillimi i trazirave të quajtura ‘‘Troubles’’ lëvizje kjo për të drejtat e qytetarëve katolikë që ishin të diskriminuar në Irlandën e Veriut.
- 1969 – Pas trazirave të përgjakshme në qytetin Derry fillon stacionimi i njësive ushtarake britanike në Irlandën e Veriut
- 1970 – Rithemelimi i organizatës ilegale katolike IRA
- 1972 – Më 30 janar, që ishte i njohur me emrin ‘‘E premtja e pergjakur’’, ushtarët britanikë vrasin në qytetin Derry 14 katolikë të pafajshëm. Gjithsej 474 persona humbin jetën, po atë vit Irlanda Veriore hyn në qeverisjen direkte të Britanisë.
- 1974 – Më 21 nëntor një bombë e IRA-s vret 21 persona të pafajshëm dhe plagos 182 të tjerë në Birmingham
- 1976 – Betty Williams dhe Mairead Corrigan marrin çmimin nobel për paqe, themeluese të organizatës Njerëzit Paqësor
- 1979 – IRA vret 18 ushtarë dhe një anëtarë të familjes mbretërore
- 1985 – Republikës së Irlandës i jepet statusi prej vëzhguesi në konfliktin e Irlandës së Veriut
- 1987 – Një bombë e IRA-s më 11 nëntor shpërthen gjatë përkujtimit të viktimave të luftës në Eniskilen ku gjenden vdekjen 11 persona
- 1991/1992 – Bisedimet për të ardhmen e Irlandës së Veriut në Londër përfundojnë pa sukses
- 1993 – Kontaktet e fshehta ndërmjet Londrës dhe IRA-s, për arritjen e paqes dhe stabilitetit në vend. Krahut politik i IRA-s fiton të drejtën e bisedimeve nëse IRA heq dorë nga përdorja e dhunës

⁵⁸ Eugenio F. Biagini, *British democracy and Irish nationalism - 1876-1906* Cambridge University Press, 2007, fq. 31.

- 1994 – IRA shpall armëpushim më 31 gusht, milicia protestante ndjek shembullin e saj me 13 tetor
- 1995 – Bisedimet ndërmjet Londrës dhe Shin Feinit, për bisedime shumëpartiake.
- 1996 – IRA prish armëpushimin përmes një atentati në Londër. Më 15 qershor u plagosën 200 persona në kampionatin europian të futbollit në Mançester.
- 1997 – Kryeministri Toni Bler fillon bisedimet për paqe me pjesëmarrjen e Shin Feinit, IRA prap i rikthehet armëpushimit.
- 1998 – Arrihet marrëveshja e njohur si Good Friday Agreement, më 10 prill. Në të njëjtin vit më 15 gusht gjatë një sulmi me autobombë vriten në Omag 28 persona dhe plagosen rendë më shumë se 220 tjerë
- 1999 – Në bazë të marrëveshjes për paqe formohet qeveria rajonale irlandeze veriore e përbërë nga katolikët dhe protestantët
- 2000 – IRA nuk u tregua e gatshme për dorëzimin e armëve, kështu qeveria rajonale shpërbëhet prap nga Londra pas 2 muajsh. Tërë procesi i paqes ndodhet në krizë të rëndë.
- 2001 – Shumë familje u shpërngulën nga shtëpitë e tyre në pjesën veriore të Belfastit pasi që disa bomba u gjetën dhe shkaktuan plagosjen dhe vrasjen e shumë njerëzve, si dhe dëme të mëdha material. Bomba të kurdisura u gjendën edhe nëpër shumë objekte të ndryshme anë e mbanë Irlandës së Veriut. Fajin për këto sulme i merrnin katolikët dhe protestantët.⁵⁹

2.2. Trazirat (The Troubles)

“The troubles” (Trazirat) ashtu siç është e njohur në mbarë botën filloi me të “dielën e përgjakshme”, një incident që nodhi në periudhën e trazirave në Irlandën e Veriut, një luftë e vërtet midis organizatave katolike që donin ndarjen nga Mbretëria e Bashkuar dhe organizatave të milicive protestante të krahinës që mbronin Irlandën e Veriut dhe e donin të pjesë përbërëse të Mbretërisë së Bashkuar.⁶⁰

⁵⁹ <http://www.cain.ulst.ac.uk/othelem/chron/ch01.htm>

⁶⁰ David McKittrick, *Making Sense of the Troubles*, UK, 2002, fq. 15.

Trazirat i referohen konfliktit tredhjetëvjeçar të dhunshëm i formuar nga marshimi për të drejta civile në qytetin e Londonderry me 5 tetor 1968 dhe Marrëveshjes së Premtes së Mirë me 10 prill të vitit 1998. Në qendër të konfliktit qëndron statusi kushetues i Irlandës së Veriut. Gjatë trazirave (The troubles), shkalla e vrasjeve të kryera nga të gjitha palët e involvuara tejkaloi 3,600 viktima. Deri në 50,000 njerëz ishin gjymtuar fizikisht ose të plagosur, dhe shumë të tjerë të dëmtuar psikologjikisht nga konflikti, ecuri që vazhdoi deri në periudhën post 1998.⁶¹

Qeveria britanike duke e pare eskalimin e këtyre trazirave në gusht të vitit 1969 dërgoi trupa në Irlandën e Veriut në atë që e përshkruan si një ‘operacion të kufizuar’, për të rivendosur rendin dhe ligjin në vend, pas tre ditëve të dhunës së përgjakshme në zonën Boagside kryesisht katolike të Londonderry. Edhe pas shumë tentativave të qeverisë britanike për zbutjen e tensioneve në shtator të vitit 1971 Gunner Robert Curtis bëhet ushtari i parë britanik që u qëllua për vdekje nga IRA. Trazirat edhe më tej nuk kishin të ndalur, 13 civilë u vranë nga ushtria britanike gjatë marshimit të drejtave civile në Londonderry. Katolikët e konsideruan si një hakmarrje të ushtrisë britanike kundrejt tyre. Në histori kjo datë është shënuar si e Diela e përgjakur e 30 janarit të vitit 1972.

IRA filloi të bënte komplete dhe të vendos bomba nëpër lokacione të ndryshme ku shumica protestante ishte viktima kryesore. Këtu mund ta përmendim rastin e Ambasadorit britanik në Republikën e Irlandës, i cili në korrik të vitit 1976 u vra nga një makinë bombë në Dublin.⁶² Shumë persona u ballafaquan me probleme të shumta gjatë këtyre trazirave që sollën edhe humbjen e shume jetëve të njerëzve si dhe dëme të mëdha materiale. IRA shpalli armëpushim në gusht të vitit 1994, dhe grupet besnike e ndjekën shembullin në tetor. Bisedimet e para zyrtare midis qeverisë britanike dhe Shin Fein-it filluan në dhjetor. Por një gjë e tillë nuk zgjati edhe shumë, pasi që në vitin 1996 IRA deklaroi fundin e armëpushimit të saj, pasi që qeveria e udhëhequr nga John Major, insistoi për dekomisionimin – dorëzimin apo shkatërrimin e armëve nga ana e grupeve paraushtarake si kusht të bisedimeve. Pak caste më vonë IRA shpërthen një bombë duke vrarë dy vetë dhe duke shkaktuar miliona paund vlerë në dëme. Kryeministri John Major, i sulmon bombardimet si një ‘zemërim të tmerrshëm’.⁶³

⁶¹ John Conroy, *Belfast Diary: War as a Way of Life*, UK, 1995, fq. 205.

⁶² Kevin Toolis, *Rebel Heart: Journeys Within the IRA's Soul*, UK, 1997, fq. 10.

⁶³ Tim Pat Coogan, *The IRA*, *The New York Times*, 2002, fq. 57.

Përafërsisht 52% e të vdekurve kanë qenë civilë, 32% anëtarë/ish anëtarë të forcave britanike të sigurisë, 11% kanë qenë anëtarë të paramilitarëve republikanë, dhe 5% anëtarë të paramilitarëve lojalist Rreth 60% e viktimave civil ishin katolikë, 30% ishin protestantë, dhe pjesa tjetër nga jashtë Irlandës së Veriut. Nga viktimat civile 48% u vranë nga lojalistët, 39% u vranë nga republikanët, dhe 10% u vranë nga forcat britanike të sigurisë..⁶⁴ Ka qenë subjekt i kontestit nëse disa individë ishin pjesëtarë të organizatave paramilitare për shkak të natyrës së tyre të fshehtë. Disa viktima që janë të listuar si civilë më vonë u pretenduan nga IRA si anëtarë të tyre.⁶⁵

Për tu arritur marrëveshje për ndaljen e trazirave filluan bisedimet ndërpartiake në vitin 1996. Në pothuajse të gjitha lagjet, një kombinim i realizmit politik dhe lodhjes nga lufta u hap rruga për negociata. E rëndësishme është se presidenti i SHBA-ve Bill Clinton mori rol aktiv personal, duke emëruar senatorin veteran George Mitchell si kryesues të procesit të bisedimeve që përfundoi me Marrëveshjen e së Premtes së Mirë.⁶⁶

2.4. Irlanda e Veriut gjatë vitit 2001

Shumë ngjarje qysh nga trazirat që e përfshin Irlandën e Veriut ndodhën në këtë vend të përfshirë nga një konflikt ndëretnik e ndër-religjioz ndërmjet dy grupeve më të mëdha atyre protestantë (britanez) dhe katolik (irlandez).

Një vit i paharrueshëm për Irlandën e Veriut që do të mbetet në historin e saj është viti 2001, për këtë ngjarje do të raportojnë shumë media vendase e të huaja duke i shfrytëzuar mjete dhe teknikave të ndryshme të informimit, ja se si shkruhet në një faqe të internetit: Viti 2001 pati një jehonë të madhe në Irlandën e Veriut në shumë sfera që tronditën Mbretërinë e Bashkuar. „Shumë familje u larguan nga shtëpitë e tyre në pjesën veriore të Belfastit pasi që dy bomba u gjetën në afërsi të tyre. Këto bomba u gjetën në afërsi të kishes irlandeze. Përgjegjësinë për to i

⁶⁴ Sutton Index of Deaths: *Summary of Organisation responsible*.

⁶⁵ <https://www.theguardian.com/uk/2002/may/19/bloodysunday.northernireland>

⁶⁶ <http://www.bbc.co.uk/history/troubles>

morren paramilitarët lojalist“.⁶⁷ Duke shfrytëzuar burime të internetit mes të tjerash thuhet: Katolikët dhe protestantët edhe gjatë fillimit të këtij viti mbetën në mosmarrëveshje, sidomos në lidhje me krijimin e një force policore neutrale në Irlandën e Veriut dhe çarmatimit të IRA-s. Në fillimit të muajit mars të vitit 2001, IRA papritur nisi një raund të ri bisedimesh me Komisionin e çarmatimit të Irlandës së Veriut, por asnjëherë nuk u bë përparim i vërtet.⁶⁸

Në lidhje me rrjedhën e këtyre ngjarjeve të vitit 2001 shprehen edhe Brendan O’Leary and John McGarry në librin e titulluar: *The politics of Antagonism: Undersatnding Northern Ireland* „Shumë akte terroriste ndodhën gjatë këtij viti si rasti ndaj sulmit të bazës së armatës britanike në qytetin Derry. Disidentën republikan besohet të kenë qenë përgjegjës për këtë sulm barbar.“⁶⁹

Numri i popullatës të Irlandës së Veriut u përcaktua atëherë kur më datë 29 prill të vitit 2001 Mbretëria e Bashkuar kreu regjistrimin e popullsisë të Irlandës së Veriut, ku rezultoi se jetojnë 1,685,267 banorë.⁷⁰ Gjatë kësaj periudhe kohore edhe Armata Irlandeze Republikane (IRA) njoftoi se ka filluar me çarmatimin e saj. Edhe pse IRA zotohej për një gjë të tillë në të shumtën e rasteve ajo shpesh herë i shpërfillte kërkesat dhe marrëveshjet e firmosura dhe fillonte shpesh herë me sulme, duke thyer armëpushimin që vendosej nga palët në bisedime, që shpesh herë ishin shumë të vështira për tu realizuar dhe implementuar nga palët në konflikt.⁷¹

Për të iu shmangur konfliktit ndërmjet protestantëve dhe katolikëve nuk ishte e lehtë, prandaj edhe krerët e këtij vendi vendosën më shumë siguri për banorët, për të qenë edhe më të qartë ja se çka thotë edhe Stacey McGoldrick: „Gjatë periudhës së vitit 2001 Irlanda e Veriut themeloi shërbimin e saj policor. Oficerët kishin kompetenca të plota policore në të gjithë Irlandën e Veriut. Po në të njejtin vit 400 policë ishin të angazhuar në përcjelljen dhe shoqërimin e shumë fëmijëve dhe prindërve të tyre për në shkollë dhe kthimit mbrapa nëpër shtëpitë e tyre për shkak të shmangies së konflikteve ndërmjet protestantëve dhe katolikëve që si dukej nuk ndalej lehtë. Anëtarët e ushtrisë britanike dhe shërbimit policor të Irlandës së Veriut vendosën në nëntor të vitit 2001 tani e tutje ti bashkohen organizatës me qëllim stabilitetin dhe ruajtjen e

⁶⁷ <http://cain.ulst.ac.uk/othelem/chron/ch01.htm>

⁶⁸ <https://www.infoplease.com/northern-irish-conflict-chronology>

⁶⁹ Brendan O’Leary and John McGarry, *The politics of Antagonism: Undersatnding Northern Ireland*, London, 1993, f.57

⁷⁰ NI Statistics and Research Agency

⁷¹ http://news.bbc.co.uk/onthisday/hi/dates/stories/october/23/newsid_2489000/2489099.stm

paqes në vend. Këtu rol të rëndësishëm luajti edhe Avokati i popullit për Irlandën e Veriut i cili merrej kryesisht me punën dhe hetonte çdo pretendim për sjellje të keqe nga oficerët e policisë. Shërbimi policor ishte i rregulluar nga brenda Departamenti i standardeve profesionale, motoja e të cilit ishte „integriteti nuk është i negociushëm.“⁷²

Procesi i paqes së brishtë u përball me një krizë tjetër në mes të qershorit, kur dhuna sektare shpërtheu përsëri në Belfast. Përleshjet filluan pasi një grup i nxënësve dhe prindërit e tyre janë gjuajtur me gurë nga të rinjtë protestantë ku viktimat ishin katolikë duke u larguar nga shkolla fillore ku ndiqnin mësimin në këtë shkollë që dominohej nga katolikët irlandez. Në atë që u konsiderua si një nga trazirat më të këqia në disa vite, turmat rivale hodhën bomba benzinë, gurë dhe shishe dhe vunë zjarrin makinave. Dhuna përkoi me fillimin e sezonit vjetor „marshimi“ kur grupet protestante përkujtuan fitoret e kaluara në fushën e betejës kundër katolikëve.

Me një përparim të vogël që u bë në fushën e policisë dhe çarmatim, Britania pezulloi qeverinë përsëri më 22 shtator, duke krijuar një tjetër dritare për gjashtë jave për palët për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre. Ky veprim u kritikua nga udhëheqësi i UUP, David Trimble, dhe më 18 tetor po të njëjtit vit, tre ministrat e mbetur të kabinetit të Partisë Unioniste të Ulster-it dhanë dorëheqje, në një përpjekje për të detyruar Britaninë që të vendos sundimin e drejtpërdrejtë për një kohë të pacaktuar. Megjithatë më 23 tetor, IRA njoftoi se kishte filluar të çarmatoset dhe dukej se procesi i paqes edhe njëherë shpëtoi nga një kolaps i vërtet. Armët dhe eksplozivët u vendosen në dy deponi dhe u vënë jashtë përdorimit.⁷³

Por cilat janë në të vërtetë mosmarrëveshjet e mbetura që edhe në ditët e sotme në Irlandën e Veriut? Pabarazia në strehim, arsim, dhe punësim kanë vazhduar edhe më tej, Kuvendi i Irlandës së Veriut shpesh herë bllokohet në çështje të diskutueshme pasi që akoma nuk ka qenë në gjendje të arrijë kompromise që adresohen këto shqetësime përmes legjislacionit. Irlanda e Veriut ka përqindjen më të lartë të braktisjes së shkollave të mesme në mesin e katër vendeve në Mbretërinë e Bashkuar, edhe pse katolikët kanë gëzuar sukses të madh arsimor më shumë se sa protestantët. Kur është fjala për pasuri, 22% e familjeve katolike jetojnë në varfëri krahasuar me 17% të protestantëve.

⁷² Stacey McGoldrick, *Uniform behavior: Police Localism and National Politics*, UK, 2006, f.116

⁷³ <https://www.infoplease.com/northern-irish-conflict-chronology>

Ndonjëherë, patjetër duhet të merresh me të kaluarën por pa frikë se mos ta dëmtojmë të sotmen, me këtë duhet të merremi me synim që të krijojmë besim se do të ndërtojmë të ardhmen tone paqësore. Gjithmonë disa gjëra ngelin në memorie historike dhe individuale për atë që është kapërcyer në të kaluarën dhe nuk duhet të bëhemi peng i kësaj të kaluare por duhet të zbardhim qartë të kaluarën dhe në qoftë se i zbardhim konfliktet, dhe e gjithë kjo do të ndihmojë që ne të qartësojmë një paqësore. Kështu në një çfarë mënyre të ngjajshme do të shprehet edhe Paul Nolan: E kaluara gjithashtu mbetet një çështje e ndjeshme për Irlandën e Veriut. Siç u përmend më lartë shumë konflikte me pasoja të mëdha ndodhën në këtë vend të kontestueshëm. Në shumë raste autoritetet nuk kanë qenë në gjendje për të identifikuar se kush është përgjegjës për këto vdekje, dhe për të afërmit e atyre që kanë vdekur që ende edhe sot shpresojnë për një mbyllje të këtij kapitulli trishtues. Hetimet janë të vështira, të kushtueshme dhe shume problematike. Pyetja e madhe mbetet se si për të balancuar thirrjet për të vërtetën, drejtësinë, kompensim të drejtë, dhe pajtimin e atyre që janë prekur drejtpërdrejtë nga konflikti.⁷⁴

Kundërshtarët në Irlandën e Veriut janë në thelb të njëjtët njerëz, të ndarë nga fakti i vetëm se njëri sundoi mbi tjetrin. Konflikti ndëretnik në Irlandën e Veriut zanafillën e vet e pat nga populli i ndarë pothuajse në të gjitha sferat. Njëra palë e konsideronte veten si irlandez ndërsa pala tjetër britanik të përbetuar. Kjo është kujtesa e dominimit nga e kaluara e hidhur në Irlandën e Veriut, e cila e ka kthyer konfliktin në një spirale të pathyeshme. Katolikët (ilrandezët) dhe protestanët (britanikët) merren me njëri tjetrin jo vetëm si individë por edhe si përfaqësues të komuniteteve të tyre. Nga pakënaqësia e tyre me statusin gjuhësor si dhe traditat dhe zakonet kulturore shpërtheu edhe konflikti fetar ndërmjet dy bashkësive më të mëdha në vend. Protestantët në të shumtën e rasteve e llogarisnin vehten si më superior karshi katolikëve në aspektin fetar, duke propaganduar edhe shpesh herë ndarjen e kishave. Gjithmonë aspekti social në Irlandën e Veriut ka çuar në një ndarje të madhe në mes bashkësive, ku katolikët nuk i gëzonin të drejtat e tyre, dhe në të shumtën e rasteve ndryshonin edhe mbiemrat e tyre që të dallohen nga britanikët (protestantë).

⁷⁴ Paul Nolan, *The Northern Ireland Peace Monitoring Report*, 2013

Fakte për konfliktin në dhe rreth Irlandës së Veriut:

- Çdo ditë të vitit shënohet përvjetori i vdekjes së dikujt si rezultat i konfliktit në Irlandën e Veriut.⁷⁵
- 3,720 persona u vranë si rezultat i këtij konflikti.⁷⁶
- Rreth 47,541 njerëz u plagosën.⁷⁷
- Gjithsej 36,923 të shtëna.⁷⁸
- Janë kryer 16,209 shpërthime.⁷⁹
- Ndërmjet viteve 1969 dhe 1998, 1553 persona gjetën vdekjen si rezultat i konfliktit të cilët ishin nën moshën 25 vjeçare. 257 persona tjerë të vrarë ishin nën moshën 18 vjeçare.⁸⁰
- Grup moshë më e madhe (25% ose 898 persona) të vrarë në mes vitit 1969 dhe 1998 ishin ato midis moshës 18 dhe 23 vjeç.⁸¹
- Që nga viti 1998, grupi më i madh (54%) i vdekjeve si pasojë e konfliktit ishin civilë.⁸²
- Që nga viti 1998, grupi më i madh (68%) i të lënduarve ishin civilë.⁸³

2.5. Procesi paqësor në Irlandën e Veriut

Pothuajse, shumica e njerëzve nëpër gjithë botën e dinë që lufta është diçka e tmerrshme dhe paqja diçka më e mirë. Por a është e mundur paqja? Apo lufta është një fat i pashmangshëm për njerëzimin që jeton në rruzullin tokësor? Sa e rëndësishme është një kulturë e paqes, sikur të

⁷⁵ Healing Through Remembering, *A Day of Private Reflection: Discussion Paper and Proposal*, (Belfast: Healing Through Remembering, 2006), 4-5.

⁷⁶ David McKittrick, Seamus Kelters, Brian Feeney, Chris Thornton and David McVea, *Lost Lives*, (Edinburgh: Mainstream Publishing, 2007), 1552

⁷⁷ Conflict Archive on the Internet (CAIN), RUC/PSNI statistics: Table NI-SEC-05: Persons injured (number) due to the security situation in Northern Ireland (only), 1969 to 2003

⁷⁸ Conflict Archive on the Internet (CAIN), RUC/PSNI statistics: Table NI-SEC-06: Security related incidents (number) in Northern Ireland (only), shootings, bombings, and incendiaries, 1969 to 2003

⁷⁹ Po aty

⁸⁰ Marie-Therese Fay, Mike Morrissey and Marie Smyth, *Northern Ireland's Troubles: The Human Costs*, (London: Pluto Press, 1999), f. 180

⁸¹ Po aty, f.181.

⁸² Po aty, f.159.

⁸³ Po aty, f.160.

kemi mirëkuptimin midis njerëzve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, e gjithë kjo duket shumë mirë.

Vendosja e procesit paqësor mes dy apo më shumë palëve që kanë rra në konflikt është shumë e rëndësishme për stabilizimin e gjendjes. Prandaj është e rëndësishme ta përmendim marrëveshjen e quajtur „Marrëveshja e Premtes së Mirë“, e cila përcaktoi një kornizë për të qeverisë dhe deleguar transferimin e kompetencave të përcaktuara mbi qeverisjen lokale nga Londra në Belfast – dhe bëri thirrje për formimin e Kuvendit e Irlandës së Veriut dhe Komitetin ekzekutiv në të cilën palët e unionistëve dhe nacionalistëve do të ndajnë pushtetin.

Për të siguruar që as unionistët dhe as nacionalistët mund të dominojnë Kuvendin, marrëveshja specifikoi se vendimet kyçe duhet të marrin mbështetje ndër-komunitare. Komiteti ekzekutiv do të përbëhet nga një ministër i parë, zëvendës ministër dhe ministra të tjerë me përgjegjësi të departamenteve (p.sh. shëndetësi, arsim, punësim).

Përveç kësaj, „Marrëveshja e së premtes së mirë“ përmban dispozita mbi disa çështje që shifen si kryesore për procesin e paqes: dekomisionimi (çarmentimi) i armëve të paramilitarëve; policia; të drejtat e njeriut; normalizimi i sigurisë së Mbretërisë së Bashkuar (demilitarizimi); dhe statusi i të burgosurve. Negociatat mbi këto çështje të shumta ishin tepër të diskutueshme. Ekspertët pohojnë se teksti përfundimtar i kësaj marrëveshje ishte në pajtueshmëri duke pasqyruar një shkallë të „paqartësisë konstruktive“ për çështje të tilla.

Më në fund, Marrëveshja e Premtes së Mirë (Good Friday Agreement) krijoi institucione të reja „veri – jug“ dhe „lindje – perendim“. Këshilli ministror veri – jugor është themeluar për të lejuar udhëheqësit në pjesët veriore dhe jugore të ishullit të Irlandës për tu konsultuar dhe bashkëpunuar në çështjet ndërkufitare. Këshilli britaniko-irlandez gjithashtu u formua, i përbërë nga përfaqësues të dy qeverive dhe administratave të bartura të Irlandës së Veriut, Skocisë, Uellsit, për të diskutuar çështjet me interes rajonal. Votuesit në Irlandën e Veriut dhe në Republikën e Irlandës më 22 maj të vitit 1998, kanë miratuar Marrëveshjen e Premtes së Mirë në referendume të veçanta. Zgjedhjet në Kuvendin e ri të Irlandës së Veriut, e cila kishte 109 vende në atë kohë, u mbajtën më 25 qershor të vitit 1998. Dy partitë më të mëdha ato unioniste dhe nacionaliste në atë kohë – Partia Unioniste e Ulster-it (UUP) dhe Social demokratët dhe Partia e punës (SDLP) fituan respektivisht 28 dhe 24 vende. Partia demokratike unioniste (DUP),

megjithë kundërtshtimin e saj të vazhdueshëm në shumë pjesë të Marrëveshjes së Premtes së Mirë, fitoi 20 ulëse; Sinn Fein, partia politike e lidhur me Armatën republikane irlandeze (IRA) fitoi 18 ulëse; dhe një numër i partive të vogla morrën pjesën tjetër të mandateve në kuvend.

Saj përket procesit paqësor, edhe pse u bë firmosja paqësore, zbatimi i saj ishte i vështirë. Në lidhje me këtë gjë do të shprehet edhe Kristin Archick, në *Northern Ireland: Current Issues and Ongoing Challenges in the Peace Process*: Edhe pse me një situatë shumë më të përmirësuar të sigurisë që nga firmosja e Marrëveshjes së Premtes së Mirë në vitin 1998, zbatimi i saj i plotë ka qenë i vështirë. Për vite, çarmatimi dhe reformat policore ishin pikat kyqe të fërkimit. Dhuna sporadike nga grupet disidente republikane dhe grupet lojaliste paramilitare refuzuan të pranojnë procesin e paqes dhe grindja sektare ndërmjet protestantëve dhe katolikëve ndihmoi për të ushqyer mosbesimin e vazhdueshëm ndërmjet bashkësive unioniste dhe nacionaliste.⁸⁴ Edhe pse Irlanda e Veriut ka bërë përparim të konsiderueshëm gjatë viteve që nga Marrëveshja e Premtes së Mirë të vitit 1998, kërkimi për paqe edhe pajtim mbetet sfidues, dhe shqetësimet e gjëra ende vazhdojnë. Këto çështje përfshijnë tejkalimin e ndarjeve sektare dhe menaxhimin e pikave kyqe të fërkimit (sidomos marshimin, protestat, përdorimin e flamujve dhe emblemave); marrja me të kaluarën; frenimin e mbetur të aktiviteteve paramilitare dhe disidente; dhe avancimin e zhvillimit ekonomik.⁸⁵

Prandaj le të jetë simboli i paqes le t'i ngroh edhe zemrat e atyre që vuajnë për shkak të konflikteve luftarake, le të jetë simbol i çlirimit për të varfërit dhe të shtypurit. Paqja është e vlefshme dhe e patjetërsueshme për të gjithë.

⁸⁴ Kristin Archick, *Northern Ireland: Current Issues and Ongoing Challenges in the Peace Process*, CRS, 2017, f.3

⁸⁵ Po aty..., f.13

3. KONFLIKTI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Republika e Maqedonisë është shoqëri multietnike në përbërjen e së cilës hyjnë shumë grupe etnike. Pjesëtarët e grupeve etnike në Maqedoni e konsiderojnë veten si të ndryshëm nga grupet tjera në shoqër, që nga ana e vet, gjithashtu, i konsideron si të tillë.⁸⁶

Në vitin 2001, në shtetin e Maqedonisë ndodhi konflikti i armatosur shqiptaro-maqedonas. Konflikti ndodhi si pasojë e shumë faktorëve, midis të cilave ishin raportet jo të drejta politiko-shoqërore ndërmjet dy etnitetëve, që përbënin shtyllat kryesore të shtetit të ri. Këto marrëdhënie shoqërore në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë u vendosën që në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, prej kur u formua Maqedonia si njësi federale e Jugosllavisë socialiste. Gjatë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë raportet etnike shqiptaro-maqedonase, nën patronazhin e Lidhjes Komuniste u zhvilluan në favor të interesave kombëtar të maqedonasve. Shqiptarët gjatë kësaj periudhe do të jenë të diskriminuar, por edhe pas kësaj periudhe shqiptarët do të jenë pothuajse plotësisht të diskriminuar.

Pra, prej kohës së komunizmit mundt të thueht se raportet shqiptaro-maqedonase ishin të tensionuara.

3.1. Ndarja dhe pavarësia e Maqedonisë nga ish – Jugosllavia

Elementet e para fillestare të formësimit të saj Maqedonia i ka fituar gjatë Lëvizjes popullore çlirimtare, e cila filloi në vitin 1941, në Komitetet e ashtuquajtura nacionalçlirimtare. Këto komitete, kanë qenë të organizuara nga partia komuniste në gjithë territorin e ish Mbretërisë Jugosllave. Si organi i parë themelues për shtetësinë e Maqedonisë llogaritet Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar i Maqedonisë (KANÇM), i cili në mbledhjen e tij të parë në

⁸⁶ Stojanoski, Nelko; Gjurovska, Mileva; Matevski, Zoran, *SOCIOLOGJIA për vitin e III të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004, f. 126.

muajin gusht 1944, vendosi të organizojë Maqedoninë si njësi federale në sistemin e Jugosllavise federative.⁸⁷

Që nga fillimi Maqedonia si pjesë përbërëse federative e Jugosllavisë, e deri në shpalljen e pavarësisë në shtator të vitit 1991, e ka ndarë fatin e shtetit federal si pjesë përbërëse e saj, duke i ndërtuar e zhvilluar marrëdhëniet socialiste shoqërore mbi bazën e pronës shoqërore dhe të vetëadministrimit jugosllav.⁸⁸

Maqedonia pas shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë, hyn në periudhën e re të historisë së saj. Kuveni i Maqedonisë më 17 nëntor të vitit 1991 e miratoi kushtetuten e re, me të cilën Maqedonia është shpallur si shtet i pavarur,⁸⁹ në esencë, në një shtet me një sistem demokratik e shumë partiak. Në parimet themelore të Kushtetutës së R. së Maqedonisë thuhet:

- R. e Maqedonisë është krijuar si shtet sovran, i pavarur, demokratik e qytetar;
- R. e Maqedonisë, vendos sundimin e së drejtës si bazë qeverisëse;
- Në R. e Maqedonisë, garantohen të drejtat dhe lirë e njeriut dhe barazia kombëtare;
- R. e Maqedonisë e siguron paqen dhe bashkëjetesën e popullit maqedonas me bashkësitë që jetojnë në të;
- R. e Maqedonisë siguron të drejtat sociale, prosperitetin ekonomik dhe avancimin e jetës individuale dhe kolektive të qytetarëve.⁹⁰

Sipas Kushtetutës së vitit 1991, pozita e individit dhe qytetarit paraqesin bazën e konceptit të shtetit, të drejtat e qytetarëve si anëtarë të bashkësive kombëtare, niset nga koncepti i pranuar në shtetet demokratike moderne, në këto parime edhe R. e Maqedonisë e përkrah sovranitetin, i cili u takon të gjithë qytetarëve të saj. Rëndësia e kësaj qëndron në faktin se të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, fetare apo të tjera, janë të barabartë dhe kanë liri dhe të drejta të barabarta.⁹¹

Sa i përket ndarjes së Republikës së Maqedonisë do të shprehet edhe Gleny Misha, i cili thotë: Maqedonia është e vetmja republikë e ish-Jugosllavisë që pavarësinë e vet të vitit 1991 e

⁸⁷ S. Kalimovski, V. Patel, R. Treneska, *Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija*, Shkup, 2001, f. 21.

⁸⁸ Po aty, f. 26-28.

⁸⁹ T. Dzunov, *Sukcesijata na drzavite, drzavjanstvoto i noviot praven poredok na R.M.*, Shkup, 1992

⁹⁰ Shih: tekstin e Kushtetutës së Maqedonisë të vitit 1991, neni 55.

⁹¹ Shih: *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, 1991., parimet hyrëse.

arriti pa ndonjë luftë. Megjithatë, pavarësia e saj u vijua nga sfida të ndyshme të jashtme dhe të brendshme. Në aspektin e jashtëm, Shqipëria njohu edhe shtetin edhe kombin maqedonas por e bëri të qartë që vullneti i saj i mirë do të varet nga statusi i shqiptarëve në Maqedoni. Serbia gjithashtu njohu shtetin e ri de facto duke e krijuar Jugosllavinë e re pa Maqedoninë, mirëpo nuk e njohu ekzsitencën e veçantë të kishës ortodokse të Maqedonisë. Bullgaria njohu shtetin por refuzoi ta pranonte që ka një komb të till legjitim. Greqia nga ana tjetër e kundërshtoi emrin kushtetues të Maqedonisë dhe refuzoi pranimin që qytetarët e saj në mënyrë legjitime të quheshin maqedonas.⁹² Nga aspekti i brendshëm, dolën shumë probleme lidhur me karakterin e veçantë të përbërjes së saj multietnike dhe multikonfesionale. Maqedonia është vend ku përkatësitë etnike e paraqesin një të tretën e popullatës dhe ku qytetarët kanë përkatësi të ndryshme fetare madje edhe brenda të njejtave etnive. Është më se e qartë se në një mjedis të tillë mund të paraqiten edhe mjaft paragjykime shoqërore dhe kulturore.⁹³

Republika e Maqedonisë kishte probleme të posaçme në lidhje me pranimin e saj në KB-së (pa emër dhe flamur) dhe njohjen e saj nga anëtarët e Bashkësisë Europiane në krye me ekspertin eminent juridik Badinter, pohoi se ekzistojnë në mënyrë kumulative kushtet e duhura për njohjen e Maqedonisë si shtet edhe para se të njihet Kroacia dhe Bosnjë Hercegovina. Greqia nga ana tjetër e keqpërdori të drejtën e vetos në Bashkimin Evropian duke e paraqitur ekzistimin e Maqedonisë si kërcënim për paqen ndërkombëtare.⁹⁴

Kushtetuta e RM-ës 1991 është shkak i kolfliktit më 2001. Për fat të keq, në vitin 1991 nën ndikimin e regjimit të trashëguar propagandues të Millosheviçit në Serbi, në Maqedoni politikanët maqedonas nuk arritën të mblidhnin forcat që t'i kundërviheshin asaj propagande dhe për këtë shkak u bënë disa gabime, veçanërisht ndaj etnisë shqiptarë. Gabimi i parë ishte që nuk u ra dakord me shqiptarët se si të duhej quajtur çështja e referendumit, dhe ajo procedurë e bën palën maqedonase përgjegjëse të madhe që shqiptarët e Maqedonisë nuk dolën në referendumin e vitit 1991. Për rrjedhojë deputetët shqiptarë në Kuvend nuk e votuan Kushtetutën e parë të Maqedonisë së pavarur.⁹⁵

⁹² Glenny Misha, *The Fall of Yugoslavia*, Londer, 1996, 255.

⁹³ Emilija Simoska, *Macedonia: A view on the inter-ethnic relations*, Stamboll, 1996, 98.

⁹⁴ Voislav Vasileski, *E drejta ndërkombëtare në konfliktet e armatosura*, Shkup, 2003, 126.

⁹⁵ Stojan Andov, *Gabuam me shqiptarët*, Intervistë më 09-11-2015, shih në: <http://portalb.mk/214954-andov-gabuam-me-shqiptaret/>

Udhëheqja e Maqedonisë nuk kishte mirëkuptim për kërkesat e shqiptarëve.

Në kohën kur Maqedonia ishte pjesë përbërëse e Jugosllavisë, përdorshin. forcat e përbashkëta të sigurimit për t'i shkelur kërkesat e shqiptarëve, kërkesa të cilat bazoheshin në përputhje me dokumentet ndërkombëtar e për liritë dhe të drejtat e njeriut. Pas pavarësisë së Maqedonisë, ata mendonin se me anë të përdorimit të forcës do e mbanin gjendjen e trashëguar nga Jugosllavia e Millosheviçit, duke ua “shitur” situatën qendrave ndërkombëtare si “oaz p aqeje”. Si partia më e madhe maqedonase VMRO-sllave dhe partia më e madhe shqiptare PDSH kontribuan në formimin e kësaj përshtypje të gabuar. Pasi ata kishin ndërtuar një qeveri të përbashkët në vjeshtë të vitit 1998, ku të dyja palët i dhanë përshtypjen bashkësisë ndërkombëtare dhe popullatës së tyre se, me formimin e kësaj qeverie, bilanci ndëretnik ishte i sigurt.⁹⁶

Kiro Gligorov, më 31 janar 1991 u zgjodh presidenti i parë në mënyrë demokratike i Republikës së Maqedonisë.⁹⁷

Shpresave të shqiptarëve për ta gëzuar demokracinë e re pluraliste shpejt u erdhi fundi. Teoria dhe praktika parlamentare në Maqedoni nisi me shpalljen e Maqedonisë si shtet etnocentrik të qytetarëve të bashkësisë etnike maqedonase, duke i shkelur dhe cënuar plotësisht të drejtat themelore civile, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, ku për pasojë përfaqësuesit e popullit shqiptar në Kuvendin e Republikës nuk e votuan Kushtetutën e vitit 1991⁹⁸, me të cilën shqiptarët u përjashtuan nga shtetformësia. Shqiptarëve u ndalohej përdorimi i gjuhës, nuk u respektohej historia dhe kultura, u mohojë territori, u ndalohej shtimi demografik, etj. Në një situatë të tillë, nga shkelja e rëndë e të drejtave nga ana e pushtetit një nacional, nga terri informativ dhe nga pesha e rëndë ekonomike, situata shkoi deri te shpërthimi i kryengritjes në vitin 2001. Ja se si e përshkruan këtë Henryk J. Sokalski,⁹⁹

⁹⁶ Predrag Jureković, International Conflict Management in Macedonia, Bureau for Security Policy, Austrian Federal Ministry of Defence, p. 2

⁹⁷ Faqja zyrtare e Presidencës së Republikës së Maqedonisë, Shih në: www.president.gov.mk/en/about-macedonia/former-presidents.html

⁹⁸ The Constitution of the Republic of Macedonia, Published in The Official Gazette of the Republic of Macedonia, No. 52/91, 31/98, 91/01.

⁹⁹ Ekspert për aktivitete paqësore ndërkombëtare dhe diplomaci parandaluese me 25 vjet përvojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Polonisë dhe 13 vjet punë në Kombet e Bashkuara, ku funksioni i fundit i të cilit ishte ndihmës i Sekretarit Gjeneral. Nga viti 1995 deri në vitin 1998, Sokolski u printe forcave parandaluese të Kombeve

“Unë u largova nga Shkupi në vjeshtë të vitit 1998, plotësisht i vetëdij shëm për ndarjet etnike, që ishin të pranishme në Maqedoni. Sikurse shumë përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë, edhe unë besoja fort se ekziston edhe hapësirë edhe nevojë urgjente për plotësimin e disa kërkesave themelore të shqiptarëve etnikë në vend, gjatë të cilave duhet të përcaktohen kufi jtë e fundit të asaj që është dhe nuk është e pranueshme për palët e interesuara. Siç theksova në raportin pas mbarimit të mandatit tim, për një zgjidhje të tillë nevojiten lëshime nga të dyja palët deri në atë shkallë që nuk do ta rrezikonte status quo-në gjeopolitike të rajonit. Në atë kohë duhej më së pakti të kiheshin në konsideratë katër elemente, të trajtuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhej që baza e marrëveshjes, deri tek e cila do të arrihej nëpërmjet negociatave të ofronte: zmadhimin e numrit të shqiptarëve etnikë në strukturat e shtetit dhe të qeverisë, zgjerimin e mundësive për arsimim universitar të shqiptarëve etnikë, përdorimin e gjuhës shqipe në Parlament dhe zbutjen e kushteve ligjore për të marrë shtetësi. Nëse Qeveria e Maqedonisë jepte mbështetje më të fortë, mund të arrihej përparim më i madh lidhur me këto çështje. Kuptohet, që në vend do të krij ohej një situatë krejtësisht tjetër. Maqedonia do të f i tonte besim të madh në botë dhe transformimet demokratike do të zhvilloheshin edhe më shpejt”, (Henryk, 2005).

Mungesa e të drejtave të plota të njeriut në Maqedoni dhe në Jugosllavi solli deri te lufta për shpërbërjen e Jugosllavisë dhe te lufta për liritë dhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, e cila mbaroi me Marrëveshjen e Ohrit dhe ndryshimin e Kushtetutës,¹⁰⁰ duke u përpjekur që me implementimin e saj të arrihet ndërtimi i mirëbesimit, zhvillimi i pushtetit të decentralizuar, jo diskriminimi, përfaqësimi i drejtë i etnisë shtetformuese shqiptare në administratë, arsimi dhe përdorimi i gjuhëve dhe shprehja e identitetit kombëtar.¹⁰¹

Kushtetuta e vitit 1991 e shpalli Maqedoninë shtet nacional të popullit maqedonas.¹⁰²

të Bashkuara (UNPREDEP), të vendosura në Maqedoni, si përfaqësues special i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuar.

¹⁰⁰ SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), Division for South-East Europe, Macedonia, - A confl ict analysis, October 2003, p. 8.

¹⁰¹ Julie Kim (Specialist in International Relations, Foreign Affairs, Defense, and Trade Division), Macedonia: Country Background and Recent Confl ict, November 7, 2001, CRS Report for Congress, p. 7.

¹⁰² SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), Division for South-East Europe, Macedonia, - A confl ict analysis, October 2003, p. 7.

U morën masa për centralizimin e pushtetit duke vendosur kontroll të plotë nga organet epushtetit qendror në të gjitha drejtim etj. Shqiptarët u diskriminuan me anë të “Ligjit për organizim territorial”, “Ligjin për zgjedhje”, “Ligjin për decentralizim”, “Ligjin për planifikim hapësinor”, etj. Shqiptarëve nuk iu dha mundësia për të marrë pjesë në privatizimin e kapitalit. Shqiptarët nuk kishin hapësirën e duhur për t’i mbrojtur të drejtat e tyre të pa tjetërsueshme. Shqiptarët autokton në trojet e tyre, në shtetin e ri Maqedonas të pavarur, ngelën të zhgënjyer. Ata u organizuan në parti politike dhe filluan të merrnin pjesë në zgjedhje që nga viti 1994, në ato parlamentare, presidenciale dhe lokale, duke menduar se pas pavarësisë së Maqedonisë kishte ardhur koha për realizimin e ëndrrave dhe dëshirave të tyre, të gëzonin të drejtat e tyre legjitime dhe të përcaktuara qartë në dokumentet e organizatave ndërkombëtare për këtë qëllim. Teoria dhe praktika parlamentare në Maqedoninë e pavarur tregoi të kundërtën, duke vijuar me metodat e trashëguara nga e kaluara e errët e ish Jugosllavisë.

Parlamenti maqedonas e shpalli Maqedoninë shtet etnocentrik të qytetarëve të bashkësisë etnike maqedonase, duke i shkelur dhe cënuar plotësisht të drejtat e etnisë shqiptare. Përfaqësuesit e popullit shqiptar në Kuvendin e Republikës nuk e votuan Kushtetutën e vitit 1991. Shqiptarëve u ndalohej përdorimi i gjuhës, nuk u respektohej historia dhe kultura, u mohojë territori, u ndalohej shtimi demografik, etj. Për përkeqësimin e situatës ndihmuan mjaft edhe mjetet e informimit në Maqedoni, të cilat ishin vendosur në shërbim të politikës antishqiptare të asaj kohe, duke përhapur urrejtje, mosbesim dhe indinjatë ndaj shqiptarëve tek popullata maqedonase. Kjo situatë e çoi Maqedoninë në mënyrë të pashmangshme drejt konfliktit të përgjakshëm të vitit 2001, konflikt i cili përfundoi me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve dhe vetëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër të Ohrit.¹⁰³

¹⁰³ Alban Përmeti, Kriza e vitin 2001 dhe faktori shqiptar në Maqedoni, Konferenca-11-June-Final.

3.2. Konflikti maqedono – shqiptarë

Siç e theksuam edhe më lartë se që nga koha e ish-Jugosllavisë, marrëdhëniet midis maqedonasve dhe shqiptarëve kanë qenë shumë problematike, posaçërisht pas vargut të demonstratave shqiptare të vitit 1981, që e kërkonin ngritjen e statusit të Kosovës në republikë brenda federatës jugosllave. Maqedonasit kishin frikë që një republikë e tillë e propozuar do t'i përfshinte pjesët e zotëruara nga shqiptarët në Maqedoninë Perëndimore, dhe do ta kufizonte për së tepërmi Maqedoninë, dhe sipas të gjitha gjasave, do t'i ngjallte pretendimet bullgare, madje edhe ato serbe dhe greke. Një gjë e tillë nga maqedonasit shihej si diçka mbase fatale, jo vetëm për integritetin territorial të Maqedonisë, por madje edhe për ekzistencën e kombit maqedon.¹⁰⁴

Kushtetura e re e Maqedonisë e uli pozitën e shqiptarëve duke e përkufizuar vendin si „shtet kombëtar të popullit maqedon“, në vend se si „shtet të popullit maqedon dhe kombësive shqiptare dhe turke“, ashtu siç ka qenë më parë. Kjo ishte arsya se pse shqiptarët e bojkotuan referendumin kombëtar për pavarësi të Maqedonisë, vetëm për ta vendosur në skenë referendumin e tyre jozyrtar për autonominë territoriale të Maqedonisë Perëndimore.¹⁰⁵ Kur një gjë e tillë u pranua në preambulën e kushtetutës së vitit 1991, elitat politike shqiptare protestuan kundër këtyre zhvillimeve dhe kërkuan që shqiptarëve që jetonin në Republikën e Maqedonisë t'u jepej statusi i kombit shtet formues.¹⁰⁶

Mbyllja e shkollave të mesme në gjuhën shqipe, kryesisht në vendbanimet shqiptare në Maqedoni, si në Shkup, Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Kërçovë, Dibër dhe Strugë, nën preteksin e formimit të paraleleve të përziera maqedone-shqiptare, të thirrur në emër të bashkim – vëllazërimit.¹⁰⁷ Vetëm në Kumanovë, për shkak të padëgjueshmërisë dhe protestave të shqiptarëve kundër paraleleve të përziera u burgosën disa dhjetëra të rinjë si dhe u torturuan dhe u nxorrën nga puna shumë të tjerë.¹⁰⁸

¹⁰⁴ Hugh Poulton, *Who are the Macedonians?*, SHBA, 1995, f.127.

¹⁰⁵ Vladimir Ortakovski, *Interethnic relations and minorities in the Republic of Macedonia*, 2001, f.34.

¹⁰⁶ Zhidas Daskalovski, *Census taking and inter-ethnic relations in Macedonia*, f. 369, 2013

¹⁰⁷ Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, 5 shkurt 1989, *Nacionalizmi shqiptar edhe mëtej po e ngarkon gjendjen e sigurisë*. f. 9.

¹⁰⁸ Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë, F. CK.SKM, K302, dok.1-2. (mëtej DARM, 1.427.535.2/1-2).

Ndërsa nga ana tjetër, Sërbia dëshironte ta shfrytëzonte Maqedoninë si territor provues, jo vetëm për të kufizuar rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe për të frenuar arsimin shqip në të gjitha nivelet si dhe prespektivën e shqiptarëve. Pushteti maqedonas si në nivel republikan, gjithashtu edhe në atë lokal ku shqiptarët përbënin shumicë, nxorri ligje të shumta për të ushtruar presion në fushën e lindjes.¹⁰⁹

Në një debatë që e zhvillon akademik Rexhep Qosja me kolegun e tij maqedon Gane Todorovski, lidhur me çështjen e shqiptarëve në Maqedoni, ndër të tjera akademik Qosja për antagonizmat nacionale në Maqedoni midis maqedonasve dhe shqiptarëve, shprehet se nuk i nxit ai apo shqiptarët, por byrokracia politike maqedone me shtypjen dhe privimin e të drejtave, që u bëhet shqiptarëve.¹¹⁰

Konfliktet tjera në vazhdimësi ishin në lidhje me miratimin e ligjit për arsim të lartë në Maqedoni, ku u paraqitën shumë probleme nga ana e palës maqedone për pranimin e një gjëje të tillë. Partnerët e atëherëshëm të koalicionit qeverisës VMRO-DPMNE dhe PDSH, do të nisin iniciativën që çështja e arsimit të lartë në gjuhën shqipe, të merr epilogun e saj, duke mos kalkuluar mirë për formën, profitin dhe pasojat që mund të burojnë nga i njëjti veprim politik. Dispozitat kushtetuese nuk lejonin që shqiptarët në Maqedoni të mësonin në gjuhën e tyre amtare, përveç në shkollat fillore dhe të mesme, domethënë arsimi i lartë nuk përfshihej fare.¹¹¹ Më 25 korrik të vitit 2000, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, votoi Ligjin për arsimin e lartë, që do të hapte rrugën edhe pakicave kombëtare në vend të studiojnë në gjuhën e tyre amtare, por dallimi qëndronte në atë që nuk do të legalizohej Universiteti i Tetovës, por mundësohej hapja e universiteteve private. Qëndrime tepër të prera kundër sjelljes së këtij ligji kishte opozita shqiptare, e cila kërkonte që të hiqej nga rendi i ditës ky propozim-ligj, pasi që edhe Bashkimi Evropian, kishte sygjyeruar që kjo çështje të zgjidhet me dialog mes opozitës dhe pozitës, si dhe në këto bisedime të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e udhëheqësisë së Universitetit të Tetovës.¹¹² Deputetja e opozitës maqedonase nga rradhët e LSDM-së, Ilinka Mitreva, do të shprehej se qeveria i harron rekomandimet e Komitetit për arsim të lartë të Këshillit të Evropës, e cila edhe

¹⁰⁹ Hivzi Islami, *Problemet Demografike të Kosovës dhe të trevave të tjera etnike shqiptare, në Çështja e Kosovës një problem historic dhe actual*, Instituti I Historisë – Prishtinë dhe Instituti I Historisë – Tiranë, Tiranë, 1996, f.262.

¹¹⁰ Rexhep Qosja, *Populli i ndaluar*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, f.140.

¹¹¹ *Kushtetuta e Maqedonisë*, nëntor 1991, neni – 7

¹¹² Fjalimi i deputetit Mersel Bilalli në Kuvendin e Maqedonisë, Mbledhja 53, 18.07.2000

vet e citon: Duhet të gjendet zgjidhje politike e balancuar për çështje të ndjeshme të drejtave të minoriteteve për studim në arsimin e lartë.¹¹³

Si përfundim dr. prof. Sali Berisha thotë se: ata që ende besojnë në mundësinë e ndërtimit të një shteti multietnik dhe multikulturor në Maqedoni në status quo-n aktuale, druaj shumë se nuk janë realistë. Ngjarja tejet tronditëse e Kumanovës, e cila pati më shumë viktime se të gjitha aktet e terrorit shtetëror të autoriteteve maqedonase, të marra së bashku të Ladorishtit, Bit Pazarit, Tetovës, Gostivarit dëshmon se, klonimi i nacionalizmit dhe shoqëria multietnike nuk bashkëjetojnë dhe se, nacionalizmi maqedonas antik është i gatshëm të ndërmarrë akte terrori kundër shqiptarëve. Pas marrëveshjes së Ohrit, Maqedonia „de jure“ është një shtet etnik, më saktë i nacionalizmit të ri maqedonas antik dhe kjo përbën një problem madhor për stabilitetin e këtij vendi.¹¹⁴

Gjithmonë ka ekzistuar konflikt i brendshëm ndërmjet dy bashkësive më të mëdha në vend, atë maqedonas dhe shqiptarë. Aspekti kryesor dhe më i rëndësishëm ka qenë çështja e gjuhës dhe arsmi i lartë në gjuhën shqipe. Edhe pas shumë përpjekjeve si nga partitë politike shqiptare pas shpalljes së Maqedonisë si shtet të pavarur e demokratik nuk rezultoi me ndonjë zgjidhje afatgjate për çështjen shqiptare. Gjithmonë konflikti sa vinte e zmadhohej tek popullata civile pas shpërfilljes së autoriteteve shtetërore karshi bashkësisë shqiptare në vend. Përpjekjet e shumta në mënyrë demokratike nuk rezultuan me sukses për popullin shqiptarë deri në ndërhyrjen e ndërkombëtarëve dhe firmosjen e marrëveshjes kornizë të Ohrit, marrëveshje kjo që avanconte të drejtat e shqiptarëve me ligj e kushtetutë.

¹¹³ Fjalimi i deputetes Ilinka Mitreva në Kuvendin e Maqedonisë, Mbledhja 53, 24.07.2000

¹¹⁴ <http://lajmpress.com/maqedonia-ne-udhekryq-i/>

3.3. Konflikti i armatosur gjatë vitit 2001

Konfliktet në shtetin me demokracinë e brishtë nuk kishin të ndalur. Situatat tepër të tensionuara haseshin pothuajse në çdo sferë të jetës, padrejtësitë ndaj bashkësisë etnike shqiptare nuk kishin të ndalura dhe kështu filloi konflikti i armatosur në vitin 2001.

Të shtënat e para të armëve do të shpërthejnë në fshatin e Tanushës, për të vazhduar edhe në hapësirat tjera të brezit kufitar me Kosovën. Kriza në Maedoni u shqyrtua edhe në Kombet e Bashkuara dhe në NATO. Pas takimeve të shumta të diplomatëve relevant ndërkombëtarë me zyrtarët maqedonas, të gjithë dolën me një qëndrim unik se: ***“mbështesin tërësinë territoriale të Maqedonisë dhe stabilitetin e kufijve të saj”***¹¹⁵. Këtë konstatim e konfirmonin edhe subjektet politike shqiptare në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM. Por, njëkohësisht sekretari i Departmentit të SHBA, Kolin Powell u rekomandoi qarqeve qeveritare maqedonase, kërkesat e të pakënaqurve, se ***“duhet të bëhen reforma kushtetuese dhe të aplikohet përdorimi i gjuhës shqipe”***.¹¹⁶

Pra, njësitë e armatosura të UÇK-së, nga mesi i shkurtit të vitit 2001, ishin futur në fshatin Tanushë të Shkupit, dhe kishin zënë pozicionet për herë të parë për luftë frontale me maqedonasit pas vitit 1945, kur u zhvilluan betejat e fundit frontale mes forcave partizane sllave dhe atyre të Ballit Kombëtar. Opinioni i gjërë ende nuk ishte njoftuar në të vërtetë se çfarë ndodhte në fushën e sigurisë, përderisa një ekip i televizionit A1, me 16 shkurt të vitit 2001, do të drejtohet për në fshatin Tanushë për të vërtetuar nëse thashethëmet rreth hyrjes së UÇK-së ishin të sakta apo thjesht spekulime. Menjëherë, pas tentimit për të hyrë në fshatin Tanushë, ekipi i televizionit A1, u ndalua nga ushtarë me uniformë ushtarake dhe me emblemën e UÇK-së, i'u konfiskuan kamera dhe aparatet tjera dhe më pas u lanë të lirë. I njejtë ekip i gazetarëve e kishte paraqitur rastin në polici ku nga këtu tani do të fillonte përleshja e armatosur mes forcave policore dhe ushtarake të Maqedonisë dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Në luftime do të bie edhe dëshmori i parë i UÇK-së nga fshati Tanushë.¹¹⁷ Në fshatin Tanushë, në javën e parë të marsit të vitit 2001, përveç ushtrisë e policisë maqedone, morri aksion edhe NATO, nga ana e

¹¹⁵ >>Fakti<<, *Deklaratë e Unionit European për situatën në Maqedoni: “Liderët shqiptarë të insistojnë për dialog”*, 26 mars, 2001, 6.

¹¹⁶ Po aty, *Kërkesë e SHBA drejtuar Shkupit: “Të realizohen reformat kushtetuese”*, 26 mars, 2001, 6.

¹¹⁷ Sandra Ismanovski, *Konflikt vo Makedonija 2001: terorizam ili borba za prava?* Skopje: Fondacija Institut otvoreno opshtestvo – Makedonija, 2008. f. 6.

Kosovës, fakt që nuk i kënaqnin autoritetet maqedonase. Përderisa luftimet vazhdonin në zonën e Tanushës, ushtarët amerikanë kishin arritur në afërsi prej 200 metra objektit të shkollës, më 8 mars në orën 2 të mëngjesit dhe nuk kishin vazhduar më tej, me arsyetimin se kishte shumë mjegull. Udhëheqësi i operacionit kolonel-lejtantë Bryan Owens do të deklarojë më pas se kishte parë një veturë dhe disa gomarë të përdorur nga UÇK-ja, por se nuk e di se ku janë vendosur tani.¹¹⁸

Në New York, me datë 8 mars 2001, ishte mbledhur Këshilli i Sigurimit i OKB-së, për të biseduar rreth situatës së krijuar në Maqedoni. Pos të tjerash Këshilli i Sigurimit, do ta mbështeste Maqedoninë në përpjekjet e saja për tu ballafaquar me dhunën, por ajo duhet ta ruajë stabilitetin politik dhe harmoninë mes të gjitha përkatësive etnike në vend.¹¹⁹

Kryeministri bullgar, Ivan Kostov do t'i ofronte Maqedonisë një ndihmë të konsiderueshme ushtarake me vlerë prej 16 milionë markash gjerman. Gjatë vizitës së tij që në ditën e parë kishte arritur pjesa e parë në vlerë prej 800.000 markash gjermane. Përderisa, një ditë më herët një grup ushtarakësh të lartë nga Maqedonia morën ndihmat e para ushtarake nga shteti grek.¹²⁰

Lufta kishte filluar në teren, mirëpo organet shtetërore të Maqedonisë bënë një propagandë të fuqishme në opinion e gjerë, nëpër mediat elektronike dhe të shkruara, për të bindur faktorin ndërkombëtarë se gjoja UÇK-ja është orhanizatë terroriste dhe se shqiptarët janë element destabilizues në rajon dhe se dëshirojnë të ndajnë shtetin dhe se luftojnë për Kosovë të Madhe ose për Shqipëri të Madhe. Maqedonia kishte përparësi të madhe që të bindë botën dhe ndërkombëtarët se ishte në të drejtë, duke filluar që nga Këshilli i Europës, BE-ja, NATO, OKB, OSBE dhe në çdo shtet aty ku Maqedonia kishte ambasadorë. Mirëpo, e gjitha kjo propagandë nga ana e autoriteteve maqedonase nuk arriti ti bind aspak ndërkombëtarët. Çdo delegacion dhe përfaqësues nga Europa Perëndimore që vinte në Maqedoni, në asnjë mënyrë nuk përmendte termin "terrorist" pas një muaji luftime, por më së shpeshti përdornin termat si: "rebel", "kryengritës" gjë që nuk e pëlqenin autoritetet e vendit. Edhe gazetarët që vinin nga çdo vend i botës përdornin termin e njejtë karshi kësaj kryengritje. Richard Beeston editori i prestigjiozes

¹¹⁸ Gazeta "The Times", 9 mars 2001. *Rebels escape as US troops seize Albanian base.*

¹¹⁹ Gazeta "Nova Makedonija", 9 mars 2001, *Osudeno nasilstvoto od albanskite ekstremisti.*

¹²⁰ Gazeta Nova Makedonija, 9 mars 2001, *Voeno-tehnička pomosh za Makedonija od 16 milioni marki.*

proqeveritare britanike ‘‘The Times’’ shkruan në një analizë për Maqedoninë arsyet e fillimit të luftës në Maqedoni, diskriminimin që i është bërë shqiptarëve, përfaqësimi tejet i ulët nëpër institucionet shtetërore, arsimimi, shëndetësia, ushtria, politika etj. Për UÇK-në shkruan se e filloi luftën jo për të ndarë shtetin, por për të avancuar statusin e shqiptarëve në Maqedoni, brenda për brenda kufijëve aktual të shtetit. Ai thekson se duhet sa më shpejt të intervenohet për të ndaluar një luftë gjithëpërfshirëse, pasi sipas tij nuk duhet shumë provokime që vendi të ndahet në dysh.¹²¹

Nga një presion i vazhdueshëm që bën qeveria e Maqedonisë në drejtim të NATO-s në Kosovë, se nuk ndërmarrin masa për të izoluar kufirin, që mos të hyjnë grupet e armatosura të shqiptarëve në Maqedoni, në selinë e NATO-s në Bruksel, më 19 mars 2001, në prani të ministrit të punëve të jashtme të Maqedonisë, do të merret qëndrim që të përforcohet kufiri në mes Maqedonisë dhe Kosovës, respektivisht ndërprerja e furnizimit, siç u shpreh Lord Robertson, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s.¹²²

Luftimet morën përmasa të mëdha në të gjitha pikat që i kontrollonte UÇK-ja që nga Gostivari e deri në Kumanovë. Njësitë e UÇK-së kishin avancuar tepër në shumë vendbanime shqiptare dhe tani bëheshin përpjekje për të marrë nën kontroll edhe qytete siç ishte rasti me Tetovën, të cilën e kishin futur nën kontroll forcat e UÇK-së, por pas marrëveshjes me NATO-n për armëpushim, shtabi i UÇK-së kishte urdhëruar të tërhiqen nga shumë pika që i kishin zënë me luftë.¹²³

Me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtarë dhe liderëve të partive politike maqedonase dhe shqiptare në një atmosferë tepër të ngarkuar politike dhe ushtarake në teren, më 13 gusht 2001 në Shkup do të firmoset Marrëveshja Kornize e Ohrit, dokument i cili do t'i jepte fund luftës dhe do të hapte një kapitull të ri zhvillimeve politike në vend duke avancuar statusin e popullatës shqiptare në Maqedoni.¹²⁴

¹²¹ Gazeta ‘‘The Times’’, 16 mars 2001, *New clashes light Balkans fuse*.

¹²² Gazeta ‘‘International Herald Tribune’’, 20 mars 2001, *NATO Aims to Seal Macedonia Border*.

¹²³ Petrit Mëhaj, *UÇK Mesazh dhe Shpresë*, vëllimi II, Tetovë, 2005, f. 129.

¹²⁴ Gazeta ‘‘Flaka’’, 14 gusht 2001

3.4. Raportet ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve pas vitit 2001 e kendej

Tendosjet etnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve janë rritur edhe më tutje gjatë viteve në vijim. Fillimisht të nxitura nga incidentet etnike në ndeshjet sportive, përleshjet midis dy bashkësive së shpejti degjeneruan në dhunë, ku në shkurtin e vitit 2012 një polic maqedonas në kohën kur nuk ishte në shërbim të detyrës vrau dy shqiptarë në qytetin e Gostivarit, dhe kur pesë maqedonas etnikë të pafajshëm u vranë afër liqenit të Smilovcit. Këto incidente nisën edhe protestat masive të shqiptarëve në njërën anë dhe maqedonasve në anën tjetër, duke përfunduar në dhunë dhe dëme të mëdha materiale ndaj pronave civile. Pas kësaj, ka pasur një varg sulmesh nëpër autobusë dhe nëpër rrugë, që kishin përplasje të mëdha ndërmjet të rinjve maqedonas dhe shqiptarë, ku disa të rinj nga të dyja palët kanë pësuar lëndime serioze.¹²⁵ Situata u përkeqësua edhe më shumë kur disa shqiptarë u burgosën dhe më pas u dënuan për vrasjen e pesë të rinjve maqedonas etnikë, gjë të cilën këta shqiptarë e mohonin kategorikisht me fakte dhe argumente. Mijëra shqiptarë të pakënaqur u ngritën në protesta kundër përfundimit të gjykimit politikisht të motivuar, duke sjellur vendin në prag të një konflikti tjetër ndëretnik.¹²⁶

Raportet e tilla të sforcuara ndërmjet dy bashkësive kryesore etnike në vend janë rezultat i disa faktorëve që rallë shumë ndërveprojne me njëri tjetrin. Sa për fillim, pjesa më e madhe e konflikteve ka rezultuar për shkak të perceptimeve të ndryshme të dy bashkësive për konceptim themelor të shtetit të Maqedonisë. Shqiptarët argumentonin se Maqedonia duhet të jetë shtet i të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë, ndërsa elitat maqedonase e dëshironin një shtet etnocentrik ku ata do të kishin pushtetin absolut dhe do të mbizotronin. Siç edhe u përmend, në pajtueshmëri me këtë, kushtetuta e re i favorizonte maqedonasit duke i trajtuar ata, edhe si të

¹²⁵ "Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger," *The Sofia Echo*, 14 mars 2012; http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger (27.10.2014).

¹²⁶ Davies, Jack, "Is Macedonia on the brink of another ethnic conflict," *Vice*, 15 korrik, 2014, <http://www.vice.com/read/albanians-in-macedonia-are-pissed-off-jack-davies-777> (27.10.2014).

vetmin komb shtetformues, edhe si shumice në suazat e shtetit.¹²⁷ Edhe pse me ndryshimet kushtetuese që e pasuan Marrëveshjen e Ohrit maqedonasit e perceptonin Maqedoninë edhe më tutje si shtet të tyre „të natyrshëm“ edhe pse preambula e kushtetutës u ndryshua për të pasqyruar natyrën multikulturore të shtetit.¹²⁸

Faktori i dytë që u jep nxitje përleshjeve etnike në mes maqedonasve dhe shqiptarëve vjen nga perceptimet e ndryshme lidhur me pretendimet shqiptare që përfitojnë nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Ndërkohë që shqiptarët gjithë këtë proces e trajtojnë si çështje të drejtave kolektive dhe njerëzore, ndërsa maqedonasit besojnë që grindja është në fakt për territor. Për më tepër shqiptarët marrëveshjen e shohin si pikënisje, si një platformë dinamike nga e cila pozita e tyre do të përmirësohet më tutje.¹²⁹ Maqedonasit edhe më tutje mbeten mosbesues për synimet e vërteta të shqiptarëve edhe pse Marrëveshja Kornizë e Ohrit e ka ruajtur karakterin unitar të vendit, ata edhe më tej dyshojnë që kërkesat e tyre për më tepër të drejta janë projekt për „Shqipërinë e Madhe“.¹³⁰

Elementi final që u ka dhënë një kontribut plotësues konflikteve ndëretnike në mes dy bashkësive më të mëdha në Maqedoni është i lidhur ngushtë me integrimin euro-atlantik të vendit. Edhe pse zyrtarisht integrimi e paraqet njërin prej prioriteteve kryesore të vendit, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe në Bashkimin Evropian është ndërprerë viteve të fundit në mënyrë serioze. Mbështetja e anëtarësimit në këto dy organizata kryesore ka pësuar një rënie viteve të fundit, si te politikanët maqedonas poashtu edhe te maqedonasit etnikë në përgjithësi. Nga ana tjetër shqiptarët etnikë në Maqedoni e përkrahin dhe e mbështesin fuqishëm integrimin euro-atlantik të vendit. Shpesh herë është theksuar nga politikanët të shumtë shqiptarë nga i gjithë rajoni, Europa, jo Shqipëria e Madhe, e paraqet shëgun e zbatueshëm drejt unifikimit të të gjithë shqiptarëve në Ballkan.¹³¹

¹²⁷ Adamson, Kevin dhe Jovic, Dejan, “The Macedonian–Albanian political frontier: the re-articulation of post-Yugoslav political identities,” *Nations and Nationalism* 10 (3), 2004, fq. 294.

¹²⁸ Slaveski, Stojan dhe Kozarev, Atanas, “‘Europeanization’ of the Macedonian National Identity,” *The Western Balkans Policy Review*, Volume 2, Issue 1, Dimër/Pranverë 2012, Prishtinë, fq. 28.

¹²⁹ Aziri, Etem, “Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement,” *Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures*, fq. 131-156. Epoka University, tetor 2011, fq. 148.

¹³⁰ Fraenkel, Eran, “Macedonia,” në *Nations in transit 2003*. New York: Freedom House, 2004, fq. 403.

¹³¹ <https://sot.com.al/politike-intervista/rama-projekti-yn%C3%AB-aktual-%C3%ABsht%C3%AB-evropa-e-madhe-jo-shqip%C3%ABria-e-madhe#sthash.%20wffAbb7n.dpuf>

Raportet ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit kanë qenë të brishta dhe shpesh herë me probleme kryesisht etnike. Shumë nxënës shqiptarë nga Shkupi dhe rrethina kanë qenë viktime të politikës ditore në vend ku më së keqi ata e kanë pësuar nga nxitja dhe urrejtja nga bashkqytetarët e tyre maqedonas. Problemet dhe konfliktet kanë vazhduar edhe gjatë ndërrimit të emrave të shkollave ku ka pasur pengesa të shumta si nga ana e institucioneve shtetërore poashtu edhe nga autoritetet lokale, duke konsideruar se një veprim i tillë është jolegjitim dhe shkon në kundërshtim me kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, por duke harruar se sipas regjistrimit të fundit të popullatës rezultojnë mbi 25% shqiptarë. Akte tjera vandale kanë vazhduar edhe nëpër pronat e shqiptarëve, ku janë thyer dhe djegur dyqane, si dhe janë shkruar grafitë nga më të ndryshme për dëbimin e tyre.

Maqedonia sot ndodhet në një krizë të thellë politike si pasojë e mosdhënies së mandatit nga ana e presidentit Ivanov për partinë e kreut të LSDM-së Zoran Zaev, që ka grumbulluar dhe ka arritur t'i mbledh votat e mjaftueshme për formimin e Qeverisë. Një gjë e tillë është kundërshtuar ashpër nga faktori vendor dhe ai ndërkombëtarë duke u shprehur se presidenti Ivanov ka shkelur kushtetutën dhe nxit thellimin e krizës që ka kapluar vendin e që zgjat tashmë dy vite. Pasojat e vendimit të tij konsiderohen si shumë të rënda në kundërshtim me kushtetutën e vendit. Në qoftë se nuk arrihet një zgjidhje e shpejtë për vendin që të dalë nga kriza atëherë Maqedonia mund të shkon drejt një konflikti civil tepër të rëndë për gjithë qytetarët e saj.

4. DALLIMET NË MES KONFLIKTIT NË IRLANDEN E VERIUT DHE KONFLIKTIT NË MAQEDONI

Shumica e rasteve të konfliktëve shtetërore po ashtu përfshinë edhe shtete me përvojë të gjatë të udhëheqjes shtetërore që kanë prishje të të drejtave njerzore, veçanërisht në hapsirën gjuhësore apo fetare që prekin interesat e individeve ose punësimet.

Dallimet kryesore në mes konfliktit së Irlandës së Veriut dhe konfliktit në Maqedoni janë:

Maqedonia (Shqiptarët). Përjashtimi i gjuhës shqipe nga përdorimi në shumicën e institucioneve institucionale (diskriminim), përfaqsim tejet i ulët i shqiptarëve etnik nga kategorite e ndryshme të punësimit në institucionet shtetërore, refuzim për të themeluar një Universitet në gjuhën shqipe (diskriminim).¹³²

Mbretëria e Bashkuar (Irlanda Veriore). Përjashtim i gjërë i pakicës katolike nga kategoritë shtetërore dhe private të punësimit, rregulla diskriminuese të vendosjes dhe votimit.¹³³


Përveç dallimeve kryesore që i vëmë re në mes këtyre konflikteve, gjithashtu këto konflikte të dy shteteve i kanë edhe elementet e përbashkëta, për të cilat do të flasim më gjërësisht në kapitullin e radhës.

Sa për ilustrim po e paraqesim një tabelë me dy bashkësi, ku janë paraqitur dallimet dhe disa elemete të përbashkëta të konfliktit në Maqedoni dhe në Mbretërinë e Bashkuar (Irlandën e Veriut), ja si duket;

¹³²Fernand de Varennes / *SFIDAT E SHPESHTA NE IMPLEMENTIMIN E MARREVESHJEVE PAQESORE BRENDA SHTETIT: RESISTENCA E AUTORITETEVE SHTETERORE* marrë nga:

<http://www.newbalkanpolitics.org.mk>

¹³³ Fernand de Varennes / *SFIDAT E SHPESHTA NE IMPLEMENTIMIN E MARREVESHJEVE PAQESORE BRENDA SHTETIT: RESISTENCA E AUTORITETEVE SHTETERORE* marrë nga: <http://www.newbalkanpolitics.org.mk>



4.1. Elementet e përbashketa të konflikteve

Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, modeli që mbisundonte për sigurimin e sigurisë ndërkombëtare, ishte modeli i konfliktit, i cili mundësoi që konfliktet ndërmjet shteteve të zgjidhen përmes përdorimit të forcës siç janë: lufta, ndërhyrjet ushtarake etj.¹³⁴

Ky model, mbështetet mbi premisën e sigurisë si një e mirë për të cilën shtetet luftojnë dhe e arrijnë këtë në llogari të tjerëve.¹³⁵ Lufta është një dukuri shoqërore e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria njerëzore, që fillimisht nuk zhvillohej në bazë të ndonjë doktrine të përcaktuar ushtarake, qoftë edhe të përgjithshme, por në mënyrë spontane. Ajo ka qenë herët e pranishme edhe shpesh përcaktuese në skenën e politikës ndërkombëtare. Një ndër përcaktimet më klasike, i cili mbahet mend edhe sot si më i ploti dhe domethënësi, është bërë nga një ndër mendimtarët më të mëdhenjë ushtarak të të gjitha kohërave, gjenerali prusian Karl Maria fon Klauzeviç. Sipas tij, lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera, që nënkupton mjetet e dhunës. Për këtë qëllim Klauzeviç i bënte përgjegjës politikën.¹³⁶

Shumica e konflikteve të dhunshme përmbajnë elemente fetare të lidhura me çështjet ndër-shtetërore, etno-kombëtare, territoriale, ekonomike, kulturore etj. Konfliktet duke kërcënuar kuptimin e jetës të bazuara në fe kanë tendencë të bëhen lloje të paepura, këmbëngulëse dhe brutale të luftërave. Kur konfliktet janë të shtrira në aspektin fetar, ato shëndërohen në konflikte me vlerë, ndryshe nga çështje të tjera si konfliktet e burimeve të cilat mund të zgjidhen me mjete pragmatike dhe shpërndarëse. Në një botë ku shumë qeveri dhe organizata ndërkombëtare janë duke vuajtur nga një deficit i legjitimitetit, mund të pritet një ndikim në rritje të diskurseve fetare në politikën ndërkombëtare.¹³⁷

Element tjetër i përbashkët llogaritet edhe dhuna, si një fenomen i cili nuk kufizohet qartë as në shkencë e as në përdorimin gjuhësor të përditshëm.¹³⁸ Nëse në televizion ose në shtypin

¹³⁴ Peter Mangold, *National Security and International Relations*, 1990, New York

¹³⁵ <https://peizazhe.com/2011/07/11/tri-pamje-te-ceshtjes-shqiptare/>

¹³⁶ Sylejman Selimi, *Lufta në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe qëndrueshmëria e saj*, Akademia diplomatike shqiptare, Tiranë, 2013, f.6-7

¹³⁷ <https://www.slideshare.net/eismaili/konfliktet-fetare>

¹³⁸ https://issuu.com/gazetamapo/docs/17-18_maj_ok

ditor flitet për dhunën atëherë në shumicën e rasteve bëhet fjalë për aspektet e mëposhtme të dhunës: kriminalitet i dhunshëm, trazira dhe kaos i vërtetë, dhunë e motivuar politikisht, dhunë armiqësie ndaj të huajve, vandalizëm etj.

Elemente tjera të përbashkëta konfliktet kanë edhe dhunën mbi jetërat e njerëzve dhe personave, në veçanti vrasjet e të gjitha llojeve siç janë: gjymtimi, trajtimi mizor, tortura, cenimi i dinjitetit personal (në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues).

4.2. Shkaqet e konflikteve

Sigurisht që shkaqet dhe format e konflikteve janë të ndryshme dhe si të tilla ndryshojnë në kontekst dhe rrethana të caktuara shoqërore. Mirëpo duhet thënë se me të drejtë shumica e studijuesve i konsiderojnë politikat qeveritare diskriminuese si shkaqet rrënjësore të konfliktit. Sipas kësaj pikëpamje, konflikti do të zhvillohet gjithnjë aty ku mbajtësit e pushtetit politik e favorizojnë grupin e tyre etnik politikisht dhe ekonomikisht, dhe në anën tjetër i përjashtojnë vazhdimisht bashkësitë tjera etnike. Kjo është ajo që është e njohur si politika e përjashtimit. Përveç kësaj, dominimi kulturor apo frika e asimilimit do të çojë në përplasje të vazhdueshme ndëretnike. Përveç konflikteve që rrjedhin nga marrëdhëniet e pushtetit, në mes të një grupi dominues etnik „në grup“ dhe identiteteve etnike të përjashtuara e „grupeve jashtë“, konflikti etnik mund të bëhet edhe më i paparashikueshëm. Dhe kjo ka të bëjë me përplasjen që mund të lind midis ose ndërmjet bashkësive etnike shpesh për shkak të konkurrencës ndaj burimeve ekonomike dhe pabarazisë qytetare dhe në një situatë të tillë mund shumë lehtë të shpërthej një luftë civile mes bashkësive.¹³⁹

Të gjitha konfliktet janë të ndryshme me historinë e tyre të veçantë. „Pabarazia brenda shoqërive dhe ndërmjet rajoneve është bërë një shkak kryesor për konflikt, përkeqësimi nga shpërndarja e shpejtë e informacionit, sikur njerëzit që janë tani më të vetëdijshëm për

¹³⁹ <http://archive.koha.net/?id=31&o=681>

pabarazinë“.¹⁴⁰ Trendet ekonomike, sociale dhe mjedisore vijnë së bashku, për shembull duke kërkuar në konkurrencën e burimeve dhe ndryshimeve klimatike (kjo e fundit intensifikon mungesën e burimeve, duke çuar në konflikt politik). Brishtësia e shtetit vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm për konfliktet e brendshme, paqëndrueshmërisë dhe vuajtjeve njerëzore. Disa nga shkaqet e konflikteve më kryesore janë:

1. Dallimet ideologjike – Vendet me ideologji të ndryshme janë zakonisht dyshues për njëri tjetrin pasi që kanë frikë se pala tjetër do të përpiqet për të ndryshuar mënyrën e tyre të jetës.
2. Resurset e pakta – Konfliktet ndërmjet shteteve ndonjëherë mund të ndodhin për shkak të mosmarrveshjeve rreth burimeve të pakta. Këto burime zakonisht kanë ndikim në mbijetesën ekonomike të një vendi.
3. Kontrolli i kufinjëve – kontrolli mbi toka të caktuara mund të thotë shumë për një vend veçanërisht nese ajo tokë është e rëndësishme për mbrojtjen dhe krenarinë kombëtare.¹⁴¹

Në një atmosferë në të cilën perceptimet për konfliktin, për shkaqet në konflikt, për interesat e ballafaquara, për mënyrën e realizimit të interesave, për eskalimin dhe rrezikun nga përdorimi i forcës për realizimin e qëllimeve, për jolegjitimitetin e dhunës, e përcaktojnë drejtimin se ku duhet kërkuar përgjigjet dhe zgjidhjet e mundshme, dhe duket pothuajse joreale të pohohet se konfliktet mund të pengohen, përkatësisht të mbrohen.¹⁴²

¹⁴⁰ <https://www.scribd.com/doc/75786544/globalizmii-ri>

¹⁴¹ <https://bareminimumsocialstudies.wordpress.com/2014/02/07/causes-of-international-conflict/>

¹⁴² Fondacioni Fridrih Ebert, Iniciativa për ndërtimin e paqes dhe demokracisë, Preventiva e konflikteve, f.12. Shkup, 2004

4.3. Ndikimi i faktorit ndërkombëtarë në zgjidhjen e konflikteve

Siç thuhet edhe më lartë se disa metodat të rëndësishme dhe të dëshmuara si më efikase për zgjidhjen e konflikteve janë: ndërhyrja e një pale të tretë, grupet e synuara, negociatat, arbitrazhi, ndërmjetësimi. Metoda këto të cilat janë të dëshmuara si më funksionale në varësi të qasjes së palëve që janë të përfshira në konflikt, gjithashtu edhe të atyre të përfshira në zgjidhjen e konflikteve.

Pa dyshim, mënyra më e suksesshme për zgjedhjen e konflikteve etnike është pengimi i tyre në momentet e të ashtuquajtrës „gjendje parakonfliktuale“. Nëse nuk kemi sukses këtu, krijohet gjendja konfliktuale, kur subjektet në konflikt kanë interesa, kërkesat dhe qëndrime të papajtueshme. Në këtë moment nisim të kërkojmë mënyra dhe mjete për zgjedhjen e konfliktit, që paraqet fazën e tij përfundimtare, sepse pak a shumë, nuk i kemi menjanuar shkaqet që i futi palët kundërshtare në këtë gjendje.¹⁴³

Ndikimi i faktorit ndërkombëtarë në zgjidhjen e konflikteve është mjaft i rëndësishëm.

Bashkësia ndërkombëtare pati rol aktiv në zgjidhjen e konfliktit të Republikës së Maqedonisë, e cila ndryshoi kahjen dhe dinamikën fillestare. Në këtë kontekst, NATO, BE-ja dhe OSBE-ja, nga njëra anë dhe pala maqedonase nga ana tjetër, nga ky konflikt nxorrën mësim të dobishëm. Respektivisht, nga shembulli i Maqedonisë për parandalimin relativisht të suksesshëm, rezultoi edhe mësimi i përgjithshëm si për aktorët vendas edhe ata ndërkombëtarë, ndërsa kjo do të thotë se parandalimi i konflikteve nuk mund të perceptohet si një formulë e cila sipërfaqësisht do t'i zgjidh problemet, ndërkaq në fakt do t'i lë të hapura shkaqet e thella të konflikteve politike (korrupsionin, mobilizimin etnopolitik, kriminalitetin), ekonomike (zhvillimin e ulët, mungesën e investimeve, papunësinë), sociale (varfërinë, standardin e ulët), dhe të sigurisë (kontrabandën me njerëz, posedimin dhe tregtinë jolegale me armë). Pasqyra e gjendjes në Maqedoni para dhe pas krizës së vitin 2001, është shembull evident për këtë.¹⁴⁴

¹⁴³ Stojanoski, Nelko; Gjurovska, Mileva; Matevski, Zoran, SOCIOLOGJIA për vitin e III të gjimnazit të reformuar, Prosvetno Dello, Shkup, 2004. Fq. 125

¹⁴⁴ Lidija Georgieva, *Partneri vo mir i prevencija; postkonfliktni dilemi za Makedonija*, Shkup, 2005

Mënyra e reagimit të Bashkimit Evropian ndaj konfliktit në Maqedoni ishte një test për zhvillimin e kornizës së re institucionale të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët si dhe për kredibilitetin politik të BE-së në skenën ndërkombëtare për disa shkaqe kryesore.

Së pari, konflikti në Maqedoni u zhvillua kur institucionet e reja të politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët dhe të politikës europiane të sigurisë dhe mbrojtjes, ishin në fillimin e realizimit të tyre të mirëfilltë. Kjo gjithsesi se ishte mundësi e mirë që të perceptohet se si tekstet juridike adaptohen nga aktorët e involvuar në implementimin e tyre.

Së dyti, BE-ja ishte ndërmjetësues në zgjidhjen e konfliktit në momentin kur Maqedonia e kishte firmosur Marrëveshjen e stabilizim asocimit.

Së treti, ekzistonte mundësia që konflikti të shkaktonte pasiguri jo vetëm në Ballkan, por edhe brenda vet Bashkimit Evropian. Në këtë rast BE-ja, e kishte parasysh faktin se Republika e Maqedonisë është pjesë e fqinjësisë së Unionit. Në kushte të këtilla, ndërmjetësimi i BE-së, në konfliktin e Maqedonisë, në mënyrë direkte e theksoi bashkëpunimin e brendshëm të nevojshëm ndërqeveritar, si dhe bashkëpunimin e jashtëm ndërqeveritar.

Këtu, është e rëndësishme të kihet parasysh se edhe pse strukturat e BE-së, në segmentin e politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët dhe të politikës europiane të sigurisë dhe mbrojtjes, ishin relativisht të reja dhe përpiqeshin të gjenin rolin dhe vendin e tyre në procesin global të Bashkimit Evropian, ato në mënyrë direkte ose te tërthortë ndihmuan që aksioni i BE-së në R.M të prodhojë rezultat më pozitiv, gjë që nuk ndodhi në krizat e mëparshme të Ballkanit. Gjithsesi ndikim të vet pati Bashkimi Evropian dhe strategjia e qartë ndaj Ballkanit. Kjo do të thotë se Unioni, këtë pjesë të Ballkanit e llogarit si pjesë përbërëse të Evropës së Bashkuar, dhe në këtë kuadër BE nuk mundi ta lejojë joefikasitetin e demonstruar në krizën jugosllave në vitet e 90-ta. Në këtë kontekst është edhe angazhimi i vendosur diplomatik dhe politik i BE-së dhe i vendeve anëtare të saj në drejtim të tejkalimit të saj.

Në këtë drejtim duhet të theksohet roli pozitiv i përfaqësuesit të lartë të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, Javier Solana. Pa dyshim se përfaqësuesi i lartë u bënte presion paralel të dyja palëve në konflikt në mënyrë që të arrihet marrëveshje me mjete politike. Ky ishte vetëm vrelli i parë, edhe atë duke falenderuar mbështetjen e Komisionit Evropian. Në masë të njëjtë,

ndihmoi edhe firmosja e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim ndërmjet BE-së dhe NATO-s, me qëllim që të dyja palët e konfliktit të obligohen të lidhin marrëveshje politike.¹⁴⁵

Ndër të tjerash, BE-ja pohon se ka mjete të ndryshme financiare dhe politike për të mbështetur përpjekjet për parandalimin e konflikteve, siç janë:¹⁴⁶

- a) Bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma të jashtme
- b) Instrumentet për politika të tregëtare
- c) Ndihma humanitare
- d) Politikat sociale dhe të ambientit
- e) Instrumentet diplomatike dhe dialogu politik
- f) Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat joqeveritare
- g) Si dhe instrumentet e reja në fushën e menaxhimit të krizave

Po ashtu është evidente nga konsensusi evropian për zhvillim, një deklaram i politikave që reflekton vullnetin e BE-së që do të zhdukë varfërinë dhe të ndërtojë një botë më stabile dhe më të barabartë, dhe që BE-ja do të zhvillojë plane gjithëpërfshirëse për shtetet në të cilat ka rrezik për shpërthimin e konflikteve. Politikat e miratuara nëse aplikohen në mënyrë të duhur, mund të zvogëlojnë rrezikun nga konflikti dhe mund të ndihmojnë në parandalimin e konflikteve duke adresuar shkaqet thelbësore të konflikteve të dhunshme, duke e përfshirë degradimin, varfërinë, shfrytëzimin, distribuimin e pabarabartë, qasjen në toka dhe resurse njerëzore dhe pabarazi gjinore. Për më tepër BE-ja do të promovojë dialogun, pjesëmarrjen dhe pajtimin me qëllim të promovimit të paqes dhe parandalimit të shpërthimit të dhunës.¹⁴⁷

E kaluara na ka dëshmuar se cilësimi i shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si: „çështje e brendshme“ e shteteve, trajtimi i pamëshirshëm i të cilave ka dërguar në kryerjen edhe të gjenocideve nga disa autoritete shtetërore, është vërtetuar jo vetëm si veprim jo i drejtë por edhe i paqëndrueshëm, duke dërguar kështu në reagimin dhe ndërhyrjen e shumë faktorëve ndërkombëtar në zgjidhjen e konfliktit.

¹⁴⁵ Marina Mitrevska, *Mediacioni (Ndërmjetësimi) i Bashkësisë Ndërkombëtare*, Shkup, 2009, f.127-128.

¹⁴⁶ http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/cpcm/index.htm

¹⁴⁷ http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/eu_concensus_en.pdf

4.4. Marrëveshjet e arritura dhe zbatimi i tyre

Gjithmonë për tejkalimin e konflikteve apo luftimeve të ndryshme që zhvillohen nëpër botë faktori ndërkombëtarë ka luajtur rol kyç në përfundimin e tyre duke ulur palët e përfshira në konflikt për arritjen e marrëveshjeve të firmosura nga ana e tyre.

Kështu është rasti edhe me Republikën e Maqedonisë dhe Irlandën e Veriut, të dyja këto vende të përfshira nëpër konflikte.

Firmosja e Marrëveshjes së Ohrit më 13 gusht 2001, i dha fund konfliktit maqedono-shqipëtarë, i cili në vehte përmbante tërësisht dhe pa kusht hudhjen e përdorimit të dhunës për realizimin e qëllimeve politike; karakteri shumë etnik i shoqërisë maqedonase duhet të rruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike; ndërprerjen e armiqësive; zhvillimi i pushtetit të decentralizuar; mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë dhe i barabartë; procedurat e posaçme kuvendore – për nxjerrjen e ligjeve që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimit, dokumenteve personale dhe përdorimit të simboleve, si dhe ligjeve për financim lokal etj.; arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve; shprehja e identitetit – lidhur me simbolet, pranë simbolit të Maqedonisë, autoritetet vendore do ta kenë lirinë që në anën e parë të objekteve publike vendore të vendosin simbolet me të cilët shënohet identiteti i bashkësisë e cila është në shumicë në komunë, me respektimin e rregullave dhe zbatimeve ndërkombëtare.¹⁴⁸

Në Irlandën e Veriut marrëveshja më e rëndësishme e arritur për t'i dhënë fund trazirave të përgjakshme ka qenë „Marrëveshja e Premtes së Mirë“ ose ndryshe e quajtuar Marrëveshja e Belfastit, që ishte një zhillim i madh politik në procesin e paqes në Irlandën e Veriut.

„Marrëveshja është e përpiluar nga dy dokumente të ndërlidhura njëra me tjetrën, ku të dy palët e përfshira në konflikt ranë dakord në të „Premten e mirë“ më 10 prill 1998 për firmosjen e saj:

- Marrëveshje me shumicën e partive politike të Irlandës së Veriut;
- Marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet qeverive Britanike dhe Irlandeze (Marrëveshja Britaniko – Irlandeze).

¹⁴⁸ Marrëveshja e Ohrit, 13.08.2001

Marrëveshja përcakton një seri komplekse të dispozitave që lidhen me një numër fushash, duke përfshirë:

- Statusi dhe sistemi i Qeverisë së Irlandës së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar
- Marrëdhëniet në mes Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës
- Marrëdhëniet në mes Republikës së Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar’’.¹⁴⁹

Çështjet që kanë të bëjnë me sovranitetin, të drejtat civile dhe kulturore, çarmatimi, drejtësia dhe policia kanë qenë në qendër të kësaj marrëveshjes. Marrëveshja u miratua nga votuesit në të gjithë Irlandën e Veriut në dy referendumet e mbajtura më 22 maj 1998.¹⁵⁰

Firmosja e këtyre marrëveshjeve është një sukses i rëndësishëm i të dy palëve që kanë rënë në konflikt, prandaj edhe vendosja e këtyre marrëveshjeve të arritura duhet që të zbatohen me synim që ta ruajnë e të forcojnë paqen.

¹⁴⁹ https://www.northsouthministerialcouncil.org/sites/northsouthministerialcouncil.org/files/publications/nsmc_annual_report_2001-opt.pdf

¹⁵⁰ <http://cain.ulst.ac.uk/events/peace/docs/da21299.htm>

Përfundimi

Burim i shumë konflikteve nëpër botë është mosrespektimi dhe diskriminimi i fondamenteve të demokracisë, mosrespektimi i gjuhës dhe shkollimit, tendenca e politikës karshi institucioneve, shpjen në lindjen dhe përshkallëzimin e shumë konflikteve tjera si dhe shkeljen e qytetarëve dhe të drejtave dhe lirive të tyre. Dallimet etnike dhe fetare në të shumtën e rasteve janë ato që i nxisin konfliktet dhe tensionojnë situatën ku më së miri mund ta vërjëm gjatë shtjellimit të këtij studim rasti.

Prandaj, kur t'i kemi kuptuar siç duhet shkaqet e konflikteve, në këtë studim rasti ka më shumë mundësi t'a rregullojmë më mirë të sotmen dhe t'a pregatisim më mirë akoma të nesërmen. Por, ndodh shpesh herë që njerëzit të vrapojn pas interesave të ndryshme kombëtare, shoqërore e politike, duke harruar të jetojnë në paqe me njëri tjetrin.

Megjithëse janë shfaqur aq mendime për këtë çështje të rëndësishme ndërkombëtare, ende mbetet si problem i pa zgjedhur, dhe mbetet detyrë primare për forcat paqedashëse që të mos lejojnë konflikte brenda shoqërisë.

Kuptohet se është vështirë që çdo herë në rast konflikti, të vetëdijësohen palët se konflikti është pozitiv dhe se duhet të trajtohet në atë mënyrë që të ju shërbej të dyja palëve. Në këtë mënyrë përfitimet do të jenë reciproke dhe të dobishme. Mirëpo, duhet të bëhen përpjekje që të shihen situatat dhe palët negociuese qartë, me qasje bashkëpunuese dhe të respektohen. Nëpër botë ka pasur mjaftë shembuj që nuk kanë rezultuar me sukses dhe ka pasur pasoja të mëdha materiale apo edhe me jetë të njerëzve. Ky është një mësim që duhet ta marrin të gjithë si qortim. Ndërkaq, shembujt për lëvdat nuk mungojnë dhe prej tyre mund të mësohet akoma më tepër se si të zgjidhen çështjet.

Zgjidhja e konflikteve është një procedurë e gjatë, e ashpër, e vështirë mirëpo sjell shumë përfitime dhe ia vlen që të mënjanoen dallimet në mes të palëve dhe të arrihet një kompromis. Në këtë mënyrë, shpëtohen njerëz, mund të ketë më pak dëme materiale dhe ndërtohen marrëdhënie më të shumta miqësore. Duke i shërbyer një kombi të tërë apo edhe më gjerë, një rajoni.

Ndërtimi i paqes gjithashtu është problematik, por përderisa egzistojnë modele të tilla të suksesshme, ka shpresë dhe hapësirë se ato janë të realizueshme. Edhe pse është një proces që merr shumë kohë dhe duhet durim, forcë, njohuri dhe kompetenca që të aplikohet një sistem i mirëfilltë i paqes, organizatat e ndryshme ndërkombëtare bëjnë përpjekje që gjatë gjithë kohës të arrijnë caqet e tyre të implementimit të një plani të caktuar paqeruajtës.

Pra, na u desh të japim një përmbledhje të shkurtër rreth konflikteve në fjalë, si dhe për të treguar anën krahasuese ndërmjet tyre, sidomos t'iu japim një shikim sa më të plotë dhe sa më të drejtë historisë së tyre, me qëllim që të kuptojnë se si ka arritur deri tek konflikti, peripecitë e vështira që kanë hasur gjatë kësaj periudhe të së cilës duhet t'iu vlejnjë si një mësim për ndërtimin e një të ardhme më të mirë.

Konflikti ndonjëherë mund të merr përmasa tepër të mëdha që të kalon nga konflikt multietnik në atë ndër-fetar, siç ishte rasti në kalanë e Shkupit. Protestat ishin të organizuara për të ndaluar ndërtimin e kishës në mes të kalasë. Mirëpo, situata morri drejtim tjetër duke akuzuar palën shqiptare që është kundër kishave dhe besimit të krishterë në Maqedoni. Në një çfarë mënyre nga shumë analistë dhe studiues të çështjeve të Ballkanit perceptohej si nxitje e konfliktit ndër-fetar. Tema të tilla janë shumë të ndjeshme andaj duhet pasur kujdes të veçantë dhe maturi pasi që në çdo moment mund të eskalon situata dhe të kalon në konflikt me përmasa më të gjëra.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

- Nocioni konflikt shpesh herë ngatërrohet me nocionin krizë. Mirëpo ekziston dallim konceptual dhe përmbajtësor në mes këtyre dy nocioneve. Në të shumtën e rasteve shprehja e revoltës dhe pakënaqësive të një grupi të caktuar për arritjen e qëllimeve legjitime shkakton konflikt
- Konfliktet zhvillohen në faza të ndryshme dhe dallojnë njëër me tjetrën për nga natyra dhe lloji i tyre pasi që jo gjithmonë paraqiten interesa të përbashkëta në varësi nga qasja dhe mënyra e trajtimit të tyre

- Ekzistojnë lloje të ndryshme të konflikteve siç janë: konflikte etnike, fetare, politike, ideologjike, ekonomike etj. Të gjitha këto dallojnë njëra me tjetrën për nga karakteri dhe studimi i tyre, mirëpo e kanë të përbashkët mospajtueshmërinë për çështje të caktuara
- Për zgjidhjen e konflikteve gjithmonë duhet të negociohet dhe të arrihen marrëveshje për shmangien e tyre, pasi që shumë nga ato mund të kalojnë në konflikte me pasoja të mëdha për popullatën civile
- Ndër metodat më efikase për zgjidhjen e konflikteve llogariten ndërhyrja e palës së tretë, negociatat, ndërmjetësimi, bisedimet etj
- Pothuajse në çdo konflikt medoemos duhet ndërhyrja e palës së tretë pasi që është vendimtare për drejtimin që mund të marrë konflikti dhe të parandalojë një gjë të tillë
- Shumë konflikte kanë lindur si rrjedhojë e diskriminimit, mohimit dhe shpërfilljes së shtetit për të drejtat themelore të qytetarëve të vet, siç është rasti me Maqedoninë dhe Irlandën e Veriut
- Një ndër konfliktet më të zgjatura në Europë konsiderohet konflikti në Irlandën e Veriut që zgjati për 30 vite dhe kishte karakter etnik dhe fetar me përmasa të mëdha dhe shkaktimin e shumë dëmeve njerëzore dhe materiale.
- Konfliktet në Ballkan në të shumtën e rasteve janë konflikte etnike si në rastin e Maqedonisë, por ndonjëherë merr edhe formën e atij fetar.
- Firmosja e marrëveshjeve sikurse në rastin e Maqedonisë dhe Irlandës së Veriut, është mënyra e vetme për arritjen e qëllimeve të tyre dhe plotësimin e kushteve të barabarta për jetesë në çdo sferë të jetës me bashkësitë tjera në vend
- “Marrëveshja e Premtes së Mirë” përcaktoi një kornizë për të qeverisë dhe deleguar bartjen e kompetencave të përcaktuara mbi qeverisjen lokale nga Londra në Belfast – dhe bëri thirrje për formimin e Kuvendit të Irlandës së Veriut dhe Komitetin ekzekutiv në të cilën palët e unionistëve dhe nacionalistëve do të ndajnë pushtetin.
-

Literatura e shfrytëzuar

1. *A Dictionary of Law*, University press. Oxford, 2009.
2. Adamson, Kevin dhe Jovic, Dejan, "The Macedonian–Albanian political frontier: the re-articulation of post-Yugoslav political identities," *Nations and Nationalism* 10 (3), 2004.
3. Agnesh Heler, *Vlerat dhe kërkesat*, Beograd, 1981.
4. Alban Përmeti, *Kriza e vitin 2001 dhe faktori shqiptar në Maqedoni*, Konferenca-11-June-Final. <http://iipcccl.org/wp-content/uploads/2016/06/Konferenca-11-June-Final.pdf>
5. Anthony Oberschall, *Theories of social conflict*, Nashville, Tennessee, 1978.
6. Anthony Wanis St. John, *Nga menaxhimi me kriza deri në parandalimin e konflikteve*, Shkup, 2009.
7. Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë, F. CK.SKM, K302, dok.1-2. (mëtej DARM, 1.427.535.2/1-2).
8. Aziri, Etem, "Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement, *Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures*, fq. 131-156. Epoka University, tetor 2011.
9. Bashkurti, Lisen *Negociatat, Historia, teoria, praktika*, Tetovë, 2010.
10. Bejtush Gashi, *Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike*, Prishtinë, 2008.
11. Cambridge University Press, 2007
12. David McKittrick, *Making Sense of the Troubles*, UK, 2002.
13. Davies, Jack, "Is Macedonia on the brink of another ethnic conflict," *Vice*, 15 korrik, 2014
14. Drejtësia *Restauruese dhe Ndërmjetesimi në Zgjedhjen e Konflikteve Penale: Manual për Gjygjëtar dhe Prokuror*: Botim nga UNICEF, Komisioni European dhe Sida. Tiranë 2007.
15. Dzunov, *Suksesijata na drzavite, drzavjanstvoto i noviot praven poredok na R.M.*, Shkup, 1992
16. Emilija Simoska, *Macedonia: A view on the inter-ethnic relations*, Stamboll, 1996.
17. Eugenio F. Biagini, *British democracy and Irish nationalism - 1876-1906*
18. F. Tashevska Remenska, *Mekanizma për zgjidhjen e konflikteve etnike*, Shkup, 2009.

19. **Fakti**, Deklaratë e Unionit European për situatën në Maqedoni: ” **Liderët shqiptarë të insistojnë për dialog**”, 26 mars, 2001, 6.
20. **Fakti**, Deklaratë e Unionit European për situatën në Maqedoni: ” **Liderët shqiptarë të insistojnë për dialog**”, 26 mars, 2001, 6.
21. Faqja zyrtare e Presidencës së Republikës së Maqedonisë, Shih në: www.president.gov.mk/en/about-
22. Fehmi Agani, *Toleranca dhe konfliktet shoqërore*, Prishtinë, 1997.
23. Fernand de Varennes / SFIDAT E SHPESHTA NE IMPLEMENTIMIN E MARREVESHJEVE PAQESORE BRENDË SHTETIT: RESISTENCA E AUTORITETEVE SHTETERORE marrë nga: <http://www.newbalkanpolitics.org.mk>
24. Fernand de Varennes, *Theory of Ethnic Conflicts and Sociology*, Australia, 2004.
25. Fjalimi i deputetes Ilinka Mitreva në Kuvendin e Maqedonisë, Mbledhja 53, 24.07.2000
26. Fjalimi i deputetit Mersel Bilalli në Kuvendin e Maqedonisë, Mbledhja 53, 18.07.2000.
27. *Fjalor i shqipës së sotshme*, ASHSH, Instituti i gjuhësisë dhe i leterisë, Tiranë, 2002.
28. Fondacioni Fridrih Ebert, Iniciativa për ndërtimin e paqes dhe demokracisë, Preventiva e konflikteve, Shkup, 2004
29. Fraen
30. Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, 5 shkurt 1989, *Nacionalizmi shqiptar edhe mëtej po e ngarkon gjendjen e sigurisë*.
31. Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, 5 shkurt 1989, *Nacionalizmi shqiptar edhe mëtej po e ngarkon gjendjen e sigurisë*.
32. Gazeta “Flaka”, 14 gusht 2001.
33. Gazeta “International Herald Tribune”, 20 mars 2001, *NATO Aims to Seal Macedonia Border*.
34. Gazeta “Nova Makedonija”, 9 mars 2001, *Osudeno nasilstvoto od albanskite ekstremisti*.
35. Gazeta “The Times”, 16 mars 2001, *New clashes light Balkans fuse*.
36. Gazeta “The Times”, 9 mars 2001. *Rebels escape as US troops seize Albanian base*.
37. Gazeta Nova Makedonija, 9 mars 2001, *Voeno-tehnička pomosh za Makedonija od 16 milioni marki*.
38. Glenny Misha, *The Fall of Yugoslavia*, Londer, 1996.

39. Greg Cashman, *What causes war – an introduction to theories of international conflicts*, Maryland, 2013.
40. Hivzi Islami, *Problemet Demografike të Kosovës dhe të trevave të tjera etnike shqiptare, në Çështja e Kosovës një problem historic dhe actual*, Instituti I Historisë – Prishtinë dhe Instituti I Historisë – Tiranë, Tiranë, 1996.
41. Hugh Poulton, *Who are the Macedonians?*, SHBA, 1995.
42. *Irish Studies*, University of Bradford, 1983.
43. Ismet Elezi, *Ndërmjetësimi për Pajtim në Konfliktet Penale*, Tiranë, 2004.
44. J. S. Mill, *A Few Words on Non-Intervention*, London, 1859.
45. John Paul Lederach, *Building peace: sustainable reconciliation in divided societies*, Washington, 1997.
46. Jonathan Tonge, *Northern Ireland Conflict and Change*, UK, 1998
47. Jonuz Abdullahi, *Politika dhe politikat politike*, Arbëria Desing, Tetovë. 2016
48. Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë, 2003.
49. Julie Kim (Specialist in International Relations, Foreign Affairs, Defense, and Trade Division),
50. Kel, Eran, “Macedonia,” në *Nations in transit 2003*. New York: Freedom House, 2004.
51. *Kërkesë e SHBA drejtuar Shkupit: “Të realizohen reformat kushtetuese”*, 26 mars, 2001,6.
52. *Kushtetuta e Maqedonisë*, nëntor 1991, neni – 7
53. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, 1991., parimet hyrëse.
54. *Kushtetutës së Maqedonisë të vitit 1991*, neni 55.
55. L.C. Green, *The contemporary law of armed conflict*, Manchester, 1996.
56. Latifi, Veton, *Negocimi si teknikë parësore për zgjidhjen e konflikteve, Zhvillimi i Negociatave 2*, Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Mardhënie Ndërkombëtare, 2007.
57. Lewis A. Coser, *Social Conflict and the Theory of Social Change*, The British Journal of Sociology, 1957.
58. Lidija Georgieva, *Partneri vo mir i prevencija; postkonfliktni dilemi za Makedonija*, Shkup, 2005
59. Lisen Bashkurti, *Krizat ndërkombëtare*, Tiranë, 2008.

60. Louis Kriesberg, *Constructive conflicts – from escalation to resolution*, UK, 2012.
61. Macartan Humphreys, *Economics and Violent Conflict*, Harvard University, 2003.
Macedonia, - A conflict analysis, October 2003, p. 7.
62. Macedonia, - A conflict analysis, October 2003, p. 8. macedonia/former-presidents.htm
63. Macedonia: Country Background and Recent Conflict, November 7, 2001, CRS Report for Congress, p.
64. Marie-Therese Fay, Mike Morrissey and Marie Smyth, *Northern Ireland's Troubles: The Human Costs*, (London: Pluto Press, 1999).
65. Marina Mitrevska, Mediacioni (Ndërmjetësimi) i Bashkësisë Ndërkombëtare, f.127-128, Shkup, 2009
66. Marrëveshja e Ohrit, 13.08.2001
67. Nazmi Maliqi, *Toleranca politike në funksion të paqës*, Fondacioni Friedrich Ebert, Shkup, 2001.
68. Peter Mangold, *National Security and International Relations*, 1990, New York
69. Petrit Mëhaj, *UÇK Mesazh dhe Shpresë*, vëllimi II, Tetovë, 2005.
70. Predrag Jureković, International Conflict Management in Macedonia, Bureau for Security Policy, Austrian Federal Ministry of Defence, p. 2
71. Rexhep Qosja, *Populli i ndaluar*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë.
72. S. Kalimovski, V. Patel, R. Treneska, *Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija*, Shkup, 2001.
73. Sandra Ismanovski, *Konflikt vo Makedonija 2001: terorizam ili borba za prava?* Skopje: Fondacija Institut otvoreno opshtestvo – Makedonija, 2008.
74. SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), Division for South-East Europe,
75. SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), Division for South-East Europe,
76. ***Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger***, *The Sofia Echo*, 14 mars 2012; http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger (27.10.2014).

77. Slaveski, Stojan dhe Kozarev, Atanas, “‘Europeanization’ of the Macedonian National Identity,” *The Western Balkans Policy Review*, Volume 2, Issue 1, Dimër/Pranverë 2012, Prishtinë.
78. Stephen K. Erickson & Marilyn S. McKnight, *The Practitioner’s Guide to Mediation: a klient-centered approach*, Canada, 2001
79. Stojan Andov, *Gabuam me shqiptarët*, Intervistë më 09-11-2015, shih në: <http://portalb.mk/214954-andov-gabuam-me-shqiptaret/>
80. Stojanoski, Nelko; Gjurovska, Mileva; Matevski, Zoran, *SOCIOLOGJIA për vitin e III të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004.
81. Sutton Index of Deaths: Summary of Organisation responsible.
82. Sylejman Selimi, *Lufta në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe qëndrueshmëria e saj*, Akademia diplomatike shqiptare, Tiranë, 2013.
83. T. Dzunov, *Sukcesijata na drzavite, drzavjanstvoto i noviot praven poredok na R.M.*, Shkup, 1992
84. The Constitution of the Republic of Macedonia, Published in The Official Gazette of the Republic of Macedonia, No. 52/91, 31/98, 91/01
85. The national archives, Countries within a country, 2003
86. The Northern Ireland Act, UK, 1998 Tom Gallagher, *James O’Connell, Contemporary*
87. United Nations, *Population Division*, UN, 2014
88. Violeta Petreska Beshka, *Konfliktet*, Shkup, 1995.
89. Vladimir Ortakovski, *Interethnic relations and minorities in the Republic of Macedonia*, 2001.
90. Voislav Vasileski, *E drejta ndërkombëtare në konfliktet e armatosura*, Shkup, 2003.
91. Yoram Dinstein, *War, aggression and self-difens*, Cambridge, 1995.
92. Zhidas Daskalovski, *Census taking and inter-ethnic relations in Macedonia*, 2013.
93. Zoran Matevski, *Zgjidhja konstruktive e konflikteve*, Shkup, 2003.
94. **9 BBC News**, “The IRA campaigns in England”, 4 March 2001
95. <http://archive.koha.net/?id=31&o=681>
96. <http://cain.ulst.ac.uk/events/peace/docs/da21299.htm>
97. http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/eu_concensus_en.pdf
98. http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/cpcm/index.htm

99. <http://lajmpress.com/maqedonia-ne-udhekryq-i/>
100. <http://lajmpress.com/maqedonia-ne-udhekryq-i/>
101. <http://www.bbc.co.uk/history/troubles>
102. <http://www.cain.ulst.ac.uk/othelem/chron/ch01.htm>
103. <http://www.dadalos.org/alb/vorbilder/peacepeople/geschichte.htm#Seitenanfang>
104. <http://www.economist.com/blogs/economist-explains/2013/11/economist-explains-4>
105. <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=28189&Cr=ki-moon&Cr1>)
106. <http://www.vice.com/read/albanians-in-macedonia-are-pissed-off-jack-davies-777>
107. <https://bareminimumsocialstudies.wordpress.com/2014/02/07/causes-of-international-conflict/>
108. https://issuu.com/gazetamapo/docs/17-18_maj_ok
109. <https://peizazhe.com/2011/07/11/tri-pamje-te-ceshtjes-shqiptare/>
110. <https://sot.com.al/politike-intervista/rama-projekti-yn%C3%AB-aktual-%C3%ABsht%C3%AB-evropa-e-madhe-jo-shqip%C3%ABria-e-madhe#sthash.%20wfFAbb7n.dpuf>
111. <https://www.nisra.gov.uk/statistics/population>
112. https://www.northsouthministerialcouncil.org/sites/northsouthministerialcouncil.org/files/publications/nsmc_annual_report_2001-opt.pdf
113. <https://www.royal.uk/role-monarchy>
114. <https://www.scribd.com/doc/75786544/globalizmi-ri>
115. <https://www.slideshare.net/eismaili/konfliktet-fetare>
116. <https://www.theguardian.com/uk/2002/may/19/bloodysunday.northernireland>